



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

PRANUAR ME
ACCEPTED ON 22/05/2023
PRIMLJENO

Nr.No.Br.

01/725



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

RAPORT I PUNËS SË KRYETARIT DHE DREJTORIVE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS

(JANAR – DHJETOR 2022)

KRYETARI
EKREM KASTRATI

Malishevë, Maj, 2023

1. HYRJE	f. 2 – 7
2. DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE	f. 8 - 10
3. DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE	f. 10 – 16
4. DREJTORIA E URBANIZIMIT	f. 16 – 19
5. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL	f. 19 – 30
6. DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCË DHE BUXHET	f. 30 – 33
7. DREJTORIA PËR ARSIM DHE EDUKIM	f. 34 - 41
8. DREJTORIA E INSPEKTORATIT	f. 41 – 44
9. DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË	f. 45 – 47
10. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	f. 48 – 68
11. DREJTORIA PËR ADMINISTRATË	f. 68 - 72
12. DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM	f. 72 - 75
13. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM	f. 75 - 99
14. ZYRA PËR BARAZI GJINORE	f. 99 - 100
15. ZYRA PËR INFORMIM PUBLIK	f. 101 - 102
16. SHTOJCA NR. 1 - RAPORTI I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE	
17. SHTOJCA NR. 2 - RAPORTI PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE	

HYRJE

Ky raport është një format i përmbledhur i të gjitha angazhimeve dhe punëve që janë bërë nga Kryetari i Komunës së Malishevës, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë drejtorët e drejtorive komunale, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022.

Ky Raport është në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Malishevës dhe akteve tjera nënligjore.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, angazhimi kryesor i Kryetarit të Komunës dhe organeve tjera komunale, ka qenë në funksion të respektimit të rendit, ligjit dhe disiplinës në punë.

Aktivitetet kryesore të Kryetarit të Komunës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 kanë qenë këto:

- Koordinimi i punëve me drejtorë të drejtorive, me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe realizimit të punëve sipas planeve përkatëse.
- Mbatja e takimeve të rregullta me drejtorë të drejtorive, përcaktimi i detyrave dhe raportimi për punët e realizuara
- Mbikëqyrja e realizimit të buxhetit të Komunës dhe realizimit i të hyrave vetanake për vitin 2022, si dhe shfrytëzimi sa më racional i mjeteve buxhetore.
- Mbikëqyrja e realizimit të projekteve kapitale të Komunës
- Raportimi i rregullt në Kuvendin e Komunës – çdo 3 muaj për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore
- Propozim aktet për shqyrtim dhe miratim në Asamblenë Komunale
- Mbikëqyrja në ngritjen e performancës në Administratën e Komunës, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore për qytetarët.
- Takimet publike me qytetarët, për çështje të ndryshme, duke përfshirë edhe dy takimet vjetore, që janë edhe obligim ligjor.
- Bashkëpunimi me institucionet qendrore, për projekte me interes për qytetarët dhe komunën tonë.
- Takime dhe bashkëpunime me organizata qeveritare dhe OJQ vendore e ndërkombëtare, përfaqësues të USAID-it, OSBE-së, KFOR-it, dhe me organizata humanitare, me të cilat kemi realizuar edhe disa projekte në bashkëfinancim, në fushën e mirëqenies sociale,
- Kryetari i Komunës ka bashkëpunuar ngushtë me të gjitha shoqatat e dala nga lufta, me pensionistët, veteranët e arsimit, etj.
- E ka përfaqësuar Komunën nëpër vizita zyrtare, gjithnjë në funksion të bashkëpunimit dhe mundësisë së sjelljes së investuesve të mundshëm në territorin e komunës së Malishevës.

Gjithashtu, në këtë Raport, të listuara dhe të detajuara janë edhe disa nga fushat kryesore të angazhimit të kryetarit të Komunës dhe ekzekutivit në përgjithësi gjatë vitit 2022:

- ❖ Diskutimet publike dhe bashkëpunimi me qytetarët
- ❖ Furnizimi me ujë të pijes në tërë territorin e Komunës së Malishevës
- ❖ Mirëmbajtja e mjedisit
- ❖ Përkrahja e familjeve me kushte të rënda ekonomike
- ❖ Bashkëpunimi me institucionet qendrore
- ❖ Bashkëpunimi me partnerët dhe donatorët vendorë e ndërkombëtarë
- ❖ Realizimi i Planit të Punës sipas Drejtorive

DISKUTIMET PUBLIKE DHE BASHKËPUNIMI ME QYTETARËT

Siç edhe jemi zotuar se, qytetarët do të kenë një tretman të domosdoshëm gjatë qeverisjes sonë katër vjeçare, ashtu edhe jemi angazhuar gjatë periudhës janar-dhjetor 2022. Qytetarët janë duke u bërë pjesë aktive në qeverisjen tonë, ku duhet theksuar se dera e kryetarit të Komunës së Malishevës, është çdo ditë pune e hapur për të gjithë qytetarët, me të cilët diskutohet lidhur me problemet që ata ballafaqohen dita ditës, pastaj për kërkesat që ata kanë lidhur me përmirësimin e kushteve elementare nëpër fshatrat ku ata jetojnë e veprojnë, si dhe kërkesa të natyrës sociale, ku njerëzit na drejtohen neve si Komunë, për të na kërkuar ndihmë financiare, në mënyrë që sado pak tua lehtësojmë koston e shpenzimeve që ata kanë, në trajtimin e sëmundjeve me të cilat ballafaqohen.

Gjithashtu, ne e kemi caktuar ditën e Enjte, nga ora 13:00 deri në ora 15:00, si ditë të rregullt të takimit të qytetarëve me kryetarin e Komunës, ku në rastet kur në mungesën kryetarit, qytetarët i takon edhe nënkryetari i Komunës, apo edhe ndonjëri nga stafi i zyrës së Kryetarit.

Kemi zhvilluar dy diskutime publik me kryetarët e fshatrave të Komunës së Malishevës. Pastaj, dy diskutime publike me qytetarë, dy diskutime publike me fermerët, si dhe disa të tjera me grupe të caktuara të shoqërisë për dokumente me rëndësi të disa prej drejtorive të qeverisjes sonë komunale.

FURNIZIMI ME UJË TË PIJES NË TËRË TERRITORIN E KOMUNËS SË MALISHEVËS

Të gjithë e dimë se situata e furnizimit me ujë të pijes në Komunën e Malishevës, nuk është e mirë. Pjesa më e madhe e fshatrave kanë probleme të mëdha lidhur me mungesën e ujit të pijes, derisa edhe ato fshatra që janë të kyçura përmes kompanisë së Hidroregjionit Jugor, çdo ditë e më tepër po kanë problem në rritje, si me mungesë të ujit, po ashtu edhe me prishje të kohë paskohshme të sistemit të ujësjellësit për shkak edhe të amortizimit të gypave aktual.

Siç e dini, njëra nga zotimet tona kryesore ka qenë edhe zgjidhja e problemit sa i përket mungesës së ujit të pijes nëpër fshatrat tona. Si rrjedhojë e kësaj, në takimet tona, pothuajse me të gjithë që jemi takuar, por edhe përmes mjeteve të informimit jeni njoftuar se, që në ditët e para të mandatit tonë, kemi ndërmarrë hapat e duhur në funksion të kësaj çështje.

Që në start, kemi zhvilluar takime me kompaninë që operon në Komunën tonë, dhe ia kemi përcjellë të gjitha pakënaqësitë e qytetarëve tanë lidhur me mungesën e furnizimit me ujë të pijes.

Më pastaj, kemi aranzhuar edhe disa takime tjera me institucionet qendrore, por edhe me drejtuesit e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Gjakova”, me të cilët kemi diskutuar lidhur me mundësinë e realizimit të projektit për të kyçur komunën tonë në sistemin e Radoniqit.

Ne kemi vazhduar me takime edhe me ministrinë përkatëse, dhe ua kemi shprehur kërkesat tonë, të mungesës së furnizimit me ujë të pijes, si dhe mundësisë së kyçjes me sistemin e Radoniqit.

Si rezultat i gjithë këtij angazhimi tonë, Këshilli Ndërmintor për Ujëra, që drejtohet nga kryeministri, ka marrë vendim që të formohen grupet punuese për gjetjen e zgjidhjeve për furnizim me ujë nëpër komuna. Ku qeveria ka përzgjedhur 3 komuna, Malishevën, Ferizajn dhe Klinën. Këto grupe e kanë pas për detyrë që deri më 15 shtator të ofrojnë zgjidhje teknike për secilën komunë, që do të thotë edhe për Komunën e Malishevës.

Gjithashtu, ne si Komunë kemi vazhduar edhe bashkëpunimin me kompaninë që operon tek ne, Hidroregjionin Jugor, ku kemi nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi, që i ka hapur rrugë inicimit të disa projekteve konkrete, në funksion të shfrytëzimit maksimal të burimeve ekzistuese të ujit të pijes, mundësisë së rritjes së kapaciteteve në mënyrë që të bëjmë zgjidhje për të gjitha fshatrat e komunës sonë, si dhe për të ndërmarrë hapa konkret për menaxhimin e ujërave të ndotura.

Gjithashtu, ne si Komunë, jemi angazhuar për të bërë zgjidhje për fshatrat Temeqinë dhe Janqist, si dhe në bashkëpunim me Hidroregjionin, jemi duke ndërmarrë hapat e duhur për jetësimin e plotë të burimit të ujësjellësit në Senik.

Gjithashtu, vlen të theksohet se rreth kësaj çështje ne kemi bashkëpunuar edhe me partnerët ndërkombëtar, konkretisht me organizatën austriake “OSTAP”, të cilët edhe kanë bërë edhe një analizë dhe një plan detal për të kyçur gjithë fshatrat e komunës së Malishevës në sistemin e Radoniqit. Aktualisht bashkëpunimi me ta është në proces, dhe hapi i radhës është që t'i drejtohem ministrisë përkatëse për të hyrë si garantuese në këtë projekt, ashtu siç edhe e kërkon legjislacioni në fuqi.

Pra, këto janë disa nga angazhimet tona gjatë vitit 2022, sa i përket çështjes së furnizimit me ujë të pijes për qytetarët e Komunës së Malishevës.

MIRËMBAJTJA E MJEDISIT

Sikurse çështja e ujit, për ne si Komunë por edhe për të gjithë qytetarët tanë, pa dyshim se një ambient i pastër është synim i yni i përbashkët.

Ne kemi marrë hapat e nevojshëm në funksion të rritjes së ndërgjegjësimit për tu kujdesur për ambientin, sepse kujdesi për ambient është përkushtim direkt për një shoqëri sa më të shëndetshme në komunën tonë.

Lidhur me këtë çështje, për periudhën janar-dhjetor të vitit 2022, mund të themi se gjendja e mirëmbajtjes së ambientit nëpër fshatra në përgjithësi është e mire, mirëpo shqetësimi ynë është situata në zonën urbane, për çka edhe në takimet që kam zhvilluar me kompaninë e Ekoregjionit, ua kemi shprehur gjithë shqetësimin tonë por edhe të qytetarëve.

Gjatë vitit 2022, kemi ndërmarrë disa aksione të pastrimit në qytet, me karakter ndërgjegjësimi ndaj ruajtjes dhe mirëmbajtjes së mjedisit. Më pastaj, kemi bërë edhe krasitjen e drunjve nëpër qytet, që në një formë ndikon edhe në përmirësimin e imazhit të zonës së qytetit.

Gjatë vitit 2022, ne kemi marrë vendim për formimin e një Task Force Komunale, që drejtohet nga nënkryetari i Komunës, e cila është marrë me menaxhimin e situatës emergjente, lidhur me kujdesin për një mjedis sa më të pastër, konkretisht për menaxhimin e mbeturinave inerte dhe mbeturinave tjera në territorin e komunës së Malishevës, por edhe me pikën e mësipërme, pra; gjendjen e furnizimit me ujë të pijes.

Muaji Prill ishte i shpallur muaj i pastrimit të ambientit, dhe në funksion të kësaj, më datë 5 prill kemi marrë një aksion të madh të pastrimit, ku i janë përgjigjur të gjitha institucionet lokale dhe qytetarë të shumtë. Pastaj, në bazë të planit, Prilli Muaj i Pastrimit të Ambientit, drejtorja përkatëse në bashkëpunim me kompaninë Hidroregjioni, gjatë gjithë muajit ka vazhduar me aktivitete tjera.

Kemi marrë hapat e duhur, për të krijuar mekanizmat tona komunale, që të vazhdojmë edhe me eliminimin e pikave inerte nëpër fshatrat e Komunës së Malishevës, ku kemi paraparë caktimin e katër pikave grumbulluese dhe një pike të transferit.

Gjatë kësaj periudhe Komuna e Malishevës ka përfituar një kamion për grumbullimin e mbeturinave nga GIZ-i gjerman, të cilin më pas ua kemi dhënë kompanisë EkoRegjioni përmes një marrëveshje të përbashkët.

Në bashkëpunim me kompaninë EkoRegjioni kemi aplikuar edhe larjen e rrugëve në qytet dhe kjo do të praktikohet vazhdimisht.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET QENDRORE

Për shkak se Komuna e Malishevës, ka një buxhet të limituar krahas nevojave të mëdha që komuna jonë ka për të bërë investime kapitale, bashkëpunimi me institucionet qendrore është i domosdoshëm.

Në mënyrë që të kërkojmë përkrahje për projekte zhvillimore për komunë tonë, në cilësinë e kryetarit të Komunës së Malishevës, së bashku me bashkëpunëtorë, gjatë periudhës janar – dhjetor 2022 kemi zhvilluar disa takime me disa nga ministritë që lidhen ngushtë me fushën e projekteve tona.

Kemi bashkëpunuar me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të cilës i jemi drejtuar me disa kërkesa për përkrahje të disa nga projekteve tona, të cilat kanë nevojë për më shumë buxhet se sa janë mundësitë tona komunale.

Në mesin e disa kërkesave për të cilat jemi në diskutim e sipër me këtë ministri janë:

- Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës lokale nga fshati Lumishtë deri në fshatin Llapqevë (Mrasor).
- Mbështetje financiare për realizimin projektit të unazës-transitit – rruga për Dragobil.
- Zgjerimi i rrugës nga Malisheva në drejtim të fshatit Banjë deri në hyrje të autostradës.
- Rregullimi i rrugës nga dalja e autostradës deri në fshatin Duhel.
- Asfaltimi i rrugës Lumishtë deri të rrethi i Gurbardhit (Është nënshkruar marrëveshja me Ministrinë e Transportit)
- Renovimi i rrugës Malishevë-Kijevë.
- Kërkesë për lejimin e vendosjes së Lapidarit të Dëshmorit të Kombit "Mentor Gashi " nga fshati Pllloqicë, hyrje dalje të rrugës regjionale Prishtine - Pejë, në zonën kadastrale në fshatin Kijevë. (Është realizuar)
- Kërkesë për inicimin e procedurave për ndërtimin e një rreth-rrrotullimi në hyrje dalje të fshatit Tërpezë. (Në pritje)

Gjithashtu, ju informojmë se kemi zhvilluar takime edhe me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, pranë të cilës kemi aplikuar me projektin për ndërtimin e Çerdhes në fshatin Bellanicë, por që na është refuzuar.

Bashkëpunimi me KEDS-KESCO

Dimri që lamë pas ka qenë jashtëzakonisht një problem i madh për komunën e Malishevës, pasi që kemi qenë ndër komunat e vetme në nivel vendi, që në ditët më të ftohta, jemi ballafaquar me mungesë të theksuar të energjisë elektrike. Në funksion të zgjidhjes së këtij problemi, kam zhvilluar një takim me kryeshefin ekzekutiv të KEDS-it, me të cilin kemi diskutuar për veprimet që duhet t'i ndërmarrim si palë, në mënyrë që komuna jonë të ketë rrjetin e ri elektrik e me kapacitete të nevojshme nëpër secilin fshat të Malishevës.

PËRKRAHJA E FAMILJEVE NË KUSHTE TË RËNDA EKONOMIKE

Komuna e Malishevës është ndër komunat që ka numrin më të madh të familjeve në kushte të rënda ekonomike.

Në mënyrë që këtyre të familjeve t'u dalim krah, gjatë vitit 2022 kemi marrë disa veprime konkrete;

Me financim të Komunës, kemi ndarë pako ushqimore dhe miell për rreth 500 familje që janë raste sociale, ku në mesin e tyre ka edhe familje të cilat kanë qenë në vështirësi ekonomike për shkak edhe të situatës së renduar nga pandemia COVID-19.

Së fundmi, në prag të festës së Fitër Bajramit, në bashkëpunim të ngushtë me shoqatën Jetimat e Ballkanit, kemi ndare mbi 250 pako, si dhe miell për familjet në nevojë. Gjithashtu, Komuna e Malishevës, ka ndarë një shumë të mjeteve financiare për ndërtimin e dy shtëpive për dy familje në fshatin Ngucat.

BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT DHE DONATORËT VENDORË E NDËRKOMBËTARË

Nevoja për të rritur bashkëpunimin tonë si Komunë me partnerë dhe donatorë, qoftë vendorë apo ndërkombëtarë është e domosdoshme, sepse vetëm duke bashkëpunuar mund të bëjmë punë të mira për qytetarët tanë.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, ndër hapat që kemi ndërmarr në funksion të kësaj pike janë:

Kemi nisur një bashkëpunim me shoqatën Jetimat e Ballkanit, pranë së cilës kemi adresuar një kërkesë për ndërtimin e dhjetëra shtëpive për familjet që kanë kushte të rënda, ku përparësi kanë fëmijët që janë jetimë, por edhe familje tjera që nuk kanë kulm mbi kokë dhe që njëkohësisht kanë edhe truall të tyre. Gjithashtu, në bashkëpunim me Komunën, kanë përkrahur rreth 500 familje me pako ushqimore.

Kemi kërkuar zyrtarisht bashkëpunim me organizatën Milenium Kosova për renovimin e Objektit të Banimit Social 01 si dhe për renovimin e një shtëpie për një familje në nevojë. (nuk kemi marrë përgjigje)

Kemi bashkëpunuar me organizatën gjermane ASB, pranë së cilës kemi adresuar dy projekte për përkrahje, një për investim në pajisje dhe renovim të qendrës HANDIKOS (refuzim), si dhe për renovim dhe investim në pajisje të kuzhinës për Shoqatën e Pensionistëve në Malishevë (projekt i pranuar dhe i realizuar).

Kemi bashkëpunuar me organizatën që financohet nga Qeveria Gjermane, Help Kosova, më ç' rast kemi nënshkruar kontrata për grante me 27 përfitues nga komuna e Malishevës.

Kemi firmosur një marrëveshje bashkëpunimi me organizatën zvicerane ABSM, në fushën e arsimit profesional.

REALIZIMI I PLANIT TË PUNËS SIPAS DREJTORIVE

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE - DShP

Drejtoria e Shërbimeve Publike në vitin 2022 është angazhuar maksimalisht për kryerjen e detyrave të punës të parapara në kuadër të planifikimeve të fushës së veprimtarisë së vetë në realizimin e projekteve sipas ndarjeve buxhetore, si dhe të parapara sipas ligjeve në fuqi.

Punët e realizuara nga DShP për vitin 2022 janë:

- ✓ Shpallja dhe caktimi i linjave, rendin e udhëtimit për transportin publik të udhëtarëve për të gjitha kompanitë që kryejnë këtë shërbim në vendbanimet e komunës së Malishevës për vitin 2022.
- ✓ Mbikëqyrja e ofrimit të shërbimeve publike lokale, duke përfshirë furnizimin me ujë, rrjetin e ujësjellësit, rrjetit të kanalizimit, mirëmbajtjen verore dhe dimërore.
- ✓ Mbikëqyrja e operatorit ekonomik për shërbimet e auto-merimangës (zhvendosja dhe bllokimi i automjeteve) sipas kontratës nr: 03/39 datë 23.07.2021. Te hyrat nga shërbimet e auto-merimangës për vitin 2022 janë 204.00 €
- ✓ Furnizimi dhe shërbimi i dekorimit të qytetit për festa zyrtare kombëtare dhe shtetërore.
- ✓ Shenjëzimi vertikal dhe horizontal i rrugëve në territorin e Komunës së Malishevës.
- ✓ Largimi dhe trajtimi i deponive inerte ilegale në territorin e Komunës së Malishevës.
- ✓ Mbikëqyrja e realizimit të shërbimeve që janë ofruar nga Bashkësia Islame në Malishevë sipas marrëveshjes së nënshkruar me nr: 01/22 e lidhur me datë: 22.01.2021 në mes Kryetarit të Komunës dhe BIK në Malishevë, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit.
- ✓ Bashkëpunimi dhe koordinimi me KEDS për rregullim të TS (trafo stacioneve) dhe rrjetit elektrik në fshatra.
- ✓ Kemi bashkëpunuar me kompaninë që ofron shërbime rreth furnizimit dhe kyçjeve në sistemin e ujësjellësit, si dhe jemi koordinuar me kompaninë në de bllokimin e kanalizimeve të ujërave të zeza në bazë të kërkesave të paraqitura nga qytetarët sipas marrëveshjes së bashkëpunimit nr: 01/468 datës 29.03.2018.

Menaxhimi i Mbeturinave

Në kuadër të menaxhimit të mbeturinave në komunën tonë, DShP ka një bashkëpunim me JICA, në projektin për Ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave drejt një shoqërie të shëndoshë faza II, ku përmes këtij projekti kemi punuar shumë për Reformën e Taksës së

Mbeturinave dhe Edukimin Mjedisor, e që pritet të vazhdojnë edhe në vitin vijues 2023 deri në zbatimin e plotë të këtij projekti.

Pilot Projekti PP1(Edukimi Mjedisor)

Për këtë pilot projekt kemi formuar grupin punues komunal të përberë nga zyrtarë të nevojshëm për rezultate më të mira, duke përfshirë në radhë të parë edhe zyrtar nga drejtoria e Arsimit. Ky grup ka caktuar dy shkolla në bashkëbisedim me drejtorë të shkollave. Me rekomandim të JET një shkollë është në zonën rurale dhe tjetra në atë urbane, ku dhe kanë filluar me realizimin e programit.

Pastaj u organizua nga JET trajnimi për arsimtarët e caktuar në lidhje me programin e ligjëratave që ka për qëllim ngritjen e vetëdijes sidomos për vendosjen e një rregulli fillimisht nëpër shkolla për ndarjen e mbeturinave në burim.

Është arritur edhe marrëveshja në mes të Komunës dhe dy shkollave për mbledhjen e mbeturinave të riciklueshme nga Kompania "EMIRI METAL" dhe "FMB GROUP" me seli në Malishevë, ku transportin e këtyre materialeve është zotuar që do ta bëjë Ekoregjioni, njësia në Malishevë.

PP4(Reforma e taksës së mbeturinave)

Në lidhje me këtë pilot projekt kemi krijuar grupin punues për Rregulloren komunale për mbeturina, dhe pas përfundimit të këtij dokumenti, drafti pritet të marrë aprovimin e Asamblesë, lidhur me këtë jemi duke bashkëpunuar edhe ekspertë të jashtëm.

Kemi grumbulluar të dhëna sa i përket shpenzimeve dhe të hyrave për tri vitet e fundit të ndërmarrjes publike Ekoregjion, dhe tani kemi një pasqyrë më të qartë për këtë çështje.

Është kryer edhe pilot projekti "Time and Motion Study" i cili do të na ndihmojë për një planifikim më efikas sa i përket grumbullimit të mbeturinave dhe planifikimit të itinerarit (lëvizjes së kamionëve)

Janë ndarë tri lokacione për deponimin e mbetjeve nga ndërtim dhe një lokacion për Transfer Stacion, kjo do të reduktojë në një masë depozitimin përfundimtar në deponin qendror të mbeturinave.

Është formuar grupi punues për reformën e taksës, dhe është duke u punuar në hartimin e legjislacionit për të zbatuar këtë reformë.

Kemi bashkëpunuar me Drejtorinë e Urbanizmit në hartimin, realizimin dhe mbikëqyrjen e projekteve në kuadër të veprimtarisë në fushën e shërbimeve publike si: rrugët, trotualet, furnizimet me ujë, kanalizimet e ujërave të zeza, ndriçimit publik, gjelbërimit, etj.

Kemi dhënë vendime, pëlqime për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirave publike për reklamim dhe ushtrim të aktivitetit biznesor, si dhe vërtetime për student dhe raste sociale.

Dokumente të lëshuara nga drejtoria me protokoll në zyrën pritëse dhe të brendshëm, në total janë 426.

Kemi shpallur konkursin për banim social në objektin e banimit social 02 dhe janë përzgjedhur 5 familje përfituese. Të hyrat financiare nga pagesat e qirasë joprofitabile për OBS-(01 dhe 02): 2363.2 €.

Kemi mbikëqyrur mirëmbajtjen e ndriçimit publik në afat tre vjeçar, 2022 – 2024.

Kemi bërë menaxhimin, kontrollimin dhe pastrimin e hapësirave publike, shesheve, varrezave të dëshmorëve, të 15 maturantëve, si dhe pastrimin e rrugëve të qytetit me ujë sipas marrëveshjes nr: 03/07 datë 01.04.2021, në mes të Komunës së Malishevës dhe Ekorrigjionin Jugor - Sh.A.

Kemi kryer punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së DShP-së.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE - DSHMS

DShMS gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 është marrë me organizim dhe monitorim të procesit të punës brenda stafit të drejtorisë, monitorim të punës brenda Qendrës për Punë Sociale, si dhe monitorimin permanent të punës brenda Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë, dhe përmes drejtorit të QKMF-së, përcjellje të punës edhe në QMF-të, AMF-të në gjithë territorin e Komunës së Malishevës.

Përvec aktiviteteve në funksion të realizimit të planit të punës të kësaj drejtorie, e të cilat do t'i përmendim më poshtë, ndër aktivitetet kryesore të drejtorit të DShMS-së gjatë kësaj periudhe janë edhe këto:

Bashkëpunimi me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike

Takim me qytetarët në fshatin Marali, së bashku me Kryetarin e Komunës dhe një pjesë të ekzekutivit,

Vizita sipas nevojës në QKMF-në në Malishevë, së bashku me Kryetarin e Komunës,

Takim me qytetarët në fshatin Llapqevë, së bashku me Kryetarin e Komunës dhe një pjesë të ekzekutivit,

Takim me qytetarët në fshatin Panorç, së bashku me Kryetarin e Komunës dhe një pjesë të ekzekutivit,

Takim me qytetarët në fshatin Bubël dhe Damanek, së bashku me Kryetarin e Komunës dhe një pjesë të ekzekutivit

Takim me pronarët e barnatoreve të komunës së Malishevës, etj.

DShMS, gjithashtu ka kryer punët e saj konform planit, si dhe angazhime shtesë, sipas nevojës, por shumë të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës në nivel te drejtorisë.

Stafi i DShMS, vec a angazhimeve të zakonshme, ka marrë pjesë edhe në trajnime të ndryshme dhe me interes për punën e kësaj drejtorie.

Gjithashtu, stafi përkatës ka punuar edhe në funksion të përkujdesjes ndaj familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të UÇK-së, ku qytetarët që i përkasin kësaj kategorie, janë pajisur me vërtetime për familje të dëshmorëve, për familjarë të të zhdukurve, viktimave civile dhe të plagosurve civil, dhe i kemi udhëzuar për plotësim të dokumentacionit për përfitim të benificionit sipas Ligjit Nr.04L-54 .

Gjithashtu, edhe zyra për sigurimin pensional dhe shëndetësor gjatë kësaj periudhe raportuese ka kryer punët dhe detyrat e punës të përcaktuara sipas kompetencave dhe autorizimeve që kanë.

Po ashtu, edhe zyra për shëndet primar, publik mental në vazhdimësi është marrë me pranimin e pacientëve të lajmëruar dhe të sëmur mental, si dhe ka bërë konsultat me familjarët e pacientëve.

Raporti i QKMF “Shpëtim Robaj” në Malishevë

Viti 2022 mund të konsiderohet më i qetë sa i përket gjendjes së pandemisë me COVID-19 në territorin e Komunës së Malishevës por edhe më gjerë.

Pandemia me virusin e quajtur Covid-19, ka bërë që të gjithë menaxherët e Institucioneve Shëndetësore të lënë me një anë për një kohë planet dhe objektivat e planifikuara në fillim të vitit dhe të organizohen në forma të ndryshme për tu përballur me pandeminë.

Duke qenë se ne u gjendem në një situatë tashmë të njohur, atëherë fokusi ynë kryesor ishte menaxhimi i pandemisë, me theks të veçantë Vaksinimi i popullatës, duke u munduar që të minimizojmë problemet shëndetësore të pacientëve të prekur me Covid 19, por në të njëjtën kohë duke mos lënë anash edhe objektivat dhe qëllimet tona të cilat ishin përcaktuar në fillim të vitit, qëllime këto të cilat gjithmonë kanë në qendër përmirësimin e cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore në institucionet tona.

Objektivat dhe qëllimet që ishin përcaktuar në fillim të vitit 2022 kanë filluar të finalizohen përgjatë tremujorit të parë të vitit dhe me të drejtë ne këtë vit mund ta quajmë: vit i sfidave dhe vit i realizimit të projekteve më të mëdha që deri më tani që janë arritur në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë.

Është i njohur fakti se institucionet shëndetësore funksionojnë atëherë kur janë të fuqizuara tri shtylla të forta:

- I. Staf të mjaftueshëm profesional për jetësimin e konceptit të Mjekësisë Familjare,
- II. Infrastrukturë të përshtatshme, kushte të punës për staf dhe pacientë,
- III. Pajisje të sofistikuara-bashkëkohore, material sanitarë, administrativ dhe higjienik të mjaftueshëm si dhe të realizuar në kohë.

Nisur nga shtylla e parë, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Malishevë përkundër stafit me kontrata të rregullta, ne kemi pranuar staf mbështetës nga Ministria e Shëndetësisë me mjekë dhe infermierë të cilët kanë vazhduar të na mbështesin deri më 15 Qershor .

Mbështetur në këto kapacitete, institucioni ynë shëndetësor ka arritur të realizojë shërbime në çdo shtëpi ku është paraqitur nevoja, duke bërë mjekim, referim si dhe kujdes gjatë referimit. Pasi që në këtë tremujor të vitit 2022 të vështirë kishim mungesën me staf dhe kuadro të duhura në institucionin tonë, atëherë angazhimi ynë si menaxher ishte të sigurojmë kushte për të ofruar shërbime mjekësore si: aparatura, material sanitar, material higjienik dhe masa mbrojtëse të cilat janë të domosdoshme për punë.

Planifikimi

Angazhimi i stafit menaxherial në QKMF Malishevë nga fillimi i vitit është fokusuar në vlerësim të nevojave të institucionit, inicimin e kërkesave, ndërsa mbështetja nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Kuvendit Komunal ka bërë të mundur realizimin dhe finalizimin e kërkesave tona.

Investimet kapitale të cilat janë paraparë që të realizohen gjatë këtij tremujori sipas kërkesave tona kane filluar të realizohen.

Problem kryesor në QKMF Malishevë tani për tani është mungesa e stafit profesional (mjekeve) gjë për të cilën kemi pasur vështirësi dhe mbingarkesë të mjekëve me orë shtesë si në QKMF, në QMF dhe në vizitat shtëpiake.

Problem tjetër në QKMF Malishevë është mungesa e furnizimit me medikamente nga lista e barnave esenciale nga Ministria e Shëndetësisë, të cilat po i vështirësojnë shërbimet ndaj qytetareve.

Aparaturat dhe materialin tjetër medicinal, do ti prezantojmë në formë tabelave, të përshkruara në detaje vendin dhe llojin e investimeve, llojin e aparaturave dhe materialin tjetër shpenzues. Të gjitha këto investime në institucionet tona janë të prekshme dhe në shërbim të qytetarëve ku çdo ditë po rrisim cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe rrjedhimisht po rritet kënaqësia e pacientëve të komunës tonë dhe pacientëve të komunave tjera përreth të cilët marrin shërbim në qendrën tonë.

Janë realizuar :

Kontrata dy vjeçare për furnizim me filma të rëntgenit me vlerë 33740 €

Aktivizimi i dy aparateve të Ultrazërit për shërbimin e Gjinekologjisë.

Realizimi i kontratës për furnizim me material stomatologjik

Furnizimi me aparate klimatizues për 18 ordianca me vlerë 5415 €

Realizimi i gjashtë konkurseve për rekrutimin e stafit (tre mjek dhe tre infermier)

Pajisja e QMF Kijevë me një EKG, Defibrilator, shtrat për pacient, karrocë për bartjen e pacienteve, ulëse për pacient, paravan, Donacion nga KFOR-i Italian.

Është realizuar Dezinsektimi, deratizimi, dezinfektimi i QKMF-se, QMF-ve dhe AMF-ve, me kontratë nga Prokurimi.

Finalizimi i projektit dy vjeçar për vizita shtëpiake (dy mjek, 29 infermierë, një shofer, një punëtor ndihmës, tre punëtor për mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore) me kontratë të prokurimit.

Është bërë rregullimi i kulmit, me rekomandimin e inxhinierëve është bërë tërheqja e kulmit si dhe është duke u bërë izolimi sipas projektit të inxhinierëve me kontratë të prokurimit.

Rregullimi i oborrit të QKMF-së është në fazën finale.

QKMF-ja me konkretisht shërbimi i Laboratorit është pajisur me aparaturë të re dhe moderne.

Është realizuar kontrata për furnizim me material sanitar për nevojat e QKMF-së me kontratë të prokurimit me vlerë 26887 €

Është realizuar kontrata për Stomatologji me vlerë 804 €

Aktivitetet

Takimet dhe kontaktet e rregullta me DShMS, MSH, IKSHIP dhe IRSHP

Mbledhjet e rregullta çdo dy javë me Shefat e shërbimeve, për organizimin e punës në shërbime, vërejtjet, sugjerimet dhe detyrat.

Takimet e rregullta ditore me Koordinatorin e cilësisë për mbarëvajtjen e punës, vërejtjet, sugjerimet dhe raportet për gjendjen e cilësisë së shërbimeve .

Takimet e rregullta ditore me Kryeinfermierin për koordinim dhe mbarëvajtje të procesit të punës

Organizimi i ligjëratave për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional të stafit.

Trajnimet e rregullta të stafit të organizuara nga MSH, OJQ-të dhe shoqatat profesionale.

Takimet e rregullta me Donatorët dhe grupet tjera të interesit.

Krijimi i grupit për auditimin e brendshëm për mbledhjen e participimit.

Aktivizimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave.

Formimi i komisionit disiplinor.

Formimi i komisioneve të veçanta për pranimin e materialit dhe aparaturës.

Vizitë në QKMF-të e tjera për informimin dhe njoftimin me modelet e implementimit të SISH-it.

Vizita në QMF Kijevë dhe Bellanicë me qëllim të ofrimit të bashkëpunimit dhe furnizimit me material të nevojshëm për punë, si dhe mbështetje të vazhdueshme.

Takim të rregullt me Komandantin e Policisë, për të konfirmuar bashkëpunimin ndërinstitucional.

Takim me përfaqësuesit e KFOR-it- LMT-në kuadër të bashkëpunimit dhe informimit me aktivitetet e shëndetësisë në Malishevë.

Shërbimet në QKMF, QMF dhe AMF

Puna e stafit në të gjitha institucionet tona përbën një kapitull të rëndësishëm në këtë raport si: Gjinekologji, Interno, Pediatri, Stomatologji, Laborator, RTG, ECHO, Vaksininim, Kartotekë, Barnatore, Depo, Mjekësi Familjare, Urgjencë, vizita për nënat dhe fëmijët deri në moshën 3 vjeçare, Vizita në familje dhe përkujdesje të drejtpërdrejtë me pacientë me Covid 19. Stafi i Administratës, stafi i Autoparkut, Higjienë mbajtës dhe stafi mirëmbajtës, të gjithë kanë kontribuar në forma të ndryshme në ndihmë të pacientëve, me punën e tyre dhe detyrat të cilat i kanë në kontratë.

Më pas do të paraqesim raportin e punës për të gjitha shërbimet për dymbëdhjetë mujorin e vitit 2022 ku nga të gjitha institucionet tona gjatë kësaj periudhe janë ofruar:

273499 vizita dhe shërbime mjekësore.

Vizitat dhe shërbimet në institucionin tonë për dymbëdhjetë muaj janë si vijon:

Raporti dymbëdhjetë mujor	TM1	TM2	TM3	TM4	Gjithsej
Gjinekologjia	2103	2147	2278	2162	8690
Interno	1975	1414	1860	1911	7160
Stomatologji	1588	1289	1664	1252	5793
Ultrazë	902	877	923	1062	3456
Laboratori	5609	3866	5378	4207	19060
Pediatri	3374	3147	4329	3815	14665
Vaksininim anti Covid					
Vaksininim i rregullt	2039	4520	1925	3635	12119
Mjekësia Familjare	13317	10995	15470	11945	51727
Intervencat	11708	10022	12536	8979	43345
Infuzione	4014	6130	9027	6164	28455
Urgjenca	7029	6778	10178	6215	30200
Lidhëtorja	1061	1217	1319	1290	4887

RTG	1654	1363	1581	1388	5986
Testime për Covid-19					
Kijevë	MF.2688	MF.2231	MF.3325	MF.2544	10788
	Pediatria.686	Pediatria.503	Pediatria.666	Pediatria.758	2613
	Stom. 362	Stom.282	Stom.199	Stom.238	1081
	sher inf .4014	Sher.inf.2774	Sher.inf.4098	Sher.inf.3508	14394
Bellanicë	565	696	561	570	2392
Llazicë	63	47	58	66	234
Drenoc	283	385	160	472	1300
Panorc	184	39	48	382	653
Llapqevë	0	0	0	26	23
Lubizhdë	0	0	0	0	0.0
Dragobil	39	58	47	57	196
Pagarushë	87	35	16	148	286
Kravasari	246	261	254	218	979
Carrallukë	76	31	0	178	275
Terpezë	6	0	5	12	23
Berishë	0	0	0	0	0.0
Vizita shtëpiake	325	131	185	463	1104
Pickime nga rriqrat	1	817	207	17	1042
Të udhëzuar					4
Participimi	12950 €	8983 €	15844 €	12511 €	50288
Gjithsejtë	69026	61989	78418	64066	272930

Menaxhimi i rasteve të pickuara nga rriqrat

Rastet me pickim nga rriqrat paraqesin prapë një problem të madh për komunën tonë edhe pse shifrat kanë tendencë rënie, rreziku nga infeksioni vazhdon të mbetet i njëjtë. Gjatë vitit 2022 kanë qenë 1042 rastet të pickuara nga rriqrat, prej tyre 4 raste kanë qenë të udhëzuar në Klinikë .

Ne si staf menaxherial do të angazhohemi në realizimin e objektivave dhe qëllimeve tona, gjithmonë duke pretenduar të rrisim cilësinë e shërbimeve, gjë që është edhe objektivi kryesor i Mjekësisë Familjare. Shpresojmë në një bashkëpunim të mirë me të gjithë bashkëpunëtorët në QKMF e po ashtu një mbështetje nga strukturat e Kuvendit Komunal, kompetent për të udhëhequr Kujdesin Parësor në Komunën e Malishevës.

DREJTORIA E URBANIZMIT - DU

Drejtoria e Urbanizmit, duke u mbështetur në fushë veprimtarinë e vet dhe planin e punës për vitin 2022, angazhimet e veta i ka fokusuar në realizimin e projekteve kapitale nga viti 2021 (projektet dyvjeçare) dhe përgatitjen e materialeve, paramasave dhe parallogarive për projektet e vitit 2022 në lëmin e infrastrukturës publike.

Për vitin 2022 janë planifikuar projekte të infrastrukturës publike si ndërtimi-asfaltimi i rrugëve lokale, ndërtimi vazhdimi i trotuareve në qytezë dhe në fshatra, ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza, renovimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, renovimi objekteve të shkollave fillore dhe të mesme, ndriçimi publik, investimet në shëndetësi, arsim, sport, kulturë dhe mirëmbajtja e kanalizimeve të ujërave të zeza nëpër fshatra dhe qytezë.

Projektet e infrastrukturës publike të realizuara në vitin 2022 janë si më poshtë:

- Ndërtimi dhe asfaltimi i 25.82 km rrugë lokale
- Ndërtimi i rrugës kryesore “Ibrahim Mazreku” nga ura deri tek hyrja e ambulancës (faza e parë) l= 1300 m
- Renovimi dhe mirëmbajtja e 5.29 km të kanalizimeve të ujërave të zeza në fshatrat e Komunës (projekt trevjeçar)
- Ndërtimi i trotuareve në gjatësi prej 3.3 km
- Ndërtimi i aneksit të objektit të shkollës fillore në fshatin Marali dhe renovimi objekteve shkollore nëpër fshatra.
- Ndërtimi i tri fusha sportive në fshatrat Guriq, Berishë dhe Stapanicë
- Ndriçimi publik dhe renovimi i tyre nëpër fshatrat e Komunës së Malishevës

- Renovimi i objektit të gjimnazit “Hamdi Berisha” në Malishevë me programin e efijencës.
- Punimet në stadiumin e qytetit “Liman Gegaj” në Malishevë
- Trajtimi i deponive ilegale në territorin e Komunës së Malishevës
- Ndërtimi i rrugës “Habib Berisha” dhe rregullimi i palestrës sportive
- Ndërtimi i garazheve në QKMF (vazhdim), renovimi i objektit të QKMF-së dhe rregullimi i oborrit pullazit dhe rrethojës
- Ndërtimi i aneksit të çerdhes në Malishevë dhe ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në fshatin Kijevë
- Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve urbane dhe lokale
- Janë mbikëqyrë punimet sipas kontratave të projekteve kapitale të vitit të kaluar dhe në këto projekte dyvjeçare 2021/2022-të në rrugët e fshatrave; Bellanicë, Ngucat, Senik, Banjë dhe Temeqinë, ku kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik. Ndërsa një pjesë e rrugëve në fshatrat Bubavec, Kijevë, LLazicë, Stapanicë, Plloqicë, Vërmicë dhe Mleqan edhe ato janë në përfundim e sipër, vetëm pritët pranimi teknik i tyre.
- Përgatitje e paramasave për asfaltimin e rrugëve lokale në fshatrat; Carrallukë, Shkarashnik, Panorc, Turjakë, Banjë, Pagarushë, Damanek, Astrazup, Bubël, Burim, Dragobil, Gurbardhë, Gajrak, Guriq, Lumnishtë, Lladrovc, Mirushë, Rud, Terpezë e Ulët dhe qytezën e Malishevës, ku një pjesë veç janë kontraktuar dhe pjesa tjetër është në procedure të prokurimit projekte të financuar nga qeveria komunale. Vlen të ceket fillimi i punimit asfaltimi të rrugës Gurbardh –Turjakë, projekt i financuar nga Ministria e Infrastrukturës.
- Përgatitje për fillimi e punimeve të kanalizimeve të ujërave të zeza Loti-1 fshatrat; Banjë, Bellanicë, Senik, Temeqinë, Ngucat, Bardhë, Lladrovc, Tërpezë , Shkarashnik dhe Fshati i Ri, ku në shumicën e fshatrave janë realizuar, ndërsa punimi kanalizimeve të ujërave të zeza Loti-2 fshatrat; Carrallukë, Vërmicë, Drenoc, LLazicë, Mleqan, Bubavec, Balincë, Kijevë , Plloqicë dhe Stapanicë veç kanë përfunduar.
- Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza Loti-3 në fshatrat: Gurbardh, Maxharrë, Marali, Pagarushë, Burim, Kravasari, Janqist, Guriq, Dragobil, Shkozë dhe Astrazup janë në përfundim e sipër, ndërsa në fshatin Pagarushë është duke u punua ku edhe aty është në përfundim e sipër. Ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza Loti-4 në fshatrat; Malishevë, Mirushë, Turjakë, Damanek, Panorc, Bubël, Lumishtë dhe Llapqevë, kanë përfunduar dhe pritët pranimi teknik.
- Përgatitjet për ekzekutimin e punimeve për ndërtimin e trotuareve Loti-1 në fshatrat; Astrazup, Banjë, Bardh, Burim, Berishë, Janqist, Lladrovc, Marali, Pagarushë, Shkozë , Temeqinë, dhe Kravasari. Ndërsa, Loti-2 përfshinë fshatrat; Mleqan, Vërmicë, Tërpezë, Rud,

Tërpezë e Ulët, Shkarshnik, Stapanicë, Plloqicë, Llazicë, Drenoc, Damanek dhe Carrallukë dhe qytezën e Malishevës. Në këtë projekt deri tani janë përfunduar shumica e fshatrave dhe pritet të bëhet pranimi teknik i tyre, ndërsa një pjesë e vogël e trotuareve të fshatrave kanë mbetur të vazhdojnë dhe të përfundohen.

- Është punuar në projektin e ndriçimit publik dhe mirëmbajtjen e tij në fshatra dhe qytezë, projekt tre vjeçar, ku ka filluar implementimi i tij në disa fshatra dhe është duke u realizuar. Projekt tjetër është ndërtimi i rrugëve fushore ku deri tani gati të gjitha janë hapur, pritet të shtrohen me zhavorr dhe të bëhet pranimi teknik i tyre.
- Është punuar në Planin Zhvillimor Komunal (2017-2025), projekti për hartat zonale, ku janë mbajtur disa takime dhe janë shtjelluar shumë tema me interes për territorin e Komunës sonë, dhe është duke vazhduar që brenda këtij viti të konkretizohet si projekt, që është duke u financuar nga ana e GIZ-it Gjerman dhe Kuvendit Komunal. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar edhe takime pune me Ministrinë e Planifikimit rreth procedurave për finalizimin e hartës zonale për komunën e Malishevës, ku është dorëzuar materiali rreth raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis.
- Ka vazhduar ndërtimi i zhveshtoreve dhe tribunave në stadiumin e qytetit, ku është duke u punuar. Janë përgatitur paramasat edhe për pjesën tjetër të zgjerimit të tribunave dhe terrenit ndihmës të fushave sportive. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe është vazhduar me finalizimin e ndërtimit të aneksit të çerdhes në Malishevë dhe ndërtimi i çerdhes në fshatin Kijevë ku dhe pritet funksionalizimi i tyre.
- Janë bërë aplikimet në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për projektin mirëmbajtja e rrugës lokale Lumishtë – Llapqevë, pastaj në projektin tjetër në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal rreth projektit të ndërtimit të çerdhes së fëmijëve në fshatin Bellanicë, si dhe aplikimi në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal me projektin për rregullimin e parkut tek liqeni Mirusha.
- Është punuar në rregullimin e garazheve dhe rrethojës në shtëpinë e shëndetit Dr. “Shpëtim Robaj” në Malishevë.
- Është punuar në ndërtimin e rrugës kryesore “Ibrahim Mazreku” nga ura e madhe deri tek transiti i shkollës profesionale, projekt ku planifikohet të zgjerohet rruga dhe gjithë infrastruktura nëntokësorë të punohet.
- Është vazhduar me implementimin e programit të efikasitetit në katër objekte publike; shtëpia e kulturës “Tahir Sinani”, shkolla e mesme e lartë “Hamdi Berisha”, QKMF “Shpëtim Robaj” dhe shkolla e mesme profesionale në Kijevë, i financuar nga Fondi i Efikasitetit Kosovare, ku deri tani janë në përfundim e sipër.

- Është hapur konkursi për Projektim Arkitektonik dhe Urbanistik për “Ndërtimin e Sheshit së bashku me parkingun nëntokësor në qytetin e Malishevës” i cili konsiderohet si projekti më i madh i realizuar në komunën e Malishevës.
- Është kontraktuar ndërtimi i rrugës që nis nga shkolla profesionale Qendra e Kompetencës rruga “Habib Berisha” që kalon ka restorant “Princesha Palace” që lidhet me rrugën e unazës së qytetit deri të stadiumi i qytetit “Liman Gegaj”.
- Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit është lidhur kontrata për renovimin e objektit të vjetër të shkollës fillore “Naim Frashëri” në Banjë, që do të shërbej si çerdhe për fëmijë.
- Dhe për fund, në Drejtorinë e Urbanizmit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, janë parashtruar gjithsejtë 388 kërkesa, ku 209 kërkesa janë realizuar (leje ndërtimore, kushte urbanistike, vërtetime, pëlqime, leje përdorimi, leje mjedisore dhe legalizime) dhe 179 kërkesa janë në shqyrtim. Të hyrat financiare në drejtori gjatë kësaj periudhe janë në vlerë prej 147,646.00 euro.

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL - DBPZHR

Drejtoria e Bujqësisë duke u bazuar në buxhetin dhe Planin e punës për vitin 2022, dhe në kërkesat e fermerëve, këtë vit ka realizuar një numër të madh të projekteve dhe aktiviteteve ku janë ndihmuar fermerët dhe ekonomit bujqësorë në rritjen e produktivitetit për sektorët prioritar. Bujqësia në Komunën e Malishevës, ka filluar të zhvillohet duke u bazuar në angazhimet e bujqve lokal dhe është njëra prej degëve kryesore të zhvillimit ekonomik. Mundë të thuhet se një pjesë e madhe e territorit të Komunës është e mbuluar me tokë pjellore dhe ka klimë të përshtatshme që garanton prodhimtari ekonomike dhe profitabilitet të drithërave, pemëve, perimeve dhe blegtorisë.

Projektet e realizuara nga DBPZHR për vitin 2022

1. Subvencionimi i sektorit të bletarisë me pagesa direkte

Janë përkrahur 124 bletarë përkatësisht janë subvencionuar 5000 shoqëri bletësh, ku për secilën shoqëri bletësh ka qenë subvencionimi me nga 4 Euro, ndërsa vlera e përgjithshme e këtij projekti ka qenë 20,000.00 euro



Foto nga tereni gjatë verifikimit të bletarëve

2. Përkrahja e blegtorëve me subvencionim të qumështit përmes pagesave direkte

Ky projekt është i organizuar në dy periudha të aplikimit (çdo 6 muaj), për 6 mujorin e parë të këtij viti kanë përfituar 81 fermerë të cilët dorëzojnë qumësht në pikat grumbulluese të qumështit me 0.03 euro për litër të qumështit, përkatësisht janë subvencionuar 984,153.33 litra qumësht. Vlera e përgjithshme e këtij projekti është: 29,524.60 Euro.



Foto nga vizitat e dorëzimit të qumështit në pika grumbulluese

3. Subvencionimi i fermerëve me sera të tipit tunel me sipërfaqe prej 50 m²

Në kuadër të zhvillimit të bujqësisë - perimekultures, Drejtoria për Bujqësi, ka përkrahur 50 fermerë, për ngritjen e serave me sipërfaqe prej 50 m². Në këtë projekt, Komuna ka kontribuar me 70% të vlerës së përgjithshme të serës, ndërsa fermeri ka participuar me 30% të vlerës.

Vlera totale për një serë në bazë të kontratës së prokurimit ka qenë 755.35 Euro, ndërsa vlera e përgjithshme e projektit ka qenë; 37,767.50 Euro.

4. Përkrahja e fermerëve (blegtorëve) me bidonë për bartjen e qumështit

Drejtoria e Bujqësisë ka publikuar thirrjen publike për aplikim për fermerët të cilët dorëzojnë (bartin) qumësht nëpër pika grumbulluese të qumështit. Në këtë projekt janë paraparë të përkrahen fermerët me 150 bidonë, ku ndarja e tyre do të bëhet në bazë të sasisë së qumështit për secilin fermerë. Ky projekt deri më tani është në procedura të prokurimit.

Aktivitetet e realizuara nga DBPZHR për vitin 2022

Drejtoria e Bujqësisë për këtë periudhë të punës përveç aktiviteteve që ka pasur në pritjen e palëve, pranimin e kërkesave nga ana e fermerëve, përgjigjen e ankesave, përgatitjen e vërtetimeve për viza turistike për ata fermer që merren me bujqësi, regjistrimin e fermerëve në programin e AZHB-së dhe lëshimin e NIF – it (numri identifikues i fermerit), konsultime me fermerët të cilët nuk kanë pasur njohuri rreth bujqësisë, mënyrës së aplikimeve për subvencione dhe sqarime rreth procedurave të aplikimit, ka kryer edhe punë të tjera si më poshtë:

- Thirrja për aplikim për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, therjet e raportuara të gjedhit, viçat për majmëri dhe akuakulturë për gjashtëmujorin e dytë 2021.

Prej datës 21.01.2022 deri me 11.02.2022 stafi i Drejtorisë së Bujqësisë ka qenë i angazhuar në aplikimin e fermerëve për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, viçave për majmëri dhe therjet e raportuara të gjedhit për gjashtëmujorin e dytë 2021, që i ndanë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Gjatë kësaj periudhe në Drejtorinë tonë për këtë masë kanë aplikuar 34 fermerë.

Duke u bazuar në dëshminë për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose në pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara del se për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021 këta fermerë kanë dorëzuar 688,395.00 litra qumësht.

- Thirrja për aplikim për pagesa direkte për vitin 2022

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka hapur thirrjen për aplikim për të gjithë fermerët e interesuar që të aplikojnë për mbështetje përmes Programit për Pagesa Direkte për vitin 2022. Këto procedura të aplikimit janë kryer në Drejtorinë e Bujqësisë në Malishevë, nga stafi i drejtorisë, ku i gjithë stafi merret me procedurat e publikimit të thirrjes, përgatitjen e dokumentacionit, sqarime tek fermerët rreth procedurave për aplikim, si dhe digjitalizimin e parcelave të mbjellura.

Statistikat e përgjithshme të sipërfaqeve të kulturave lavërtare, perimtare, pemëtare, vreshtave, bimëve mjekësore aromatike si dhe fondi blegtoral, shpezëve, dhe bletarisë, në Komunën e Malishevës.

Tabela 1. Të dhënat e sektorëve për vitin 2022 në Komunën e Malishevës

Nr.	Sektorët	Lloji	Njësia matëse	Hektar/krerë/koshere/copë
1.	<i>Spektori i Lavërtarisë</i>	Grurë	Ha	2,225
		Misër	Ha	936
		Elb	Ha	14.54
		Thekër	Ha	
		Tërshërë	Ha	206
2.	<i>Spektori i Pemëtarisë</i>	Molla	Ha	126.64
		Dardha	Ha	14.52
		Ftoni	Ha	3.04
		Kumbulla	Ha	15.71
		Pjeshka	Ha	1.45
		Qershia	Ha	2.81
		Vishnja	Ha	8.24
		Arra	Ha	55.87
		Lajthia	Ha	0.51
		Mjedra	Ha	0.38
3.	<i>Spektori i Perimtarisë</i>	Domate	Ha	
		Spec	Ha	0.15
		Kungull	Ha	0.70
		Tranguj	Ha	
		Shalqiri	Ha	3.49
		Pjepri	Ha	
		Lakra	Ha	2.77

		Qepa	Ha	7.18
		Patate	Ha	2.12
		Fasule Monokultur	Ha	2.86
		Perime në Sera	Ha	0.51
4.	<i>Sektori i Vreshtarisë</i>	Rrush	Ha	51.08
5.	<i>Sektori i Blegtorisë dhe Shpezëtarisë</i>	Lopë Qumështore	Krerë	2064
		Dele	Krerë	4851
		Dhi	Krerë	738
		Pula Vojse	Copë	5550
6.	<i>Sektori i Bletarisë</i>	Bletë	Koshere	4485
7.	<i>Bimë Mjekësore dhe Aromatike</i>	BMA	Ha	1.82

Gjatë kësaj kohe të aplikimit për subvencione, në Komunë kanë aplikuar 941 fermerë, ku të gjitha këto aplikacione janë dorëzuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë, për procedura të vlerësimit dhe pagesave.

- Hartimi i Draft rregullore për përkrahjen e fermerëve dhe bizneseve në sektorin e bujqësisë

Me këtë draft rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë komunës të ndaj mjete financiare pa kthim nga kategoritë e subvencioneve dhe granteve për fushat e cekura në këtë draft rregullore për personat fizik dhe juridik.

- Thirrja për aplikim për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, therjet e raportuara të gjedhit, viçat për majmëri dhe akuakulturë për gjashtëmujorin e parë 2022.

Duke u bazuar në dëshminë për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose në pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara del se për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 e kemi këtë situatë sipas tabelës së mëposhtme;

Tabela 2. Sasia e qumështit të dorëzuar si dhe numri i krerëve të viçave për majmëri.

Numri i fermerëve aplikues	Sasia e qumështit të dorëzuar (litër)	Numri i viçave për majmëri (krerë)
62	743,538.00	366

▪ Dëmet në Bujqësi të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore elementare

Për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në bujqësi, Komuna ka formuar Komisionin profesional për vlerësimin e dëmeve në teren. Në Komunën e Malishevës kemi pasur dëme nga fatkeqësitë natyrore elementare gjatë muajve maj dhe korrik, ku ka shkaktuar dëme të mëdha në bujqësi.

Sektori më i dëmtuar ka qenë aj i pemëtarisë dhe vreshtarisë, pastaj ai i lavërtarisë, përkatësisht kultura e grurit i cili ka qenë në prag të fillimit të korrjes së tij, si dhe kulturat perimore.

Dëme nga fatkeqësitë natyrore elementare kanë pasur 21 fermerë si kultivues të kulturave të ndryshme.

Vlera e përgjithshme e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore elementare ka qenë 376,662.64 euro.



Foto nga terreni gjatë vlerësimit të dëmeve nga breshëri.

- Realizimi i mbjelljeve pranverore për vitin 2022

Në këtë vit sipas shënimeve të grumbulluara nga tereni në Komunën tonë kanë qenë të planifikuara të mbillen me kultura pranverore afër 1,337.30 ha, ndërsa janë realizuar 1,322.30 ha, që do të thotë se plani është realizuar rreth 98.89 % në përgjithësi.

Tabela 3: Struktura e mbjelljeve pranverore

Nr.	Kultura	Sipërfaqet e realizuara / ha
1	Misër me fasule	985
2	Misër për sillazhë	89
3	Tërshërë	36
4	Elb Pranveror	21
5	Patate	68
6	Thekër	5.3
7	Perime	91
8	Bimë Foragjere	27

- Shtabi i korrje-shirjeve

Me qëllim që procesi i korrje-shirjeve të ecë sa më mirë Drejtoria e Bujqësisë ka formuar Komisionin prej 5 anëtarëve të shtabit komunal.

Procesi i korrje-shirjeve në Komunën tonë zyrtarisht ka filluar më datë 05/07/2022. Në Komunën e Malishevës në këtë vit janë mbjellë 3587 ha sipërfaqe me drithëra të bardhë, ku Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural i ka bërë përgatitjet e nevojshme në mënyrë që ky proces mjaft i rëndësishëm të zhvillohet sa më mirë.

Tabela 4: Struktura e mbjelljeve me drithëra të bardhë

Nr.	Kulturat e mbjella	Sipërfaqja ha
1	Grurë	3504
2	Tërshërë	45
3	Elb	38



Foto nga terreni gjatë procesit të korrije-shirjeve

Fushata e korrije-shirjeve në territorin e Komunës së Malishvës ka përfunduar me afat optimal me datë 27/07/2022 dhe rendimenti mesatar i grurit ka qenë 3900 kg/ha.

▪ Realizimi i mbjelljeve vjeshtore për vitin ekonomik 2022-2023

Në këtë vit ekonomik sipas shënimeve të grumbulluara nga terreni dhe sipas aplikimit të fermerëve për subvencione në Komunën e Malishevës janë planifikuar të mbillen këto kultura lavërtarie: Gruri, Elbi, Tërshëra, si dhe Thekra, si kultura bujqësore të cilat mbillen zakonisht tek ne, dhe njëherit edhe më të domosdoshme për sigurimin e ushqimit të popullsisë dhe të bagëtisë.

Në sektorin privat janë planifikuar të mbillen rreth 3,248.00 ha me kultura lavërtarie, ndërsa janë realizuar 3548.5 ha

Tabela 5: Struktura e mbjelljeve vjeshtore për vitin ekonomik 2022-2023

Nr.	Kultura	Sipërfaqet e planifikuar	Sipërfaqet e realizuara
1	Grurë	3,153.00	3,460.00
2	Tërshërë dimërore	37	26
3	Thekër	11	13.5
4	Elb dimëror	29	33
5	Bimë foragjere	18	16
	Gjithsejtë:	3,248.00 ha	3,548.50 ha

Për mbjelljen e sipërfaqeve të lartcekura është e nevojshme edhe sigurimi i repromaterialit si; fara cilësore, plehu kimik me kombinim NPK, dhe derivatet e naftës.

Tabela 5.1: Sasia e repromaterialit të nevojshëm për mbjelljet e këtij viti

Nr.	Lloji i repromaterialit	Sipërfaqja në ha	Sasia në kg	Sasia e përgjithshme në kg/L
1	Farë gruri	3,460.00	250.00	865,000.00
2	Farë tërshëre	26	220	5,720.00
3	Farë thekre	13.5	200	2,700.00
4	Farë elbi	33	220	7,260.00
5	Farë foragjere	16	25	400.00
6	Plehra kimike	3,548.50	300	1,064.550.00 kg
7	Derivate të naftës	3,548.50	80	283,880.00 L

Në qoftë se mbretërojnë kushtet e mira agrometeorologjike, dhe të aplikohen të gjitha masat agroteknike, rendimentet nuk do të mungojnë.

Pylltaria dhe mbrojtja e pyjeve

Në periudhën prej janarit deri në dhjetor 2022 Njësia Pyjore Komunale Malishevës, në suaza të punëve dhe obligimeve në mbrojtjen dhe kultivimin e pyjeve publike në Njësinë Pyjore “Pyjet e Malishevës” si dhe në punët teknike profesionale në pyje publike dhe private në territorin komunal të Malishevës realizoj këto punë:

1. Shërbimi Juridik

Pasqyra e Fletëparaqitjeve për dëme pyjore për vitin 2022: Gjithsej 71, ku 15 janë penale dhe 56 kundërvajtje.

Pasqyra e Fletëparaqitjeve sipas Rajonit Pyjor dhe Rojës së Pyllit, dhe dëmi pyjor në M3; Gjithsej penale dhe kundërvajtje 72, dëmi 107.19 M3, si dhe dëmi në euro; 17298.03 Euro.

Pasqyra e seancave gjyqësore; Gjithsej 21, ku 12 janë penale, 8 kundërvajtje dhe 1 civile.

Pasqyra e Aktvendimeve dhe Aktgjykimeve për Nj.P.K; Gjithsej janë 106, ku 19 janë penale dhe 87 kundërvajtje, ndërsa dëmi në M3 është 159.73, derisa dëmi financiar është 25735.39 Euro.

2. Shërbimi Teknik

Pasqyra e zjarreve në pyjet publike për vitin 2022 në Njësinë “Pyjet e Malishevës”

Në total kanë qenë 2 zjarre të cilat kanë prekur rreth 56 hektarë, në rajonet pyjore; Mirusha dhe Dubrava.

3. Shërbimi profesional në pyjet private.

Gjatë periudhës janar –dhjetor të vitit 2022 nga pronarët e pyjeve private janë parashtruar 12 kërkesa për prerje dhe furnizim me drunj nga pyjet e tyre, janë kërkuar 107.00 M3 drunj zjarri prej të cilave janë realizuar 73.00 M3.

Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës janë konfiskuar gjatë kësaj periudhe 3.02 M3 drunj zjarri prej dëmtuesve ilegal nga pyjet publike.

Gjithashtu, janë bërë kontrole të rregullta të rrugëve dhe vendeve të ndryshme ku është evidentuar tregtim ilegal i drunjve të zjarrit.

Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës ishte i përhershëm sikurse me Inspektoratin Qendror të pyjeve të Kosovës në parandalimin e prerjeve ilegale të drunjve, uzurpimeve të tokave pyjore, ndërtimin pa dokumentacion sipas ligjit në tokat pyjore dhe në pyje, etj.

Gjithashtu, bashkërendimi i punëve me resorët tjerë Komunal ka qenë në nivel sikurse me Agjencionin Pyjor të Kosovës, Zyra Rajonale në Prizren, duke koordinuar punët profesionale dhe këshillimore.

Kërkesa për themelimin e dy vend gjuetie - Drejtoria e Bujqësisë ka bërë kërkesën për themelimin e dy vend gjuetie të përbashkëta në komunën tonë, duke u bazuar në Pëlqimin e MBPZHR të datës 10/02/2009, ku përcaktohen dy zona për vend gjueti të përbashkëta në Komunën e Malishevës, Zona 1 dhe Zona 2, si dhe bazuar në Ligjin për gjueti respektivisht në Udhëzimin administrativ MA-NR 10/2007.

Në pëlqimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me nr.280/2 të datës 10.02.2009 figurojnë 30,585.34 ha sipërfaqe pyjore në Komunën e Malishevës të ashtuquajtura:

“Malisheva 1” me sipërfaqe të përgjithshme prej 16,241.05 ha dhe

“Malisheva 2” me sipërfaqe të përgjithshme prej 14,344.29 ha

Ndërsa aprovimi i vendimit ka qenë i përfshirë në tërë sipërfaqen pyjore prej 30,585.34 ha të Komunës së Malishevës, ndërsa sipërfaqet në të cilat do të zhvillohen aktivitetet e gjuetisë në Komunën tonë janë:

Në vend gjuetinë “MALISHEVA 1” – 1505.01 ha

Në vend gjuetinë “MALISHEVA 2” – 13327.92 ha.

Mbrojtja e Pyjeve

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ligjor, DBPZHR ka bashkëpunuar ngushtë me Policinë e Kosovës në Malishevës, me qëllim të koordinimit ndërinstitutional për mbrojtjen e pyjeve në territorin e komunës tonë.

Vizitat dhe takimet me fermerë - Gjatë këtij viti kalendarik Drejtoria e Bujqësisë ka bërë vizita të shumta tek fermerët për t'i parë nga afër punët e tyre si dhe sfidat dhe kërkesat e tyre.



Foto nga tereni gjatë vizitës të fermerja, Fatime Limaj (Fshati Banjë)

Komuna e Malishevës ka mbajtur takim me fermerët (blegtorët dhe bletarët) me të cilët ka bashkëbiseduar rreth mënyrës së subvencionimit të qumështit për litër, dhe shoqërive të bletëve, që Drejtoria e Bujqësisë ka planifikuar që t'i përkrahë.



Foto gjatë takimit me fermerët blegtorë dhe bletarët

Po ashtu, janë mbajtur edhe takime të tjera me fermerë dhe agrobiznese për tu konsultuar rreth hartimit të Projekt Buxhetit të Komunës së Malishevës, konkretisht për sektorin e bujqësisë për vitin 2023.

DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCË DHE BUXHET – DEF

Drejtoria për Ekonomi, Financë dhe Buxhet, gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, ka bërë ofrimin e shërbimeve në mënyrë sa më efikase për drejtoritë tjera si dhe ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarë duke ofruar kryerje të shërbimeve, informacioneve sa më të sakta të të hyrave dhe shpenzimeve.

Në Drejtorinë për Ekonomi, Financë dhe Buxhet operojnë këto sektorë:

1. Sektori për Buxhet
2. Sektori i Tatimit në Pronë
3. Sektori për Financa
4. Sektori i Thesarit,
5. Sektori i regjistrimit të Biznesit dhe të Hyrave
6. Sektori për shpenzime dhe kontabilitet

Sektori për Buxhet

Ky sektor për vitin 2022 ka përgatit raportet buxhetore në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në bazë të buxhetit të aprovuar. Ka mbikëqyr shfrytëzimin dhe realizimin e buxhetit si dhe ka përgatitur buxhetin për vitin 2023 në koordinim me departamentet tjera dhe në bashkëpunim me qytetarët.

- Takimet me institucionet tjera dhe me qytetarë

Në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe Departamentet tjera Komunale kemi zhvilluar 4 dëgjime publike për përgatitjet dhe hartimin e projekt-buxhetit për vitin 2023, 2024 dhe 2025 me fokus te veçantë projekt-buxhetin për vitin 2023.

- Fushëveprimi specifik i këtij sektor
- Përgatitë raportet buxhetore javore dhe mujore në përputhje me aktet ligjore në fuqi
- Mbikëqyre shfrytëzimin-realizimin e buxhetit përmes programit “Free balance”

Sektori i tatimit në pronë

Në periudhën dymbëdhjetë mujore të vitit 2022, Zyra e Tatimit në Pronë në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi që ka, ka vazhduar t'i kryej obligimet e veta duke u bazuar mirë në legjislacionin në fuqi, respektivisht në baze të ligjit Nr. 06/L/005, Rregullores komunale për tatimin në pronë, si dhe në bazë të udhëzimeve administrative të lëshuara nga MEF.

Në Sektorin e Tatimit në Pronë gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2022 janë realizuar të hyra në vlerë prej **370,413.61 euro**.

- Takimet me institucionet tjera dhe me qytetarë

Takime me Departamentin e Tatimit në Pronë në MF, dhe Drejtoritë përkatëse të komunës.

Sektori i tatimit në pronë ka takime me palë çdo ditë sipas nevojës.

Kurse në zyrën e shërbimeve me qytetarë ku ofrohen shërbime për tatimpagues sipas kërkesë së tyre si dhe konsulta gjatë gjithë orarit të punës.

Ky sektor ka vazhduar të bëjë grumbullimin e tatimit në pronë, verifikimin e pronave të regjistruara, vjeljen e detyruar, plotësimin e të dhënave personale të tatim paguesve, shqyrtimin e ankesave-kërkesave të tatim paguesve, etj.

- Fushëveprimi specifik i këtij sektor

- Analiza e borxheve për tatim në pronë;
- Shpërndarja e faturave për tatim në pronë për palët e interesuara;
- Kontakton me borxhlinjtë të cilat kanë borxhe të mëdha;
- Mban evidencën e të hyrave nga tatimi në pronat e paluajtshme;
- Bënë identifikimin, klasifikimin dhe vlerësimin e pronës së paluajtshme;
- Përgatit faturimin për tatim në pronë për të gjitha pronat e paluajtshme
- Angazhohet dhe përcjell shpërndarjen e faturave të tatimit në pronë;
- Zhvillon vjeljen e detyruar sipas procedurave;
- Regjistrimi i pronave të reja dhe tatimpaguesve;
- Verifikimi i pronave të regjistruara dhe tatimpaguesve;
- Futja e të dhënave në sistem e tatimit në pronë;
- Bashkëpunon me Departamentin e Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave;
- Bashkëpunon me drejtoritë komunale përkatëse lidhur me pronat e paluajtshme;
- Lëshon certifikata-vërtetim për kryerjen e obligimeve të tatimit në pronë, sipas kërkesës së palëve;
- Kryen edhe punë të tjera, në bazë të Ligjit të tatimit në pronën e paluajtshme dhe akteve nënligjore.
- Regjistrime dhe modifikime në Sistemin e tatimit në pronë;

- Ekzekutimi i vendimeve të nxjerra nga Komisioni për ankesa dhe Sektorit i tatimit në pronë.
- Shqyrtimi i kërkesave për taksën në transaksion për pronën paluajtshme,
- Shqyrtimi i ankesave nga Komisioni komunal për shqyrtimin e ankesave
- Shqyrtimi i kërkesave nga Sektori i Tatimit në Pronë

Sektori për Financa

Në vitin 2022 ky sektor ka krye evidentimin dhe regjistrimin e pasurisë së Komunës, kontrollimin dhe mbikëqyrjen e të hyrave dhe të dalurave dhe miratimin e tyre sipas fondit, kodit dhe kategorive ekonomike. Planifikon, raporton dhe mban evidencën e të hyrave vetanake për të gjitha drejtoritë, pranimin e faturave, procedurat dhe shpenzimet e mjeteve buxhetore, alokimet-planin e zotimeve dhe planin e shpenzimeve (plani i keshit), si dhe raportimin e shpenzimeve të realizuara sipas drejtorive.

- Regjistrimi i të hyrave vetanake të mbledhura për periudhën Janar-Dhjetor 2022 në shumën prej 910,497.11 €
- Procedimi i pagesave prej zotimit-përpunimit-shpenzimit të mjeteve për periudhën Janar-Dhjetor 2022 në shumë prej 16,705 ,105.00 €, në përqindje 99.70%.
- Sipas menaxhimit të arkës janë grumbulluar të hyra për periudhën Janar-Dhjetor 2022 në vlerë prej 117,280.96 €.
- Janë realizuar të hyra nga taksa për automjete motorike në shumë prej 103,449.00 €.

3.1. Takimet me institucionet tjera dhe me qytetarë

Kemi takime dhe komunikime të vazhdueshme me Ministrinë e Financave rreth Raportimeve, këshillimeve, konsultime për buxhetet dhe ekzekutimin buxhetit . Gjithashtu janë mbajtur rregullisht takime me qytetarë

3.2. Fushëveprimi specifik i këtij sektor

- Evidentimi dhe regjistrimi i pasurisë së Komunës
- Koordinimi i punëve dhe zhvillimi i bashkëpunimit me sektorët tjerë të Drejtorisë, sipas dinamikës për harxhimin e buxhetit në bazë të rrjedhës së parasë
- Kontrollimi dhe mbikëqyrja e të hyrave dhe të dalurave dhe miratimin e tyre sipas fondit, kodit dhe kategorive ekonomike.
- Planifikon, raporton dhe mban evidencën e të hyrave vetanake për të gjitha drejtoritë

- Pranimi i faturave
- Procedurat dhe shpenzimet e mjeteve buxhetore
- Alokimet-Plani i zotimit dhe plani i shpenzimeve (plani i keshit)
- Zotimet
- Raportimi i shpenzimeve të realizuara sipas drejtorive
- Menaxhimi dhe raportimi i buxhetit;
- Raporti për periudhën Janar-Dhjetor 2022 nga Drejtoria e Financave për ZKA-Zyra e Kryetarit.
- Shpenzimet e pagesave të ndryshme nga zotimi deri te shpenzimi
- Regjistrimi i të hyrave në Free Falance
- Përcjellja e linjave buxhetore nga të hyrat vetanake për alokim të mjeteve
- Regjistrimi i pasurive komunale;
- Barazimi me drejtorit për bartjen e mjeteve nga të Hyrat vetanake nga vitet paraprake në vitin 2022.

Sektori i regjistrimit të Biznesit dhe te Hyrave

Zyra e te Hyrave Vetanake në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi, Financë dhe Buxhet, merret me menaxhimin e grumbullimit dhe regjistrimit të të hyrave vetanake, barazimet dhe alokimet e të hyrave në bazë të projeksioneve të parapara nga të hyrat për buxhetin komunal dhe menaxhimin, ekzekutimin e buxhetit nga zotimet e mjeteve, përpunimet, shpenzimet e mjeteve dhe arkivimin e tyre.

Sfidat e DEFB

Sfidat e Drejtorisë për Ekonomi, Financë dhe Buxhet, zakonisht paraqiten në komunikim me nivelin qendror, për shkak të mos kthimit të përgjigje të kërkesave në afat ligjor pastaj vonesa në dhënien e qasjeve ne sistemin Free Ballanc-it.

DREJTORIA PËR ARSIM DHE EDUKIM - DAE

Bazuar në realizimin e punës së Drejtorisë për Arsim dhe Edukim deklarojmë që gjatë kësaj periudhe ka pasur aktivitete të shumta të cilat janë bazuar në planin e veprimit të DKA-ës për vitin 2022.

Për të realizuar punët në procesin edukativo arsimor DKA-ja ka zhvilluar një varg konkurses, të cilat janë bazuar në legjislacionin në fuqi përfshirë rekrutimin e personelit arsimor mësimdhënës dhe teknik e gjithashtu në shpalljen e konkurseve për pozitë të drejtorëve dhe zëvendësrejtorit. DKA-ja ka bashkëpunuar ngushtë me Institucionet kompetente për të shpallë dhe realizuar konkurset për personelin arsimor, mësimdhënës dhe administrativ.

Në rekrutimin e personelit arsimor kemi zhvilluar kontakte të vazhdueshme me MASHT-in për të bërë të mundur shpalljen e konkursit edhe për angazhimin e personelit arsimor për fëmijët me nevoja të veçanta. Në drejtim të arritjeve të avancimit të pozitës së personelit arsimor, gjithashtu kemi bashkëpunuar ngushtë me MASHT-in dhe SBASHK-un e donator të tjerë në realizimin e pakove trajnuese për mësimdhënësit. Këtu përfshihen angazhime në fushën e kurrikulës, dhe programeve të trajnimit të organizuara nga SBASHK-u, të cilat janë mbajtur nëpër shkolla në koordinim me nevojat e personelit arsimor sindikalist. Po ashtu kemi bashkëpunuar me CARITAS-in në avancimin e njohurive për edukatorët, të cilët punojnë me nxënësit parashkollor dhe po ashtu jemi në realizim të pakos së përkrahjes për klasat e parafillorëve me mjete konkretizimi.

Duke ditur që ka qenë vit i pandemisë Personeli Arsimor shumë herë ka qenë pjesë e programeve online në fushën e kurrikulës, dhe metodologjisë arsimore duke bashkëpunuar ngushtë me shumë donatorë dhe MASHT-in në realizimin e programeve të ndryshme dedikuara personelit arsimor. Po ashtu në këtë drejtim janë realizuar bashkëpunime të shumta edhe me Institutin Pedagogjik, Zyrën për vlerësime dhe trajnime në MASHT. Këtu duhet veçuar bashkëpunimin që kemi pasur me SIA në Gjakovë në shqyrtimin e shumë aspekteve të legjislacionit për të drejtat e personelit arsimor. Në kuadër të bashkëpunimit për qasje në programet vlerësuese ndërkombëtare dhe kombëtare, shumë mësimdhënës janë angazhuar në programin e vlerësimit PISA duke u njoftuar me mënyrën e realizimit të këtij testi ndërkombëtar, i cili është me rendësi edhe për sistemin tonë arsimor.

Për të përkrahur të rinjtë dhe studentët DKA-ja ka lejuar edhe realizimin e shumë hulumtimeve të studentëve të drejtimeve të ndryshme arsimore që kanë realizuar praktikën profesionale në shkollat tona. Po ashtu është mbajtur edhe Testi i Maturës Shtetërore për afatin e parë dhe të dytë, ku kalueshmëria është rreth 83% e nxënësve në të dy afatet.

Po ashtu lajm me rendësi për qytetarët e komunës sonë ishte edhe hapja e drejtimeve të reja në IAAP “Lasgush Poradeci” në Kijevë dhe ato drejtime janë: Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë, Teknik i Sistemeve të TIK, Zhvillues i aplikacioneve softuerike; si dhe Asistent Restoranti.

Kontratat në përkrahje të institucioneve arsimore: Për të realizuar kushte më të mira të punës në procesin edukativo- arsimor janë realizuar edhe këto punë dhe aktivitete:

- Kontrata: Furnizimi me material higjienik;
- Furnizimi me material teknik, e cila kontratë ka përfunduar;
- Furnizimi me tonerë dhe letër për institucionet arsimore nga AQP-ja;
- Furnizimi me gravura dhe mirënjohje për nevojat e personelit arsimor pensionist;
- Realizimi i kontratës për mjete të zërimit për nevojat e aktiviteteve shkollore;
- Furnizimi me derivate për nevojat e shkollave me rastin e reduktimeve të energjisë elektrike;
- Në përfundim kontrata për kryerjen e punimeve Objektivin e Ri të Çerdhes në Malishevë;
- Kontrata për Shërbime Interneti për Institucionet Arsimore;
- Kontrata për furnizim me ushqim dhe pije për "Çerdhen" Zërat e "Ëmbël" në Malishevë;
- Në realizim kontrata për furnizim me xhama dhe mekanizëm të dyerve e dritareve;
- Kontrata shërbimi transportues për nxënësit me nevoja të veçanta;
- Kontrata shërbime transportuese për nxënësit, të cilët vijojnë mësimet në SHFMU" Dëshmorët e Kombit" në Ngucat, SHFMU" Hasan Prishtina" në Tërpezë, dhe SHFMU" Ismet Jashari" në Temeqinë, nxënësve të lagjes Garaqevë për në SHFMU" Asim Vokshi" në fshatin Panorc, SHFMU" 28 Nëntori" në Kërvasari.
- Në procedurë kontrata e re për bartjen e nxënësve në fshatin Janqist dhe Shkozë.
- Në realizim kontratat për furnizim me lëndë djegëse dru dhe pelet për institucionet arsimore.
- Realizimi i disa punëve në evitimin e defekteve në infrastrukturën shkollore përfshirë rrjetin e kanalizimit, energjisë elektrike, nyjave sanitare dhe punë të natyrës rinovuese.
- Furnizimi i Çerdhes me material didaktik.
- Furnizimit me shujtë ditore për nxënësit e programit fillor.
- Kontrata për mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore në institucionet arsimore-dy vjeçare
- Kontrata për renovimin e shkollave, kontratë dyvjeçare.

DKA gjithashtu gjatë vitit 2022 ka realizuar edhe një varg aktiviteteve tjera, të cilat kanë të bëjnë me:

- Realizimi i aktiviteteve për nder të Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve;
- Realizimi i aktiviteteve për nder të Ditëve të Shkollave;
- Realizimi i testeve provuese për testin e arritshmërisë për nxënësit e klasave të Nënta dhe testeve provuese për Testin e Maturës shtetërore;
- Realizimi i testeve - Testit PISA, TIMS, Testit të Arritshmërisë dhe Testit të Maturës për afatin e pare;

- Pjesëmarrja në garat shkollore sportive në Futboll, Volejboll, Atletikë etj, ku nxënësit e Gjimnazit “Hamdi Berisha” në Malishevë kanë fituar vendin e dytë në nivelin Republikan në lojën e futbollit- ekipi i djemve dhe Nxënësit e SHFMU’”17 SHKURTI” në Banjë kanë nxënë vendin e dytë në garat republikane në lojën e volejbollit ekipi i vajzave;
- Pjesëmarrja në trajnimet e ndryshme organizuar për Nxënësit me Nevoja të Veçanta;
- Pjesëmarrja në trajnimet e ndryshme organizuar për Edukatorët;
- Organizimi i takimeve me KFOR- LMT në Malishevë për të realizuar projekte të ndryshme në dobi të institucioneve arsimore.
- Vizita nëpër shkolla për nder të Ditëve të Shkollave;
- Pjesëmarrja në vizita monitoruese për institucionet arsimore;
- Bashkëpunimi me SIA në Gjakovë, MASHT-in e institucionet tjera e lokale qendrore;
- Takime me palë të ndryshme të nivelit lokal dhe qendror për mbarëvajtjen e arsimit;
- Përgatitjet për furnizim me tekste të reja shkollore.

Drejtorja për Arsim dhe Edukim ka realizuar edhe aktivitete të tjera si në:

- Realizimin e dhjetëra vizitave me karakter pune nëpër institucionet arsimore në komunë;
- Shqyrtimi i qindra kërkesave dhe ankesave të palëve të ndryshme;
- Pjesëmarrjen në shumë takime në nivel lokal dhe qendror për tematikat e ndryshme arsimore, përfshirë fushën kurrikulare, integrimin e nxënësve me nevojat të veçanta;
- Përgatitja e raporteve për Asamblenë Komunale;
- Realizimi i vizitave me karakter pune nëpër institucionet arsimore;
- Pjesëmarrje në takimet shkollore me rastin e njohjes së kontributit për mësimdhënësit pensionist;
- Përgatitja e raporteve për programin e performancës;
- Realizimi i testit Pisa, Testit TIMSS, Testit të Arritshmërisë dhe Testit të Maturës shtetërore. Afati i parë etj;
- Mbajtja e takimit me Aktivin e Drejtorëve;
- Organizimi i garave me karakter garues sportive në mes shkollave;
- Përkrahja e aksioneve për pastrim të objekteve shkollore;
- Shqyrtimi i fillimit të projekteve për investimet kapitale në shkolla sipas Buxhetit të vitit 2022 në koordinim me drejtorinë e urbanizmit.

Bashkëpunimi me institucionet tjera:

DKA-ja ka realizuar bashkëpunime me shumë institucione lokale dhe qendrore:

- Bashkëpunimi me Zyrën për Barazi Gjinore në realizimin e aktiviteteve për të drejtat e njeriut, fëmijëve dhe gruas;
- Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës në projekte të përbashkëta për mjedis të sigurt shkollor;
- Bashkëpunimi me Shoqata Joqeveritare lokale dhe Qendrore në projekte me rëndësi për komunitetin shkollor;
- Bashkëpunimi me Hidro Regjionit në trajtimin e disa kërkesave nga ana institucioneve arsimore;
- Bashkëpunimi me Eko Regjionin për arritjen e objektivave për mjedise të pastra shkollore;
- Bashkëpunimi me CARITAS-in në ngritjen e pozitës së infrastrukturës për klasat parashkollore e gjithashtu realizimin e programit trajnues për edukatorët dhe personelin e Çerdhes;
- Bashkëpunimi me KEDS-in për trajtimin e problemeve në rrjetin e energjisë elektrike;
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Drejtoritë komunale;
- Bashkëpunimi me QKMF'' Dr. Shpëtim Robaj'' në Malishevë;
- Bashkëpunimi me shumë donatorë të cilët përkrahin vazhdimisht institucionet arsimore;
- Bashkëpunimi me LMT me seli në Malishevë për shqyrtimin e realizimit të projekteve me rëndësi shkollore;
- Bashkëpunimi me KFOR-in Turk dhe Zvicëran: Realizimi i projektit për kabinetin e informatikës për Gjimnazin '' Hamdi Berisha'' në Malishevë si dhe shqyrtimi I Hapjes së tri puseve për Institucionet Arsimore për SHFMU'' Kajtaç Ramadani'' në Paralelet e saj në Gullboc dhe Stapanicë dhe SHFMU'' Emin Duraku'' në Dragobil.
- Bashkëpunimi me Komitetin e Arsimit në Trajtimin e temave me rëndësi arsimore;
- Bashkëpunimi me KPF-ën në shqyrtimin e raporteve për Asamblenë Komunale;
- Bashkëpunimi me Këshillin për Sigurinë në Bashkësi.

Përgatitjet për vitin e ri shkollor 2022/2023

Duke u bazuar në vazhdimësinë e zhvillimit të procesit edukativo arsimor, Drejtoria për Arsim dhe Edukim kishte filluar përgatitjet për të realizuar përgatitjet që viti i ardhshëm shkollor të jetë i organizuar dhe të funksionojë në kushte sa më të mira në përputhje me rekomandimet që do të

jepen nga MASHT-i Por jemi të gjithë të vetëdijshëm se përgatitjet dhe aspektet tjera ishin në varshmëri të zhvillimit të punës të ndikuar nga Niveli i përhapjes së Pandemisë. Megjithëkëtë ne ishim në kontakt të vazhdueshëm me MASHT-in për të bashkërenduar aktivitetet, të cilat do të mundësonin fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023.

Po ashtu për mirinformimin tuaj, deklarojmë që viti shkollor 2022/2023 nuk kishte filluar deri më 3 tetor 2022 për shkak të grevës, e cila ishte shpallur me 24 gusht të këtij viti.

Kemi qenë në presion të vazhdueshëm edhe nga komuniteti i prindërve dhe institucionet tjera relevante për të gjetur zgjidhje për të tejkaluar këtë situatë, e cila do t'i ketë pasojat e veta dhe do të ndikojë për zhvillim jo të mirë të procesit edukativo arsimor dhe humbje të shumë orëve të mësimi. Tash do të ballafaqohemi me zëvendësim të orëve të mësimi, e cila synon të bëhet sipas një kalendari të deklaruar nga MASHT-i, por në perspektivë shihet një mos koordinim mes MASHT-it dhe SBASHK-ut për të mbajtur orët e humbura gjatë muajit shtator.

Për të realizuar përgatitje sa më të mira të stafit mësimdhënës DKAE-ja ka bashkëpunuar ngushtë me shkollat në përgatitjet e konkursit për pranimin e punëtorëve të rinj. Kjo është bërë në koordinim dhe bazuar në legjislacionin në fuqi të nxjerrë nga MASHT-i.

DKAE-ja ka shpallë konkurs për plotësimin e mbi 30 pozitave të punës. Në drejtim të një arsimi sa më gjithëpërfshirës, Drejtoria për Arsim dhe Edukim ka bërë kërkesë që të shtohet numri i edukatoreve në institucionet tona. Kjo e bazuar në KAB të vitit 2022 dhe vitit 2023 ku thuhet se raporti Edukatore nxënës duhet të jetë: 1:12 nxënës. E aktualisht një edukatore në shkollat tona duke vlerësuar mesataren angazhohet për 20 nxënës. Kjo është shumë dhe del jashtë standardeve arsimore, pasi niveli para fillor kërkon përkushtim më të madh në raport me fëmijët. Vlerësuar në aspekte të përgjithshme konsiderojmë që institucionet arsimore janë duke lëvizur në drejtim të mirë të plotësimit të kuadrit të kualifikuar që na garanton për rezultate sa më të larta të procesit edukativo arsimor.

Në fushën e përgatitjeve për arsim gjithëpërfshirës DAE-ja ka punuar ngushtë me Shkollat, Këshillin e Prindërve, dhe gjithashtu ka themeluar Ekipin për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me nevoja të Veçanta me qëllim të plotësimit të këtij standardi institucional dhe përfshirjen e këtyre fëmijëve në procesin arsimor, gjegjësisht integrimin e tyre në institucionet arsimore. Po ashtu formimi i EPRMB-ve – Ekipeve për Parandalimin e Braktisjes dhe Reagimit për mos Regjistrim të Nxënësve është kërkesë për të gjitha shkollat e koordinuar me MASHT-in.

Në përgatitjen për vitin e ardhshëm shkollor do veçuar edhe anën e planifikimit financiar, ku kemi punuar ngushtë me Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Buxhet dhe me MASHT-in që të koordinojmë sa më mirë veprimet tona që të kemi një planifikim sa më gjithëpërfshirës. Do të mbetet sfidë angazhimi i koordinatorëve të cilësisë në shkollat, të cilat deri tani janë certifikuar nga MASHT-i. Po ashtu po planifikojmë të angazhojmë edhe rritjen e numrit të Shërbimit Pedagogjik dhe Psikologjik në shkollat tona. Gjithashtu në këtë drejtim e kemi pasur të lejuar që të angazhojmë edhe mësues mbështetës për të ndihmuar integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat tona, ku 3 (tre) mësimdhënës janë punësuar tashmë.

Për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme për përgatitjet dimërore nëpër shkolla po paraqesim një raport të përgjithshëm cili do të reflektojë anën e burimeve njerëzore, përgatitjet për mallra dhe shërbime e gjithashtu infrastrukturën shkollore.

Në aspektin e burimeve njerëzore kemi pothuajse stafin e kompletuar dhe të kualifikuar për të realizuar punën në procesin edukativo arsimor në rast të zhvillimit të punës në institucionet arsimore. Për të plotësuar nevojat për stafin e drejtorisë, konsiderojmë që Drejtoria për Arsim dhe Edukim ka nevojë të domosdoshme të shtojë numrin e stafit të vet të punës, pasi që aktualisht funksionon me 4 punëtorë dhe Drejtoreshën e DKAE-së. Për të kompletuar stafin, i cili do të ndikonte në rritjen e përgjegjësisë krahas institucioneve arsimore, konsiderojmë se prania e një pedagogu dhe një psikologu dhe një zyrtari për arsimin parafillor dhe zyrtari për arsimin e fillor është nevojë e domosdoshme që të mund të plotësojmë stafin për punë sa më gjithëpërfshirëse, që do të na garantonte cilësi dhe rezultate pozitive nga i gjithë procesi edukativo arsimor.

Po ashtu në konkursin e parë për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve ju njoftojmë se janë përzgjedhur 12 drejtor në shkollat të cilat janë në: Shkolla fillore në Malishevë, Gjimnazi në Malishevë, Kijevë, Balincë, Vërmicë, Lladroc, Bellanicë, Damanek, Dragobil, Drenoc, Bubavec dhe Panorc dhe një zëvendës drejtor për Gjimnazin Hamdi Berisha. Po ashtu për shkak të mungesës së dokumenteve ka dështuar konkursi në disa shkolla si në: Kijevë, Banjë, Mirushë dhe Bardh. Po ashtu në muajin gusht kemi hapur edhe konkursin për drejtorë edhe në 17 shkolla tjera përfshirë Çerdhen dhe SHMP Lasgush Poradeci në Kijevë, dhe rishpallje të konkursit për 4 shkolla të tjera.

Po ashtu Drejtoria i ka bërë kërkesë Komisionit për Buxhet dhe Financa në Kuvendin e Kosovës, MPFT dhe MASHT për të aprovuar stafin për dy çerdhe në Malishevë dhe në Banjë.

Në aspektin e infrastrukturës besojë që kemi një infrastrukturë të mirë që garanton funksionimin e rregullt të institucioneve arsimore

Këtu do të veçojmë intensifikimin e punimeve në Shkollat në Dragobil dhe në Malishevë.

Është në procedurë kontrata për furnizim me material administrativ, po ashtu furnizimi me material pedagogjik është kryer. Po ashtu shkollat do të furnizohen me rekuizita sportive. Po ashtu edhe këtë vit DKAE-ja do të përkrah nxënësit e familjeve në nevojë, të cilat kanë nevojë të furnizohen me pajisje shkollore.

Po ashtu kemi disa shkolla të cilat janë të përfshira në një marrëveshje për efikasitet të energjisë elektrike por kjo kontratë nuk e dimë ende sa do të jetë e zbatueshme për të përkrahur institucionet tona në fushën e energjisë.

Këtu janë të përfshira aktualisht:

1. Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë, SHFMU "Ibrahim Mazreku" në Malishevë,
2. SHFMU "Labinot Krasniqi" në Mirushë dhe SHFMU "Visar Krasniqi" në Drenoc.

Për të realizuar qëndrueshmëri në nxehjen kemi disa shkolla të cilat kanë kaldajat jo funksionale dhe është kërkuar nga Institucionet arsimore që të ndërrohen. Është fjala për Astrazup ku është vendosur kaldaja e re, në Drenoc, në Shkozë të cilat do të përdorin peletin lëndë djegëse për ngrohje. Dhe gjithashtu do të ndërrohet kaldaja e IP" Zërat e Ëmbël" në Malishevë e cila deri tash ka funksionuar me lëndë djegëse naftë e tash e tutje do të përdoret peleti lëndë djegëse për ngrohje. Po ashtu nga programi i eficiencës së energjisë elektrike është ndryshuar kaldaja në Gjinnazin "Hamdi Berisha" në Malishevë, ku kalojnë në shfrytëzimin e peletit si lëndë djegëse. Besoj që në javët në vazhdim do të fillojnë edhe procedurat për furnizim me material teknik dhe elektrik për institucionet arsimore.

Drejtorja për Arsim dhe Edukim gjatë të vitit 2022, ka realizuar edhe shumë punë të tjera administrative përfshirë, raportet statistikore, koordinimin me shkollat për planifikimin e shpenzimeve për vitin 2022, identifikimin e nevojave për projekte prioritare për institucionet arsimore, dhe komunikimin e rregullt me Drejtorinë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa në përgatitjen e planifikimeve buxhetore për vitin 2023.

Po ashtu janë bërë edhe shumë specifikime për realizimin e shërbimeve për shkollat. Gjithashtu janë realizuar me dhjetëra konkurse për plotësimin e personelit arsimor dhe administrativ e teknik për shkollat. Po ashtu DKAE-ja ka shqyrtuar me prioritet përgatitjet për mbajtjen e Testeve-Testi PISA, Testit TIMSS, Testi i Arritshmërisë, dhe Testin e Maturës etj.

Po ashtu në konkursin e parë për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve ju njoftojmë se janë përzgjedhur 13 drejtor në shkollat të cilat janë në: Shkolla fillore në Malishevë, Gjinnazi në Malishevë, Kijevë, Balincë, Astrazup, Vërmicë, Lladroc, Bellanicë, Damanek, Dragobil, Drenoc, Bubavec dhe Panorc dhe një zëvendës drejtor për Gjinnazin Hamdi Berisha. Po ashtu për shkak të mungesës së dokumenteve ka dështuar konkursi në disa shkolla si në: Kijevë, Banjë, Mirushë dhe Bardh.

Ne kemi publikuar konkursi për drejtorë edhe në 20 shkolla tjera përfshirë Çerdhen dhe SHMP Lasgush Poradeci në Kijevë. SHFMU "Beqir Gashi" Mleqan, SHFMU "Gjergj Kastrioti" Llozicë, SHFMU "Imer Krasniqi" në Carrallukë, SHFMU "Migjeni" në Lubizhdë, SHFMU "Petro Nini Luarasi" në Llapqevë, SHFMU "Rifat Berisha" në Berishë, SHFMU "Vesel Pagarusha" në Pagarushë, SHFMU "Visar Krasniqi" në Drenoc, SHFMU "17 SHKURTI" në Banjë, SHFMU "18 PRILLI" në Burim, SHFMU "28 NËNTORI" në Kërvasari, SHFMU "Habib Berisha" në Gurbardh, SHFMU "Afrim Krasniqi" në Bardh, SHFMU "Naim Frashëri" në Banjë, SHFMU "Nuhi Mazreku", SHFMU "Dëshmorët e Kombit" në Ngucat, SHFMU "Xhevë Krasniqi-Lladroci", SHFMU "Gjergj Fishta", SHMP "Lasgush Poradeci", IAP "Zërat e Ëmbël". Konkursi nuk është mbyllur me sukses për shkak të mos aprovimit të rekomandimeve të komisionit nga ana e zyrës së kryetarit për mungesë të konkurrencës cilësore.

Përfundim:

Bazuar në rrjedhat e përgjithshme konsiderojmë që sektori i arsimit duhet të mbështetet nga Granti i Përgjithshëm për të mbuluar të gjitha nevojat, të cilat i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime ku janë rritur çmimet dhe e kemi të pamundur të jemi të kompletuar në plotësimin e

tyre duke ditur që kemi një buxhet të kufizuar të kësaj kategorie, e cila nuk plotëson të gjitha nevojat.

Shkollat kanë nevojë, për furnizime me mjete konkretizimi, pajisje informatike, perde, kamera të sigurisë. Kemi nevojë për përkrahje në realizimin e shërbimeve trajnuese për personelin arsimor dhe Këshillat Drejtues të Shkollave.

Po ashtu në këtë vit shkollor mbulojmë transportin e nxënësve në Ngucat, Tërpeze, Temeqinë, Garaqevë dhe transporti i nxënësve me nevoja të veçanta. Po ashtu do të shqyrtohet transporti i nxënësve të fshatrave Janqist dhe Shkozë. Dhe është nënshkruar edhe kontrata për bartjen e nxënësve të lagjes Kodrali nga fshati Kërvasari për në SHFMU "28 Nëntori" në Kërvasari

Bazuar në realizimin e aktiviteteve të deritanishme deklarojmë që DKA-ja do të vazhdojë të punojë me përkushtim për realizimin e punëve të saj.

DREJTORIA I INSPEKTORATIT - DI

Drejtoria e Inspektoratit gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 ka qenë e angazhuar në funksion të realizimit të planeve të saj të punës me të gjitha resurset e saj.

Disa nga punët e realizuara nga Drejtoria e Inspektoratit janë;

- ✓ Kemi bërë planifikimin e punës për Drejtorinë për vitin 2022;
- ✓ Kemi inspektuar marketet në përgjithësi, e në veçanti inspektimi ka qenë për ndarjen e produkteve shtazore me ato të pallmës -bimore, gjendja ka qenë në nivel;
- ✓ Kemi inspektuar të gjitha furrat e bukës për pastërti, peshën e bukës dhe zbatimin e masave anti-Covid;
- ✓ Duke u bazuar në vendimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe rekomandimet nga Drejtoria e Urbanizimit dhe Gjeodezisë, kemi marrë Aktvendime për Rrëtime të disa objekteve;
- ✓ Inspektime të përgjithshme në ndërtim;
- ✓ Është bërë ndalimi i heqjes së dheut së Gërmimeve, të cilat kanë vepruar pa pëlqim;
- ✓ Janë identifikuar dhe inspektuar subjektet afariste të cilat e kanë deklaruar biznesin e tyre të shuar, se a janë më të vërtetë të shuar apo janë duke e zhvilluar aktivitetin e tyre biznesor;
- ✓ Në bashkëpunim me inspektorët e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kemi inspektuar "Ujëvarat e Mirushës";
- ✓ Pas zhvillimit të fundit për dukurinë e ngritjes së çmimeve që kanë përfshirë regjionin e me këtë rast evident ka qenë edhe tek ne, vlen të ceket se ngritja e çmimeve ka qenë në disa artikuj,

e më të theksuar kanë qenë nafta dhe disa artikuj ushqimorë, në veçanti vaji ushqimor, me këtë rast kemi monitoruar duke inspektuar marketet në përgjithësi, lidhur me dallimet evidente të theksuar në çmim për të njëjtin artikull,

- ✓ Kemi inspektuar në tërë territorin e Komunës së Malishevës për furrat gëlqerore, si dhe kemi përpiluar raport për Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, për furrat gëlqerore dhe njëkohësisht i kemi njoftuar për gjendjen;
- ✓ Kemi inspektuar subjektet afariste të video lojërave si, bilardo dhe të ngjashme, si dhe subjektet tjera ku shërbehen pijen, për të mbikëqyr shërbimin e pijeve alkoolike për personat nën moshën 18 vjeçare;
- ✓ Si Drejtori bëjmë pjesë në “TASK- FORCA” për Covid-19, për menaxhimi të mbeturinave, si dhe menaxhim të ujit të pijes, e formuar nga Kryetari i Komunës, ku ne si drejtori gjithmonë do të jemi në ballë të detyrave dhe obligimeve që na takojnë;
- ✓ Kemi dhënë urdhëresa për marrjen e pëlqimeve për reklamat që janë në rrethrrrotullim, në qendër të qytetit;
- ✓ Kemi monitoruar pastrimin e pushtave kryesore nëpër qytet nga kompania e mirëmbajtjes së kanalizimit të ujërave atmosferikë;
- ✓ Kemi filluar të shpërndajmë Vërejtje me shkrim për subjektet afariste, të cilat kanë borxhe të taksës komunale, këto borxhe janë nga viti paraprak (2000-2021) ;
- ✓ Kemi marrë pjesë në të gjitha fshatrat, në aksionin për pastrimin e ambientit, me moton “Muaji Prill, muaji i Pastërtisë” që janë zhvilluar gjatë muajit Prill;
- ✓ Kemi pasur takim me inspektorët nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me të cilët kemi biseduar për ndërtime në Komunën e Malishevës, respektimin e procedurave, për punën dhe inspektimet që zhvillon drejtorja në fushën e ndërtimeve;
- ✓ Kemi bërë inspektime të ndërtimit, në veçanti të ndërtimeve të larta (ndërtime banesore), me këtë rast, kemi shqiptuar për 4 posedues të lejeve të ndërtimore, gjoba mandatorë për secilin, këto gjoba janë shqiptuar për mosrespektim të sigurisë së përgjithshme në vend ndërtim dhe përreth ndërtimit;
- ✓ Në bashkëpunim me sektorin e Hetuesisë së Policisë në Malishevë, kemi inspektuar të gjithë Gurthyesit, si dhe Fabrikat e Betoni që operojnë në territorin e Malishevës. Ky inspektim është bërë për verifikim të dokumentacionit dhe inspektim për ndotjen e ambientit në përgjithësi.

- ✓ Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, kemi bërë largimin e reklamave të disa bizneseve në rrethrotullim në Malishevë;
- ✓ Në bashkëpunim me GIZ Gjerman dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike, kemi bërë evidentimin e të gjitha pikave ilegale të mbeturinave (inerte edhe komunale) nëpër hapësirat publike;
- ✓ Në bashkëpunim me Policinë kemi inspektuar auto-taksitë, për verifikim të dokumentacionit, me këtë rast kemi dhënë disa urdhëresa për plotësimin të dokumenteve;

Gjithashtu, Drejtoria e Inspektoratit ka bërë edhe këto angazhime tjera;

- Verifikimin e çmimeve të produkteve.
- Zbritjen sezonale dhe ndarjen fizike këtyre produkteve.
- Matjen e peshës së produkteve.
- Deklaracionin e produkteve, etiketat, vendosja e flamujve të origjinës së produkteve
- Ndalimin e shitjes të disa lodrave për fëmijë (këto lodra janë imitimi i produkteve ushqimore)
- Largimin e disqeve për prerje të metalit dhe betonit me afat të skaduar, po ashtu edhe inspektimin e parkingjeve lidhur me orarin dhe çmimet që i kanë, me këtë rast ne kemi inspektuar operatorët ekonomikë dhe aty kemi hasur parregullsi dhe kemi marrë masat e parapara;

Gjithashtu,

- Kemi bashkëpunuar me Prokurorinë e Përgjithshme, Sektorin e Hetimeve të Policisë në Prishtinë, KPMM, MMPHI, Agjencinë e Pyjeve, ATK, për parandalimin e aktivitete të jashtëligjshme të degradimit mjedisor;
- Kemi inspektuar për Leje Mjedisore Komunale disa objekte në ndërtim e sipër se a janë duke e respektuar LMK (12 LMK).
- Kemi filluar me shpërndarjen e Aktvendimeve për Taks Komunale për subjektet afariste, janë shpërndarë më shumë se 250;
- Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës përkatësisht me Njësinë kundër trafikimit të qenieve njerëzore të Policisë së Malishevës dhe Gjakovës kemi inspektuar në orët e vona të natës disa lokacione të lokaleve të natës.
- Kemi dhënë urdhërues për largimin e një pengese të vendosur në rrugën kryesore në fshatin Carralllukë e cila është vendosur pa Pëlqim nga Komuna, dhe kjo pengesë është larguar;

- Kemi dhënë dhe njëkohësisht kemi dorëzuar Urdhërues për Drejtorinë e Urbanizmit, që për të gjitha ndërtimet e projekteve komunale që planifikojnë të bëhen ndërtime të pajisen me Leje Ndërtimorë para se të fillohen punimet;
- Kemi inspektuar në orët e vona të natës, për respektim të orarit të punës për subjektet afariste, në veçanti për orarin dhe kujdestarinë e barnatoreve;
- Kemi iniciuar procedurën e plotësim ndryshimit të rregullores për orarin e punës për subjekte afariste, njëkohësisht kemi bërë fillimin e ndryshimit të saj si dhe kemi marrë pjesë edhe në komisionin e formuar nga Kryetari për ndryshimin e kësaj rregullore, po ashtu pas përfundimit të plotësim ndryshimit, kemi dërguar në zyrën për informim që kjo projekt rregullore të del në debat publik.
- Kemi dhënë Vërejtje për 6 subjekte afariste dhe personave të tyre përgjegjës, për mos pagesën e gjobave mandatore të cilave ju kemi shqiptuar në fund të korrikut, me rastin e inspektimit për mallrat me afat të skaduar;
- Kemi inspektuar vendosjen e disa shenjave të komunikacionit nëpër qytet dhe në rrugën transite për automjete të tonazhit të lartë (Malishevë-Mirushë-Gurbardh-Astrazup) nga kompania kontraktuese për vendosjen e këtyre shenjave.
- Subjekteve afariste, sektorit të gastronomisë ju kemi bërë njoftim për fillimin e zbatimit të vendimit për ndalimin e shërbimit me shishe/argjile.
- Në fund të dhjetorit jemi marrë kryesisht edhe me shitësit ambulant të mjeteve piroteknike, ndalimin e përdorimit të tyre në hapësirat publike, si dhe me vërejtje, sugjerime, rekomandime për shitësit ambulator.

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, Drejtoria e Inspektoratit ka bërë gjithsej;

- ☐ 405 Procesverbale;
- ☐ 221 Urdhëresa ;
- ☐ 75 Shqyrtime të kërkesave të natyrave të ndryshme;
- ☐ 25 Gjoba mandatore;
- ☐ 4 Kërkesa Gjykatës, Prokurorisë;
- ☐ 210 Shpërndarje të Aktvendimeve, Taksa Komunale;

DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË - DGJKP

Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, në përputhje me mandatin e saj ligjor ka arritur të realizoj pjesën me të madhe të objektivave të parapara për vitin 2022. Në fillim të kësaj periudhe janë vendosur në prioritet kërkesat dhe lëndët e papërfunduara gjatë vitit paraprak, shqyrtimi i të gjitha kërkesave brenda afatit të rregullt ligjor, thellimi i bashkëpunimit me të gjitha departamentet në Komunën e Malishevës si dhe organet tjera relevante në nivel qendror.

Në këtë periudhë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, ka zhvilluar shumë aktivitete duke u bazuar në detyrat dhe obligimet që i takojnë. Në kuadër të këtyre detyrave dhe obligimeve ka kryer këto aktivitete: takime zyrtare me institucionet përkatëse siç është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencinë Kadastrale të Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe institucione tjera. Pastaj aktivitete tjera në terren në tërë territorin e komunës sonë aty ku është kërkuar që të jemi në shërbim të qytetarëve si dhe aktiviteteve që kanë qenë të nevojshme për Komunën. Gjithashtu janë kryer të gjitha shërbimet që janë kërkuar nga qytetarët në zyrat tona siç janë pajisja me certifikata të pronës, kopje të planit dhe të gjitha shërbimet që kryhen në përgjegjësinë e kësaj drejtorie.

Kjo drejtori do të vazhdojë me aktivitetet e saj pa ndërprerë në kuadër të detyrave që të jemi sa më efikas në shërbim të qytetarëve, si dhe institucioneve të ndryshme në Republikën e Kosovës që kanë korrespondencë me këtë drejtori.

Në kuadër të përgjegjësisë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, përkatësisht stafi i kësaj drejtorie, ka qenë në nivel të detyrave, duke shqyrtuar dhe miratuar të gjitha kërkesat e palëve, e institucioneve, që kanë të bëjnë me ndërrim pronari, regjistrim dhe çregjistrim i hipotekës, regjistrim i servitutit, kërkesa për certifikata të pronës, kopje plani, kërkesa për ndarje dhe bashkim parcelash, etj.

Njëkohësisht i jemi përgjigjur të gjitha kërkesave nga Drejtoria e Inspektoratit të cilat kanë të bëjnë më dyshime për uzurpim, vërtetim të gjendjes faktike dhe kërkesa nga Drejtoria e Urbanizmit që lidhen me realizimin projekteve komunale.

Gjatë vitit 2022 është bërë regjistrimi në regjistra kadastral i Vendimeve Përfundimtare për shpronësim në Autostraden Gjurigjicë – Kijevë dhe Morinë – Merdare në territorin e Komunës së Malishevës, përkatësisht në Zonat Kadastrale Kijevë, Mleqan, Llozicë, Balincë, Carrallukë, Shkarashnik, Tërpezë, Lladroc, Banjë, Bellanicë dhe Temeqinë.

Janë shqyrtuar edhe shumë kërkesa të ndryshme të bëra nga qytetarët dhe përfaqësuesit e fshatrave.

Në kuadër të DGJKP-së, puna dhe procedurat janë të shpërndara në tre sektor: sektori i kadastrit, sektori i gjeodezisë dhe sektori i pronës.

Sektori i Gjeodezisë - është sektori ku palët kanë mundësi që ta shohin gjendjen e pronave të tyre në pjesën grafike, të bëjnë kërkesa të ndryshme për ndarje, bashkim parcelash, matje të ndryshme, kërkesa për koordinata, korrigjime, barazime të pjesës grafike me pjesën tekstuale,

pajisen me kopje plani, etj. Po ashtu ky sektor realizon bashkëpunime me drejtori tjera aty ku paraqitet nevoja që të bëhen incizime dhe konstatime ne terren.

Numri i përgjithshëm i kërkesave në sektorin e gjeodezisë gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 është 501 kërkesa, ndërsa të hyrat e realizuara në sektorin e gjeodezisë gjatë kësaj periudhe janë 3943 euro.


Sektori i Kadastrit – ky sektor bënë pranimin e lëndëve të cilat kanë të bëjnë me regjistrime dhe ndryshime në regjistra kadastrale të cilat bëhen në bazë të akteve të ndryshme juridike, vendimeve gjyqësore, vendimeve administrative apo kontratave të ndryshme, regjistrimi i hipotekave, servituteve, objekteve, etj. Për secilin shërbim me udhëzime administrative dhe rregullore janë të parapara tarifat. Pasi zyrtarët e kadastrit pranojnë lëndën, e njëjta shqyrtohet nëse është e pakompletuar atëherë me shkrim njoftohet pala për plotësim lende dhe pas plotësimit merret vendimi për aprovim, për ndryshimet e nevojshme në regjistra.


Po ashtu ky sektor lëshon dokumente të ndryshme kadastrale si certifikata të pronës, certifikatë që nuk posedon pasuri të paluajtshme, ku numri i përgjithshëm i kërkesave për dokumentacion gjatë vitit 2022, ishte 2926, derisa të hyrat e realizuara janë 2167 euro.

Gjithashtu, numri total i lëndëve sipas sistemit kadastral të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, që është në përdorim nga të gjitha Zyrat Kadastrale Komunale në nivel vendi, për vitin 2022 është 849, nga të cilat 799 janë të aprovuara, 11 të refuzuara dhe 39 janë në proces, dhe të hyrat e përgjithshme vjetore të realizuara nga këto lëndë janë në vlerë prej 54,174.75 euro.

Numri i përgjithshëm i kërkesave dhe të hyrave të realizuara gjatë intervalit kohor Janar – Dhjetor 2022 nga të gjithë sektorët e drejtorisë është 4276, ndërsa të hyrat e realizuara për periudhën Janar – Dhjetor 2022 janë në vlerë 60,284.75 euro.

Me anë të tabelave grafike të mëposhtme është paraqitur një krahasim i punëve gjegjësisht kërkesave dhe të hyrave të realizuara ndër vite.





Sektori i Pronës - sektori i pronës zhvillon procedura të ndryshme që kanë të bëjnë me uzurpime të pronës komunale, pranon kërkesa nga përfaqësues të fshatrave që kanë të bëjnë me hapjen e ndonjë rrugë nëpër prona private dhe regjistrimin e saj në kadastrë, zhvillon procedura për këmbimin e pronës publike me pronë private sipas vendimeve administrative, përgatitë lëndët për procedurë të shpronësimit, pranon kërkesa dhe jep kopje të lëndëve të vjetra të cilat janë të arkivuara në këtë sektor si dhe punë shtesë sipas nevojave dhe kërkesave edhe nga drejtori tjetra.

Shërbimi pronësoro – juridik ka filluar rilevimet e pronës publike nëpër shumë lokalitete, me theks të veçantë në qytetin e Malishevës, si dhe rilevime në lokacione të ndryshme sipas kërkesave dhe ankesave të palëve, dhe për këto lëndë janë iniciuar dhe zhvilluar mbi 100 procedura administrative për shqyrtimin e marrëdhënieve pronësoro juridike të krijuara më uzurpim arbitrar të pronës shoqërore. Këto raste kryesisht kanë qenë të fokusuara në rrugët kryesore të qytetit të Malishevës, me qëllim që ta kemi një pasqyrë me të mirë për realizimin e projekteve kapitale dhe ruajtjes së hapësirave publike.

Në bashkëpunim me shërbimin e kadastrit dhe gjeodezisë është bërë regjistrimi në regjistra kadastral i Vendimeve Përfundimtare për shpronësim në Autostradën Gjurgjicë – Kijevë dhe Morinë – Merdare në territorin e Komunës së Malishevës, përkatësisht në Zonat Kadastrale Kijevë, Mleqan, Llozicë, Balincë, Carrallukë, Shkarashnik, Tërpezë, Lladroc, Banjë, Bellanicë dhe Temeqinë.

Mbetet sfida numri i vogël i punëtorëve në këtë sektor gjë që ndikon shumë në mbarëvajtjen e punëve dhe zhvillimin efikas të procedurave si dhe mos reformimi i infrastrukturës ligjore që ka të bëjë me trajtimin e uzurpimeve dhe mbrojtjen e pronës komunale e publike.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT - DKRS

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN JANAR SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Në fillim të muajit janar kam përgatitur dhe dorëzuar planin e punës për kulturën për vitin 2022 dhe kam dorëzuar raportin një vjeçar të kulturës për vitin 2021.

Më 20/01/2022, bashkë me zyrtarin e kulturës Kushtrim Morina dhe zyrtarin e sportit Albert Morina, kemi vizituar disa objekte të Trashëgimisë Kulturore me qëllim të informimit të pronarëve, poseduesve dhe shfrytëzuesve të asetit të Trashëgimisë Kulturore që janë në Mbrotjtje të Përkohshme të miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2021/2022.

Gjatë kësaj vizite kemi takuar pronarët e aseteve, përfaqësuesit e fshatrave dhe kemi shpërndarë disa njoftime informuese për përgjegjësitë ndaj aseteve të trashëgimisë kulturore, bazuar në Ligjin Nr. 02/L-88 PËR TRASHËGIMIN KULTURORE.

Njoftimet janë pranuar dhe nënshkruar nga pronarët e aseteve që janë në pronësi private dhe nga përfaqësuesit e fshatrave që janë në pronësi shoqërore.

Njoftimin informues në fshatin Senik për objektet e trashëgimisë kulturore “Mullirin dhe koshin e familjes Jonuzaj” e ka pranuar dhe nënshkruar poseduesi dhe pronari i asetit Ali Januzaj, ndërsa në fshatin Pagarushë objektin e trashëgimisë kulturore “Mulliri i Islam Zenelit” e ka pranuar dhe nënshkruar përfaqësuesi i fshatit Gëzim Krasniqi, në fshatin Shkozë objektet e trashëgimisë “Rrënojat e Xhamisë së vjetër” dhe “Shtëpi gurin e Ruzhdi Ramadan Bytyqi” e ka pranuar dhe nënshkruar përfaqësuesi i fshatit Luan Bytyqi.

Po ashtu edhe në fshatin Bubël, objektet e trashëgimisë kulturore “Ura e Bublës”, “Rrënojat e Mullirit” dhe “Hambarin e Fazli Osman Reshitaj” e ka pranuar dhe nënshkruar përfaqësuesi i fshatit, Ahmet Rrahmanaj, megjithëse objekti i trashëgimisë “Hambari i Fazli Osman Reshitaj” tani më nuk ekziston i cili është shkatërruar nga kushtet atmosferike.

Bashkë me zyrtarin e kulturës Kushtrim Morina kemi pritur përfaqësuesit nga Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore - Prizren, ky takim u realizua me qëllim të dorëzimit të kopjeve të njoftimeve informuese të pranuar dhe nënshkruara nga pronarët dhe përfaqësuesit e fshatrave në lidhje me përgjegjësitë e pronarëve dhe shfrytëzuesit të aseteve të trashëgimisë kulturore që janë në mbrotjtje të përkohshme.

Bashkë me zyrtarin e kulturës Kushtrim Morina vizituam Bibliotekën e Qytetit “Sokol Kryeziu” në Malishevë, aty jemi pritur nga menaxherja e bibliotekës Hana Bytyçi, ku dhe jemi njoftuar për gjendjen e këtij institucioni.

Një prej problemeve më të mëdha që po e pamundëson mbarëvajtjen e punës në Bibliotekë është ç'kycja nga rrjeti me energji elektrike që nga data 21/09/2020. Ne kemi bërë kërkesë për paramasa në Drejtorin e Urbanizmit dhe kemi kërkuar të fillojnë edhe procedurat e prokurimit.

Nga menaxherja u njoftuam se biblioteka ka pranuar në vlerë 3,000.00 € tituj të librave të ndryshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ky material ende ka mbetur në pako dhe ende nuk është sistemuar dhe regjistruar për shkak të gjendjes dhe kushteve që e bënë të pamundur mbarëvajtjen e punës në këtë institucion publik.

Gjatë vizitës në këtë institucion u vë re që zhvillimi i punës është i pamundur, ambienti brenda bibliotekës është shumë i ftohtë, përveç kësaj biblioteka teknikisht ishte mbuluar nga pluhuri dhe jo vetëm biblioteka por edhe Muzeu i Qytetit “Jahir Mazreku” dhe e tërë hapësira ku ndodhen këto dy institucione niveli i pastërtisë ishte shumë i ulët.

Prandaj nëse vazhdohet kjo gjendje rrezikohet të dëmtohet e gjithë pasurimi librar, andaj është nevojë e domosdoshme që sa më parë të merren masa në mënyrë që të fillon mbarëvajtja e punës dhe të ruhet i gjithë pasurimi librar që posedon biblioteka.

Në janar 2022, kemi filluar me përgatitjet për “Flakën e Janarit” , kemi konkretizuar agjendën e programit në tërësi dhe kam përgatitur ftesat.

Shënimi i Flakës së Janarit- sipas agjendës janë vënë buqeta me lule te vendi i rënies, më pas Homazhe dhe nderime tek varri i dëshmorit Hysni Mazreku-Malishevë dhe Homazhe dhe nderime tek varri i dëshmorit Ali Kryeziu – Bubavec.

Ka nisur punimet Kuvendi Zgjedhor i Këshillit të Veprimit Rinor Lokal. Në këtë Kuvend kanë marrë pjesë tri organizata rinore (Qendra Rinore, Values for better Future dhe Thirrja rinore) dhe dy këshilla të nxënësve (Këshilli i nx. nga gjimnazi “Hamdi Berisha” dhe Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi”).

DKRS, ka ofruar kushtet e nevojshme që Kuvendi Zgjedhor të realizohet me sukses.

Kuvendi ka vendosur që t’i zhvillojë punimet më 1 shkurt ku edhe do të zgjidhet kryetari i ri i KVRL-së. Kjo u bë për shkak se njëri nga anëtarët e kuvendit ishte më i moshuar se 24 vjet, dhe kjo binte ndesh me rregulloren dhe statutin e KVRL-së.

Në muajin Janar kam bërë hartimin e planit vjetor për vitin 2022 për aktivitetet të cilat do t’i zhvillojmë në sektorin e sportit gjatë kësaj periudhe.

Gjatë këtij muaji së bashku me zyrtarin për sport kemi vizituar Stadiumin e qytetit “Liman Gegaj” si dhe palestrën e qytetit “Habib Zogaj” ku u njoftuam nga punëtorët e këtyre institucioneve lidhur me aktivitetet të cilat zhvillohen në këto terrene sportive.

Gjatë kësaj periudhe kam pasur takim me përfaqësuesit e KFF “Malisheva” dhe KFF “16 Qershori”, ku kemi biseduar lidhur me problemet me të cilat ballafaqohen këto klube të cilat e përfaqësojnë Malishevën në nivelet më të larta në futbollin kosovar për femra.

Gjatë kësaj periudhe së bashku me zyrtarin Albert Morina kemi pritur në takim përfaqësuesin e FC Malishevës, Kastriot Kafexhollin me të cilin biseduam lidhur me mundësitë dhe format si mund ta përkrahim klubin e futbollit “FC Malisheva” i cili bënë pjesë në Superligën e Kosovës.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN SHKURT SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Me datë 3 shkurt, gjatë vizitës që e kemi bërë së bashku me zyrtarin Kushtrim Morina në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, kemi vërejtur dëmtime në shtyllat elektrike që janë të dedikuara për ndriçimin e hapësirave të oborrit të këtij institucioni, nga pamja shihet që rrjeti elektrik në këto shtylla mund të paraqet rrezik për jetë (kabllot nuk janë izoluar si duhet). Sipas punëtorit teknik këto dëme janë bërë nga faktori njëri dhe për këtë janë njoftuar organet e rendit dhe sigurisë, po ashtu të dëmtuara ka edhe ulëse që janë të dedikuara për hapësirat e jashtme dhe gjithë këto dëme vijnë si pasojë e mos rregullimit të rrethojave të oborrit dhe hapësirave që posedon ky objekt.

Në hyrje të objektit shkallët janë dëmtuar nga faktorë të ndryshëm, objekti i Shtëpisë së Kulturës ka filluar të dëmtohet edhe më shumë për shkak të shfrytëzimit të hapësirave brenda Shtëpisë së Kulturës si depo për grumbullimin e miellit dhe pakove tjera ushqimore, dhe si pasojë e këtij shfrytëzimi mirëmbajtja e higjienës në këtë objekt ka paraqitur shumë vështirësi.

Ndërsa brenda objektit në disa vende pikon çatia dhe po i dëmton shumë muret dhe tavanin në korridore dhe në salla. Ndriçimi është jofunksional 80% prandaj e pamundëson zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në Shtëpinë e Kulturës.

Gjendja e tualeteve ishte jo e mirë teknikisht shumë nyje sanitare jo në gjendje funksionale dhe tualetet ishin shumë të papastruara, për këtë gjendje të higjienës punëtori teknik u arsyetua se për shkak të temperaturave të ulëta si pasojë janë ngrirë gypat e ujit dhe nyjat sanitare prandaj ka qenë e pamundur të pastrohet.

Punëtori teknik i Shtëpisë së Kulturës, Fadil Hoti, paraqiti nevojën e domosdoshme për furnizim me material higjienik dhe një fshesë elektrike në mënyrë që të mund të mirëmbajë higjienën në këtë objekt.

Me datë 9 shkurt, kemi dërguar sugjerimet tona për rregulloren për taksa, gjoba dhe ngarkesa komunale për vitin 2022.

Më 11 shkurt, kemi nisur përgatitjet dhe planifikimin për shënimin e 14-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Kemi diskutuar për mënyrën e shënimit të kësaj dite, si dhe kemi konkretizuar agjendën aktiviteteve për shënimin e kësaj dite.

Më 15 shkurt, kemi bërë shpërndarjen e ftesave dhe agjendën e aktiviteteve me rastin e shënimit të 14-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ftesat i kemi shpërndarë tek Stacioni Policor në Malishevë, Shoqatat e dala nga Lufta e UÇK-së dega në Malishevë, Kryqi i kuq, HANDIKOS, LMT KFOR, QKMF, Shoqata e Pensionistëve, Bashkësia Islame, etj.

Më 17 shkurt, është shënuar 14-vjetori i Pavarësisë së Kosovës, aktivitetet kanë filluar sipas agjendës mbledhja solemne më pas nderime para Shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari në Malishevë, homazhe në varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe në Kleçkë, vizitë në Kompleksin Memorial Adem Jashari në Prekaz. Gjithashtu, kemi organizuar edhe transportin dhe drekë për familjet e dëshmorëve.

Më 21 shkurt, i kemi shoqëruar nxënësit e një shkolle fillore, të cilët me planprogram të shkollës kanë vizituar Muzeun e Qytetit “Jahir Mazreku” në Malishevë. Gjatë kësaj vizite nxënësit u njoftuan me rëndësinë që ka Muzeu dhe po ashtu patën mundësinë të njiheshin nga afer me artefakte të ndryshme të trashëgimisë Kulturore që ndodhën në Muze.

Me 23 shkurt, së bashku me zyrtarin e kulturës Kushtrim Morina dhe zyrtarin e sportit Albert Morina ishim në takim në Drejtorinë e Kulturës, Rinis dhe Sportit të komunës së Suharekës, në këtë takim u pritëm nga Drejtoresha e DKRS-së Lorika Gashi, ku dhe diskutuam për shumë çështje të ndryshme në fushën e kulturës, rinis dhe sportit. Si komuna fqinje diskutuam edhe rreth bashkëpunimit dhe shkëmbimit të ideve në fushën e kulturës, rinis dhe sportit. Më pas vizituam edhe Galerinë e Muzeut edukativ të Suharekës.

Ka vazhduar punimet Kuvendi Zgjedhor i Këshillit të Veprimit Rinor Lokal. Në këtë Kuvend kanë marrë pjesë tri organizata rinore (Qendra Rinore, Values for better Future dhe Thirrja rinore) dhe dy këshilla të nxënësve (Këshilli i nx. nga gjimnazi “Hamdi Berisha” dhe Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi”). Kuvendi i KVRL-së ka zgjedhur Bordin dhe kryetarin e ri të KVRL-së me mandat dyvjeçar. DKRS, ka ofruar kushtet e nevojshme që Kuvendi Zgjedhor të realizohet me sukses.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional, bashkë me zyrtarin e rinisë Mehdi Krasniqi takuam Drejtorin e Departamentit për Rini, z. Xhevat Bajramin. Në këtë takim diskutuam për projektet me karakter rinor si dhe kërkuam mbështetjen për realizimin e tyre. Drejtori i DiR-it, theksoi se rinia duhet të mbështetet dhe të fuqizohet dhe ne së bashku duhet dhe mund ta bëjmë këtë.

Me qëllim të thellimit të bashkëpunimit ndërmjet DKRS-së dhe OJQ-ve rinore, pritem në takim përfaqësuesit e OJQ-ve rinore, me të cilët diskutuam për zhvillimin e aktiviteteve rinore, me theks të veçantë realizimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal 2021-2023.

Me përfaqësuesit e OJQ-ve u pajtuam që së shpejti të fillojmë me realizimin projektit për fuqizimin e rinisë, zgjedhjen e përfaqësuesve rinorë nëpër fshatra të cilët do të jenë pjesë përbërëse e KVRL-së. Gjithashtu, u pajtuam që të fillojmë me aktivitete njoftuese për vullnetarizmin dhe përfitimet e vullnetarëve rinorë. Përfaqësuesit rinorë njëzëri u shprehën të gatshëm për bashkëpunim në të mirë të rinisë së komunës sonë.

Takim pune kemi zhvilluar edhe me përfaqësuesin e OSBE-së, z. Islam Salihu, me të cilin kemi diskutuar për Planin e Zhvillimit Rinor Lokal 2021-2023. Në këtë takim është njoftuar përfaqësuesi i OSBE-së edhe për funksionalizimin e KVRL-së dhe për zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara për këtë vit.

Bashkë me zyrtarin e rinisë Mehdi Krasniqi, vizituam Qendrën Rinore Publike në Malishevë. Takuam kryetaren e Qendrës Rinore Publike, znj. Albanë Gashi, me të cilën diskutuam për rëndësinë e fuqizimit të rinisë, thellimin e bashkëpunimit, shtimin e numrit të të rinjve në aktivitete rinore. Kryetarja e QR-së, theksoi nevojën e përmirësimit të kushteve të punës, me theks të veçantë riparimin e zyrave të cilat janë dëmtuar shumë nga vërshimet e krijuara nga të reshurat në vitin e kaluar. Gjithashtu u diskutua edhe për nevojën që Qendra Rinore Publike ta

ketë një zyrë në qendër të qytetit- kjo do ta ndihmonte shumë në zhvillimin e aktiviteteve rinore.

Kam realizuar takim zyrtar me përfaqësuesin e OSBE-së, z. Islam Salihu, me kryetaren e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal, znj. Brikenë Kastrati dhe nënkryetarin z. Endrit Mazreku.

Diskutuam për mundësinë e organizimit të disa trajnimeve që janë të nevojshme për të rinjtë, kryesisht për strukturat e OJQ-ve rinore e që janë të planifikuara edhe në Planin e Veprimit Rinor Lokal 2021-2023.

Bashkë me përfaqësuesit e KVRL-së kërkuam nga OSBE që të na mbështesë në realizimin e trajnimeve për hartimin, menaxhimin dhe raportimin e projekt propozimeve dhe të tjera. Përfaqësuesi i OSBE-së z. Islam Salihu u shpreh i gatshëm për thellimin e bashkëpunimit brenda mundësive që ka OSBE-ja.

Në muajin shkurt për nder të shënimit të 14-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës është organizuar turnir Sportiv në Volejbol.

Më datë 15.02.2022, së bashku me Klubin e Volejbollit Malisheva, është organizuar turniri në Volejbol, për nder të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Turniri është organizuar në shkollën "17/Shkurti" në Banjë të Malishevës ku pjesëmarrës ishin këto klubet :

- 1."KV MALISHEVA"- Malishevë
- 2."KV FERONIKELI"- Drenas
- 3."KV THERANDA"- Suharekë
4. "KV VLLAZNIMI"- Gjakovë

Fitues në këtë Turnir:

Vendi i parë--- "KV FERONIKELI"

Vendi i dytë--- "KV MALISHEVA "

Vendi i tretë--- "KV VLLAZNIMI"

Fituesit në fund u shpërblyen me kupa dhe mirënjohje nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, gjithashtu komuna e Malishevës së bashku me DKRS ka mbuluar shpenzimet e ushqimit për ekipet pjesëmarrëse.

Në këtë turnir ishte prezent edhe unë si drejtor i DKRS-së të cilët i përshëndeta të pranishmit dhe ekipet pjesëmarrëse në këtë Turnir të Pavarësisë.

Aty theksova se Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport vazhdimisht i ka përkrahur klubet sportive dhe aktivitetet sportive, por synohet që në të ardhmen kjo mbështetje të jetë edhe më e madhe.

Gjithashtu i urova të pranishmit për 14 vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte 50 Sportistë, ndërsa numri i shikuesve 200.

Së bashku me Kryetarin Ekrem Kastrati, kemi pritur në takim klubin e atletikës “Malisheva”, të prirë nga trajneri Adrian Mazreku.

Atletët e klubit të atletikës “Malisheva”, Olti Bytyçi dhe Enis Bytyçi, së fundmi e kanë përfaqësuar Kosovën në garat ballkanike në salla të mbyllura, që u mbajt në Beograd, duke e shënuar edhe rastin e parë që ekipi nga Kosova, merr pjesë në gara të këtij niveli, në shtetin fqinj, dhe njëherë duke thyer barrierën, që për sportistët tanë deri më tani konsiderohej e paarrtshme, për shkaqe politike. Ekipin e Kosovës në këto gara e ka udhëhequr trajneri Adrian Mazreku.

Gjatë kësaj periudhe bashkë me zyrtarin e sportit Albert Morina dhe zyrtarin Kushtrim Morina kemi vizituar komunën e Suharekës ku u takuam me drejtoreshën Lorika Gashi ku biseduam për shumë çështje të drejtorisë në fokus të veçantë për sportin me theks të veçantë për mënyrën e shfrytëzimit të stadiumit të qytetit.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN MARS SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Më 1 mars, kemi nisur përgatitjet dhe planifikimin për shënimin e Epopesë së UÇK-së. Është formuar këshilli organizativ, në këshillin organizativ ishin 1. Fitim Shala- Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, 2. Milazim Morina- nga zyra e kryetarit, 3. Argjend Thaçi- kryesues i kuvendit, 4. Metush Kryeziu-OVL, 5. Sinan Gegaj-OVL, 6. Kushtrim Morina-zyrtar për kulturë.

Është mbajtur takimi i parë me këshillin organizativ për shënimin e Epopesë së UÇK-së, në këtë takim të këshillit kemi diskutuar për mënyrën e shënimit të kësaj dite, si dhe kemi konkretizuar agjendën aktiviteteve për shënimin e kësaj dite.

Me 2 mars, kemi filluar me përgatitjet e agjendës dhe ftesave, më pas kemi bërë shpërndarjen e ftesave tek familjaret e dëshmorëve dhe në institucione në Komunën e Malishevës.

Më 5,6,7 mars, në kuadër të shënimit të manifestimit “Epopeja e UÇK-së”, kemi organizuar aktivitete të ndryshme. Aktivitetet kanë filluar me seancë solemne më pas janë bërë nderime pranë shtatores së Komandantit Legjendar “Adem Jashari” në Malishevë, homazhe në varrezat e dëshmorëve në Malishevë, Kleçkë dhe në Prekaz. Gjithashtu, kemi organizuar transportin dhe drekë për familjet e dëshmorëve.

Aktivitetet e manifestimit “Epopeja e UÇK-së” janë përmbyllur me ndezjen e flakadanëve në kompleksin “Kodra e UÇK-së” në Ngucat.

Me 25 mars, si anëtar i komisionit për hartimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2022, kam marr pjesë në konsultimin publik lidhur me këtë draft rregulloren dhe kemi mbrojtur sugjerimet tona.

Me 29 mars, kam përgatitur dhe shpërndarë agjendën dhe ftesat me rastin e shënimit të 23-vjetorit të masakrës së Burimit.

Me 30 mars kemi marrë pjesë në promovimin e librit "Gjëma e Burimit" nga autori Habib Zogaj, në hapësirat e bibliotekës kombëtare, ku është shfaqur edhe dokumentar për masakrën e Burimit.

Me 31 mars, sipas agjendës është mbajtur një mbledhje përkujtimore dhe janë bërë homazhe në Kompleksin Memorial në vendin e ngjarjes (Vrella e Mëhillit) në fshatin Burim, dhe më pas homazhe te varrezat e martirëve në Dragobil.

Kemi pritur në takim përfaqësuesit e KFOR-it (CIMIC) italian, me të cilët ka diskutuar për mundësinë e renovimit të Qendrës Rinore në Malishevë.

Gjithashtu, përfaqësuesit e CIMIC janë njoftuar edhe për zhvillimin e aktiviteteve rinore dhe nevojat e të rinjve të komunës së Malishevës.

Përfaqësuesit e CIMIC-ut italian u shprehën të gatshëm që të bëjnë renovimin e objektit të Qendrës Rinore Publike në Malishevë.

Kam zhvilluar takim me zyrtaren për Barazi Gjinore, znj. Vera Bytyçi me të cilën kemi diskutuar për organizimin e debatit me të rinj për fuqizimin e rinisë dhe barazinë gjinore. Ky debat do të realizohet në muajin mars dhe pjesë e panelit do të jetë edhe z. Mark Kaqinari-Këshilltar në Zyrën e Avokatit të Popullit. Në këtë debat kemi planifikuar të marrin pjesë 35 të rinj.

Kam pritur në takim zyrtarin OSBE-së, z. Islam Salihu, me të cilin kemi diskutuar rreth vullnetarizmit, zbatimit të UA nr. 01/2016 për Punën Vullnetare të të Rinjve, për Rregullores nr. 02/404, për Fuqizimin dhe Promovimin e Vullnetarizmit në Komunën e Malishevës, fushatat vetëdijesuese për vullnetarizëm si dhe bashkëpunim me Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport, për punësimin e të rinjve dhe për mundësinë e trajnimeve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve si dhe fuqizimit të sektorit të rinisë.

E informova zyrtarin që jemi duke e zbatuar UA nr. 01/2016 për Punën Vullnetare të të Rinjve, Rregulloren nr. 02/404, për Fuqizimin dhe Promovimin e Vullnetarizmit në Komunën e Malishevës, gjithashtu edhe për fushatat vetëdijesuese për vullnetarizmin që i kemi bërë në të kaluarën dhe ato që pritet t'i bëjmë shumë shpejtë.

Kam pritur në takim përfaqësuesit e OJQ-ve rinore, me të cilët kemi diskutuar për organizimin e debatit me karakter rinor: "Fuqizimi i Rinisë dhe Barazia Gjinore" si dhe për realizimin e aktiviteteve rinore që janë të parapara në Planin e Veprimit Rinor Lokal 2021-2023.

Në këtë takim është përcaktuar numri i pjesëmarrësve dhe mënyra e organizimit të debatit. Përfaqësuesit e OJQ-ve rinore janë shprehur të gatshëm që të japin kontributin e tyre në organizimin e këtij debati.

Në kuadër të aktiviteteve për fuqizimin e rinisë në Malishevë, në bashkëpunim me zyrtaren për Barazi Gjinore, znj. Vera Bytyçi realizuam debatin me temën "Fuqizimi i Rinisë dhe Barazia Gjinore"

Në këtë debat mori pjesë edhe Këshilltari Ligjor në Zyrën e Avokatit të Popullit, z. Mark Kaqinari si dhe përfaqësuesit e OJQ-ve rinore dhe të rinj të tjerë.

Të pranishmit i përshëndeta edhe ofrova mbështetjen time si drejtor dhe si institucion për përkrahjen e rinisë.

Debati është fokusuar më shumë në fuqizimin e rinisë, zbatimin e Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, roli i komunës në fuqizimin e rinisë, pjesëmarrja e rinisë në vendimmarrje, promovimi i vullnetarizmit, barazia gjinore, promovimi i barazisë gjinore, roli i Zyrës së Avokatit të Popullit, mbrojtja e të drejtave të njeriut, mosdiskriminim gjinor dhe dhuna në familje. Të rinjtë parashtruan pyetje për Këshilltarin Ligjor të Zyrës së Avokatit të Popullit për çështje të ndryshme, për të cilat edhe morën përgjigje. Komuna e ka mbështetur financiarisht këtë debat.

Në kuadër të aktiviteteve të organizuara për shënimin e "Epopesë së UÇK- së", është organizuar turniri në futboll të femrave.

Ky aktivitet sportiv është organizuar në bashkëpunim me klubin e futbollit KFF "Malisheva", dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Në këtë turnir morën pjesë 3 ekipe nga komuna e jonë.

Ekipet pjesëmarrëse në turnir ishin:

KFF "Malisheva"

KFF "Shqiponja"

KFF "16 Qershori"

Fitues i këtij turniri ishte KFF "16 Qershori"

Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte 54 Sportistë, ndërsa numri i shikuesve 100.

Gjatë këtij muaji në kuadër të aktiviteteve të drejtorisë, e kemi vizituar stadiumin e qytetit "Liman Gegaj" në Malishevë, me qëllim të njoftimit me punimet që janë duke u realizuar në stadiumin e qytetit, përkatësisht në ndërtimin e tribunave dhe zhveshtoreve në stadium.

Pas njoftimit me punimet që janë duke u realizuar në stadium, kam kërkuar nga ana e operatorit, që të intensifikoj punimet në ndërtimin e zhveshtoreve dhe pjesës së tribunës, me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira dhe sipas standardeve të kërkuara, për zhvillimin e garave sportive.

Kam realizuar takim me drejtorin e departamentit të infrastrukturës sportive në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ku kemi diskutuar për projektet e nevojshme në komunën e tone, me theks të veçantë ndërtimin e tribunave të stadiumit, të cilat janë në ndërtimin e punimeve të vrazhda.

Stadiumi i qytetit "Liman Gegaj" në Malishevës, krahas fushës së futbollit, e ka edhe shtegun e atletikës, prandaj zgjerimi me tribuna, zhveshtoret dhe hapësira tjetër, është e nevojshme në këtë stadium.

Gjatë kësaj kohe kam vizituar komunën e Drenasit ku u takuam me drejtoreshën Laureta Thaqi ku biseduam për shumë çështje të drejtorisë, në fokus të veçantë për sportin dhe projekte të ndryshme, biseduam për projektin e tribunave të stadiumit të qytetit në këtë komunë.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, i ka përkrahur të gjitha aktivitetet sportive që janë pasqyruar në këtë raport. Numri i pjesëmarrësve të përfshirë në aktivitetet është rreth 300.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN PRILL SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Gjatë këtij muaji jemi marrë intensivisht për procesin e rivarrimit të dëshmorit të kombit Brahim Islam Morina nga fshati Drenoc, të cilin e kemi rivarrosur në kompleksin e varrezave të dëshmorëve në Malishevë. Po ashtu, është mbajtur edhe një akademi përkujtimore kushtuar dëshmorit Brahim Islam Morina që është mbajtur në 23 vjetorin e rënies së tij. Në akademi përkujtimore kanë marrë pjesë rreth 500 persona dhe është mbajtur nën përkujdesjen e kryetarit të komunës z. Ekrem Kastrati dhe është organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Si DKRS jemi marrë me të gjitha organizimet, përgatitjen e agjendës, përgatitjen e ftesave dhe shpërndarjen e tyre, zërimin, pikat muzikore, moderimin, etj

Kam pasur takim me rapsodët Sali e Feriz Krasniqi, të cilët kanë siguruar ftesat për të marrë pjesë në Festivalin Ndërkombëtar Muzikor në Llangolen të Anglisë i cili mbahet në këtë vit, ata do të paraqiten me veshje kombëtare në atë festival. Së bashku me ata e kemi bërë një kërkesë/rekomandim për Ministrinë e Kulturës ku i kemi kërkuar mbështetje financiare për pjesëmarrje në këtë festival.

Gjithashtu, kemi dhënë sugjerimet tona dhe kemi propozuar që hapësirën që kemi menduar të ndërtojmë stadiumin ndihmës të planifikohet në hartat zonale dhe në planin zhvillimor komunal. Kam pritur në takim zyrtarët e departamentit të infrastrukturës sportive në kuadër të Ministrisë së Kulturës, ku kemi kërkuar nga ata që të na japin sugjerimet e tyre lidhur me ndërtimin e zhveshtoreve që janë në ndërtim e sipër te stadiumi i qytetit “Liman Gegaj” ku së bashku me ata i kemi dhënë sugjerimet për ndryshim drejtorisë së urbanizmit. Problemet të cilat janë shfaqur aty janë probleme me ndriçim, ventilim, numri i vogël i tualeteve dhe hapësirat për zyre. Po ashtu, kemi kërkuar nga drejtoria e urbanizimit që të kërkojë nga kompania rritjen e dinamikës së punëve në zhveshtore.

Kam marrë pjesë në konstituimin e kolegjiut të drejtorëve të Kulturës, Rinisë dhe Sportit në kuadër të Asociacionit të Komunave. Në këtë kolegjiut janë zgjedhur strukturat udhëheqëse të kolegjiut ku me mbështetje unanime të të pranishmëve jam zgjedhur anëtar i kryesisë së kolegjiut të drejtorëve të Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Janë mbajtur garat regjionale në futsall që është mbështetur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nga thirrja publike 2021. Së bashku me zyrtarin e sportit Albert Morina kam marrë pjesë në këto gara dhe kam bërë shpërndarjen e mirënjohjeve, kupave dhe medaljeve për shkollat fituese. Shkollat fituese në garat regjionale në futsall nga komuna e Malishevës kanë marrë pjesë në garat rajonale në Gjakovë. Në këto gara kanë arritur të nxënë vendet e para ekipi i femrave i SHFMU “Visar Krasniqi” nga Drenoci dhe ekipi i femrave SHML “Hamdi Berisha” nga Malisheva.

Së bashku me kryetarin e komunës z. Ekrem Kastrati i kemi pritur në komunë për t'i falënderuar të gjitha shkollat pjesëmarrëse dhe fituese duke i uruar suksese në garat republikane.

Kam pasur takim me OJQ-të Kulturore, Rinore dhe Sportive ku kemi diskutuar për problemet me të cilën ballafaqohen ata, idetë e tyre për aktivitete të ndryshme në komunën e tonë si dhe kemi diskutuar edhe për disa kriteret të cilat i kemi punuar për Thirrjen Publike për subvencionim të OJQ-ve.

Gjatë muajit prill kam përgatitur kriteret për thirrjen publike për subvencionim të OJQ-ve, ku edhe i kam rekomanduar kryetarit të komunës z. Ekrem Kastrati që thirrjen publike ta bëjmë mbi bazën e atyre kriterëve në mënyrë që të kemi ndarje sa më të mirë të subvencioneve për klubet sportive, organizatat kulturore e rinore që veprojnë në komunën e tonë. Gjithashtu kam punuar në përgatitjen e shkresave, kërkesave të ndryshme që lidhen me thirrjen publike. Pas gjithë këtyre punëve kemi arritur që në muajin prill të bëjmë edhe shpalljen për thirrje publike e cila është hapur me datë 21.04.2022 dhe mbyllet me datë 16.05.2022 në ora 16:00. Thirrja publike për subvencionimin të OJQ-ve është bërë në bazë të rregullores së MF, nr. 04/2017 mbi kriteret dhe standardet dhe procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Gjithashtu, siç është e përcaktuar edhe me rregullore kemi bërë edhe shpalljen publike për Ekspert të Jashtëm për Komisionin Vlerësues për shqyrtim të projekt propozimeve nga OJQ-të. Po ashtu kemi formuar edhe komisionin për shqyrtimin e aplikacioneve për thirrjen publike për ekspert të jashtëm.

Kemi pranuar dhe shqyrtuar shumë kërkesa nga klubet sportive dhe organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në komunën e Malishevës, ku disa prej tyre i kemi rekomanduar për zyre të kryetarit dhe ministrisë së kulturës.

Si DKRS kemi filluar përgatitjet për organizmin e ditës së çlirimit të komunës së Malishevës që është me 16 qershor. Kemi bërë kërkesë për binë, zërim dhe elementet të tjera të cilat nevojiten për organizimin e 16 qershorit (akademinë solemne, ndarjen e çmimeve, konkurset pamore letrare e artistike si dhe organizmin e koncertit festiv që planifikohet të mbahet në parkun e qytetit me artistë të mirënjohur).

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN MAJ SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Me 5 maj, kemi mbajtur takimin e dytë me përfaqësuesit e OJQ-ve Kulturore, gjatë këtij takimi kemi diskutuar për procesin e aplikimit në thirrjen publike, për aktivitetet që janë të parapara të përkrahen nga kjo thirrje. Po ashtu diskutuam edhe për organizimin e aktiviteteve dhe Ekspozitën Artistike që tashmë është tradicionale për çdo manifestim të 16 qershorit- Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të UÇK-së. Në këtë takim ishim 6 pjesëmarrës.

Me 10 maj, kemi vizituar mullirin e Mehmet Alis në Marali-Shkozë dhe mullirin e Islam Zenelit në Pagarushë, për të parë nga afër punimet të cilat janë duke u bërë në restaurimin e këtyre dy objekteve të trashëgimisë kulturore.

Investitori i këtyre dy vlerave të trashëgimisë është Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa organi mbikëqyrës është Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në Prizren.

Gjatë muajit Maj kam pasur takim me të gjithë punëtorët e DKRS-së, në këtë takim është diskutuar për ecurinë e punës dhe është kërkuar nga punëtorët që të angazhohen të gjithë në aktivitetet që do të realizohen për nderë të 16 Qershorit. Në këtë takim ishim 9 pjesëmarrës.

Me 24 maj kam pritur në Muzeun e Qytetit "Jahir Mazreku", Shkollën fillore nga fshati Bellanicë, vizitë kjo e planifikuar nga shkolla. Gjatë vizitës nxënësit u njoftuan nga afër me Muzeun dhe artefaktet e trashëgimisë kulturore që janë të ekspozuara në Muze. Po ashtu, nxënësit vizituan edhe Bibliotekën e Qytetit, ku u priten nga Menaxherja e Bibliotekës. Pjesëmarrës në këtë vizitë ishin rreth 20 persona.

Me 27 maj, kemi nisur përgatitjet dhe planifikimin për shënimin 16 Qershorit -Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Malishevës. Kemi konkretizuar agjendën aktivitetëve për shënimin e kësaj dite. Po ashtu kemi përgatitur dhe publikuar konkursin artistik në lëmin e artit pamor, letrar dhe muzikor. Kam pasur takim me këshillin organizativ të 16 qershorit.

Me kërkesë të përfaqësuesve të OJQ-ve rinore është mbajtur takimi konsultues, ku është diskutuar për formatin e projekt propozimeve, rëndësinë e aplikimit të organizatave në thirrjen publike për subvencionim si dhe për realizimin e aktivitetëve me karakter rinor që ata planifikojnë t'i realizojnë gjatë këtij viti. Përfaqësuesit e OJQ-ve kanë kërkuar që materiali i thirrjes publike t'iu përcillet edhe nëpërmjet postës elektronike.

Përfaqësuesit e KVRL-së dhe të Qendrës së Rinisë shprehën shqetësimet e tyre për mungesën e zyrave në këtë kohë, kur duhet të përgatitet i tërë dokumentacioni për të aplikuar në thirrjen publike për subvencionim (Qendra e Rinisë është jashtë funksionit për shkak të dëmtimeve të pësura nga vërshimet vite më herët, ndërsa edhe hapësira e siguruar përkohësisht në objektin e shtëpisë së kulturës paraqet pengesë sepse ka defekte të energjisë elektrike).

Kam zhvilluar takim me drejtorin e Departamentit të Rinisë pranë Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, z. Xhevat Bajrami. Me drejtorin z. Bajrami kemi diskutuar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet DKRS-së dhe DiR-it në të mirë të rinisë. E kam njoftuar për aktivitetet rinore që kemi planifikuar t'i realizojmë për këtë vit me OJQ-të rinore në komunën e Malishevës.

Është mbajtur trajnimi dyditorë me temën "Menaxhimi e projekteve dhe implementimi hap pas hapi i projekteve", ku janë trajnuar 15 të rinj nga komuna e Malishevës. OSBE, i ka mbuluar të gjitha shpenzimet financiare për realizimin e këtij trajnimi. Trajnimi është realizuar në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet DKRS-së-sektori për rini dhe OSBE-së- zyra rajonale në Prizren.

Të rinjtë, pjesëmarrës në këtë trajnim janë përgatitur për menaxhimin e projekteve dhe implementimin e tyre dhe do të jenë të gatshëm të japin kontributin e tyre në organizatat ku ata janë anëtarë. Ky trajnim është pjesë e fuqizimit të rinisë në komunën e Malishevës.

Gjatë këtij muaji kam pasur takime me disa nga përfaqësuesit e klubeve sportive ku është diskutuar për çështje të ndryshme sportive, kemi biseduar për vështirësitë me të cilat përballen këto klube sportive të cilat bëjnë gara në nivele të ndryshme garuese.

Së bashku me kryetarin e komunës z. Ekrem Kastrati kam marrë pjesë në garat e kupës së Kosovës në Atletikë e cila është mbajtur në stadiumin e qytetit "Liman Gegaj" në të cilën klubi i Atletikës Malisheva fitoi vendin e parë.

Kemi bërë përgatitjet për turnirin tradicional "Ibrahim Mazreku" në futboll të vogël që mbahet më 16 qershor.

Gjatë këtij muaji kam bërë përgatitjen e kontratave për të gjitha OJQ-të të cilat kanë përfituar nga thirrja publike e cila është shpallur nga DKRS.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN QERSHOR SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Me 1 qershor, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, kemi organizuar shfaqje teatrale për fëmijë "DASHURI NË FUND TË DETIT" me aktorët e teatrit DODONA. Kjo shfaqje u realizua në Shtëpinë e Kulturës "Tahir Sinani" në Malishevë. Të pranishëm për ta shikuar këtë shfaqje teatrale ishin rreth 200 fëmijë.

Me 2 qershor, së bashku me zyrtarin e kulturës, kemi vizituar Xhevat Zogaj në fshatin Turjakë, mbledhësi dhe ruajtësi i qindra eksponateve dhe artefakteve që ruhen në një hapësirë private në oborrin e shtëpisë së tij. Gjatë vizitës që bëmë ne pamë nga afër shumë artefakte që kanë vlerë për trashëgimin kulturore por që kushtet për tu ruajtur në këtë hapësirë nuk janë të përshtatshme, andaj ne kërkuam nga personi në fjalë që këto artefakte ti sjell në Muzeun e Qytetit "Jahir Mazreku" në mënyrë që këto eksponate dhe artefakte të ruhen dhe ekspozohen në Muzeun e Qytetit "Jahir Mazreku" në Malishevë. Pas shumë përpjekjeve për ta bindur kjo ishte e pamundur tani për tani, pasi që qëllimi i tij ishte të zgjeroj hapësirat ku i mban këto eksponate të ndryshme ku dhe kërkoj nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ta ndihmojnë për ndërtimin e një objekti më të përshtatshëm për ruajtjen e eksponateve.

Kam takuar përfaqësues nga Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, në lidhje me restaurimin e Mullirit të familjes Januzaj në Senik, ku pronarët e këtij aseti të mbrojtur nuk kanë lejuar që të fillohet të bëhet restaurimi i këtij aseti, ku më pas janë njoftuar organet përgjegjëse nga Drejtoria e Inspektoratit me kërkesë të Qendrës Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Prizren. Më pas pronarët e këtij aseti janë njoftuar që do të jenë prezent organet e Policisë së Kosovës nëse pengohet operatori ekonomik të kryej punimet gjatë restaurimit të mullirit.

Me datën 15 qershor, bashkëpronarët e Mullirit të familjes Januzaj, kanë dhënë pëlqimin për Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren, për të filluar punimet e restaurimit të Mullirit të familjes Januzaj, me kusht që të propozohet nga QRTK ndarja e Mullirit nga Hambari me numra të veçantë unik.

Më 15 qershor, në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës, janë zhvilluar aktivitete kulturore dhe sportive. Sipas planifikimit në bashkëpunim me Organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në komunën e Malishevës kemi organizuar:

Orë letrare, ku është bërë edhe publikimi i rezultateve të konkursit artistik në lëmin e krijimeve letrare, ku morën pjesë 16 punime në këtë lëmi, pas vlerësimit të komisionit të përbërë prej 3 anëtarëve me vendin parë u vlerësua poezia "Të çliruar për herë" nga autorja Albulenë

Krasniqi, me vendin e dytë u vlerësua poezia “Ushtar nana të ka beku” nga autorja Luljeta Telaku dhe me vendin e tretë u vlerësua poezia “Grua e hekurt në luftë për liri” nga autori Rudi Berisha. Ky aktivitet u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës, ku të pranishëm në këtë orë letrare ishin rreth 20 persona.

Ekspozita artistike dhe publikimi i rezultateve të konkursit në lëmin e pikturës, kjo ekspozitë kolektive u organizua në Muzeun e Qytetit “Jahir Mazreku” në Malishevë. Në këtë Ekspozitë morën pjesë shumë artistë dhe artdashës të artit pamor me gjithsej 23 punime dhe pas vlerësimit të komisionit, me vendin e parë u vlerësua punimi i z. Luan Jakupi, me vendin e dytë u vlerësua punimi i z. Nderim Bytyçit dhe me vendin e tretë u vlerësua punimi i z. Milaim Kryeziut. Të pranishëm në hapjen e kësaj ekspozite kolektive ishin rreth 50 persona.

Konkursi artistik në lëmin e artit muzikor, ku kanë konkurruar gjithsej 9 këngë, më pas komisioni vlerësues në përbërje prej 3 anëtarëve ka vlerësuar me kujdes secilën këngë dhe ka arritur në këtë përfundim: me vendin e parë u vlerësua kënga “Babë e Birë” e kënduar nga Arton dhe Aris Zogaj, me vendin e dytë u vlerësua kënga “Gjuha e Ëmbël” e kënduar nga Naxhije Bytyqi dhe Resmije Krasniqi dhe me vendin e tretë u vlerësua kënga “Ngoni Vëllezër e Ngoni Miq” e kënduar nga Taulant Gashi.

Me 16 qershor, shënimi i Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të komunës së Malishevës, ka nisur me vizitën dhe vendosjen e buqetave me lule të Shtatorja e Komandantit Legjendar “Adem Jashari” në Malishevë, më pas kemi vazhduar me homazhe të varrezat e Dëshmorëve në Malishevë, Kleçkë dhe Prekaz.

Për nderë të Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të komunës së Malishevës kemi shtruar drekë për familjet e Dëshmorëve të komunës së Malishevës dhe për mysafirët.

Pas homazheve kemi vazhduar me mbledhjen solemne të Kuvendit Komunal, Akademisë Përkujtimore, ndarjen e çmimeve tradicionale të kuvendit komunal, programin kulturor-artistik që është mbajtur në shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm të gjithë strukturat lokale, familjet e Dëshmorëve dhe mysafirë të shumtë brenda dhe jashtë vendit. Për të nderuar këtë datë historike dhe për të begatuar edhe më shumë këtë aktivitet me programin e tyre artistik ishin Ansambli “Shota”, poeti i mirënjohur Mirush Kabashi dhe anëtari i Filarmonisë së Kosovës Liridon Sadriu. Në këtë aktivitet të pranishëm ishin rreth 500 pjesëmarrës.

Pas tubimit qendror kemi vazhduar me Koncertin në Parkun e Qytetit, në të cilën kanë marrë pjesë këngëtar, Shoqëri Kulturore Artistike dhe grupe të ndryshme të muzikës, këngëtarë të njohur të vendit tonë. Gjatë kësaj mbrëmje, janë argëtuar rreth 3700 qytetarë të ndryshëm përfshirë të gjitha moshat. Aktivitetet e planifikuar për organizmin e 16 Qershorit janë përmbyllur me ndezjen e fishekzjarrëve në orën 21:00

Në kuadër shënimit të 16 Qershori-Dita e Çlirimit dhe e Dëshmorëve të Malishevës, më 3 qershor, bashkë me zyrtarin e rinisë kemi realizuar një vizitë në SHFMU “Dëshmorët e Kombit” në Ngucat dhe i kemi dhuruar 300 ekzemplarë librash.

Në bashkëpunim me OSBE-në, është organizuar ceremonia e certifikimit të 30 të rinjve të cilët kanë ndjekur trajnimin dyditor "Menaxhimi e projekteve dhe implementimi hap pas hapi i projekteve". Certifikatat u janë dorëzuar të rinjve nga përfaqësuesi i OSBE-së, z. Islam Salihu, dhe zyrtari për rini. Ky trajnim është realizuar nga OSBE-ja.

Për nderë të 16 Qershorit ditës së Çlirimit dhe ditës Dëshmorëve të Malishevës në bashkëpunim me klubin e futbollit të femrave "16 Qershori" është mbajtur turnir në stadiumin "Liman Gegaj" në Malishevë, ku pjesëmarrës ishin 7 ekipe nga vende të ndryshme, në fund të turnirit fitues dolën:

-Vendi i parë: KFF "16 Qershori"-Malishevë

-Vendi i dytë: KFF "Dukagjini"-Klinë

-Vendi i tretë: KFF "Shqiponja"-Malishevë

Golashënuesja më e mirë: Vesa Krasniqi (KFF "Shqiponja"), lojtarja më e mirë: Dorina Qorri KFF "16 Qershori", portierja më e mirë Anita Krasniqi (KFF "16 Qershori", ekipi më Fair Play: KFF "Dukagjini". Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte 140 Sportiste, ndërsa numri në tribuna ishte rreth 200.

Për nderë të 16 Qershorit ditës së Çlirimit dhe ditës Dëshmorëve të Malishevës në bashkëpunim me klubin e PingPongut "Llapusha" është mbajtur turnir në Palestrën Sportive "Habib Zogaj" në Malishevë, ku pjesëmarrës ishin garues nga vende të ndryshme, në fund të turnirit fitues i vendit të parë doli Afrim Veliu nga klubi i PingPongut "Llapusha", në fund fituesit u shpërblyen me kupa dhe mirënjohje nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte 15 Sportistë, ndërsa numri i shikuesve rreth 30.

Për nderë të 16 Qershorit ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës në bashkëpunim me klubin e Futsallit "Malisheva" është organizuar turnir në futboll të vogël për meshkuj në qendrën sportive "Fusha Jonë" në Lubizhdë ku pjesëmarrës ishin 75 ekipe nga vend të ndryshme të Kosovës.

Në Finalen e këtij turniri është organizuar një lojë miqësore ndërmjet komunës së Malishevës dhe komunës së Klinës, ku kanë marrë pjesë kryetarët së bashku me drejtorët. Kjo miqësore është zhvilluar për nderë të Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të komunës së Malishevës.

Fituesit në këtë turnir ishin:

-Vendi i parë: KF Special Event

-Vendi i dytë: KF Nili

-Vendi i tretë: KF Mon Ami

Fituesit në fund u shpërblyen me kupa dhe mirënjohje nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte 750 Sportistë, ndërsa numri i shikuesve rreth 1500.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, i ka përkrahur të gjitha aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive që janë realizuar gjatë muajit qershor.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN KORRIK SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Gjatë këtij muaji me kërkesën tone dhe me aprovimin e kryetarit kemi nxjerrë vendimin për themelimin e këshillit organizativ për organizimin dhe manifestimin e Festivalit Folklorik “Oda e Llapushës” që do të mbahet më 1 dhe 2 gusht 2022.

Pas themelimit të këshillit organizativ kemi mbajtur mbledhjen e parë me të cilën kemi diskutuar për problemet që janë shfaqur në vitet e kaluara në organizimin e festivalit dhe kemi diskutuar se si ti mënjanojmë ato probleme. Në këtë mbledhje kemi rënë dakord fillimisht për çështje teknike siç janë: bina, zërimi, skenografia, mirënjohjet, ftesat, çmimet, baneri, billbordet, njoftimet dhe në përgjithësi për piarin e festivalit. Gjithashtu, në këtë mbledhje kemi bërë edhe specifikacionin e çmimeve të festivalit ku edhe kemi pasur rritje të çmimeve të festivalit.

Pas mbledhjes së këshillit kemi filluar më përgatitjen e çështjeve teknike, ftesa, baner, zërim, karrika, tavolina, etj. Gjithashtu, kemi bërë kontaktimin e grupeve artistike brenda Kosovës dhe jashtë saj, duke ftuar grupe artistike nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Medvegjë, Bujanoc e Preshevë dhe grupe artistike nga diaspora.

Gjatë këtij muaji kemi mbajtur edhe takimin e dytë të këshillit organizativ të festivalit, në këtë takim është vendosur për jurinë profesionale të festivalit, Prof. Zymer Neziri, Adem Zejnullahu dhe Haki Mulliqi, dhe mysafir nderi i festivalit të jetë këngëtarja Shkurte Fejza dhe për moderim Myrvete Uka.

Gjatë këtij takimi të këshillit organizativ u vendos që të ndahen edhe disa mirënjohje për rapsodë, të cilët kanë dhënë kontribut në mbajtjen, ruajtjen dhe promovimin e folklorit burimor shqiptar në komunën e Malishevës.

Gjatë këtij aktiviteti kemi paraparë edhe organizmin e panairit artizanal dhe së bashku me OJQ “Fatjona” kemi bërë të gjitha përgatitjet që panairi të mbahet më 1 dhe 2 gusht dhe që do ti paraprijë festivalit folklorik “Oda e Llapushës”.

Po ashtu, në muajin korrik kam filluar përgatitjet edhe për festivalin rinor “MAL FEST” i cili do të organizohet për herë të parë në komunën tonë, së bashku me OJQ-të në komunën tonë dhe në bashkëpunim me biznese të shumta brenda dhe jashtë komunës sonë. Ky festival ka karakter rinor dhe do të përcjelljet me aktivitete të tjera rinore, siç janë: ekspozita me fotografi, gara në rrjete sociale për fotografinë më të mirë. Gjithashtu, në këtë festival biznese të shumta do të jenë prezente me pijet dhe ushqimet e tyre. Ky festival do të mbahet në parkun e qytetit me datë 12 dhe 13 gusht.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN GUSHT SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Me 1 gusht, krahas Festivalit Folklorik “Oda e Llapushës”, për dy ditë është hapur edhe panairi me punë artizanale, i cili këtë është organizuar në hapësirat e oborrit të Muzeut të Qytetit në këtë panair janë prezantuar punimet e dorës në veshje, si dhe të ushqimeve tradicionale.

Panairi është organizuar nga shoqata e gruas “Fatjona” në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport. Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte afër 20 pjesëmarrës, ndërsa numri i vizitorëve ishte rreth 2600 vizitorë.

Më 1 dhe 2 gusht, kemi organizuar Festivalin Folklorik “Oda e Llapushës” – edicioni i shtatë, një festival me karakter garues gjithëkombëtar, në këtë festival u prezantuan vlera të larta të folklorit shqiptar, ku morën pjesë rapsod të shumtë, Shoqëri kulturo-artistike, Ansamblet e këngëve dhe valleve nga të gjitha trevat shqiptare dhe diaspora.

Festivali filloi me defileun artistik, të grupeve, shoqërive kulturore-artistike, rapsodëve. Defileu ka nisur në orën 18:00, duke filluar nga Rruga “Hamdi Berisha” pranë KEDS-it deri të Sheshi i Dëshmorëve në qendër të qytetit.

Nata e parë e festivalit filloi në orën 19:00, ku u prezantuan 12 pikët pjesëmarrëse përfshirë rapsodë, grupe, ansamble kulturore.

Po ashtu, edhe nata e dytë e festivalit filloi në orën 19:00 dhe u prezantuan 16 pika konkurruese, ku pjesëmarrja e shikuesve ishte shumë e madhe. Këtë edicion gjatë kohës ku jurisë iu është dashur të vendos dhe të bënë vlerësimin e pikëve konkurruese na ka nderuar dhe argëtuar këngëtarja e mirënjohur Shkurte Fejza. Në natën e dytë juria profesionale ka bërë ndarjen e çmimeve të fituese të festivalit.

Juria profesionale e cila përcjelli dy netë radhazi Festivalin Folklorik “Oda Llapushës” - edicioni VII, pasi dëgjoi me vëmendje pikat muzikore të cilat u prezantuan në këtë festival, nga solistë, duete, trio, kuartete solistësh dhe grupe e ansamble nga hapësirat shqiptare, juria profesionale, në përbërje: prof. dr. Adem Zejnullahu, studiues i folklorit, prof.dr. Zymer Neziri dhe etnokoreografi Haki Mulliqi, vendosën për këto çmime muzikore:

Vendi i parë, çmimi : “Sali e Feriz Kraniqi”: Ansambli “Deçani”

Vendi i dytë: Ansambli “Përparim Tomçini”

Vendi i tretë: Ansambli “Zëri i Kosovës”

ÇMIMI VETERAN I FOLKLORIT: Kolë Martini

ÇMIMI “BEQIR GASHI”, PËR DEBUTANTIN MË TË RI: Vëllezërit Bajraj;

ÇMIMI I KARRIERËS: Lutfi Istogu dhe Fehmi Nishefci

ÇMIMI I PUBLIKUT: Viktor Paloka

ÇMIMI GRUPI MË I KOMPLETUAR: Mleqni 2

ÇMIMI I DIASPORËS: Blend dhe Haxhi Buçaj

Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte afër 200 pjesëmarrës, ndërsa të pranishëm në të dy netët konkurruese ishte rreth 3000 shikues.

Gjatë këtij muaji, më datë 12 dhe 13 gusht është mbajtur Festivali Rinor “MALFEST”. Ky festival është mbajtur në parkun e qytetit në Malishevë dhe gjatë këtyre dy ditëve kanë performuar

artistë të ndryshëm, brenda dhe jashtë komunës sonë. Gjatë këtij festivali pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë edhe të shërbimit me pije dhe ushqim, në të cilën kanë qenë prezent sponsorët tanë. Festivali ka pasur edhe karakter kulturor, është mbajtur një ekspozitë me disa nga ikonat e muzikës në Malishevë dhe është mbajtur një takim debatues për fotografinë në përgjithësi. Ky festival “MAL FEST” është mbajtur për herë të parë në komunën e Malishevës dhe në të ka pasur pjesëmarrës të shumtë.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN SHTATOR SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Me 22 shtator, së bashku me ekipin e RTK-së, kemi vizituar shpellën e Flladit në Panorc dhe Mullirin e Islam Zenelit në Pagarushë, me qëllim të realizimit të një emisioni “Autokton” që ka të bëjë me promovimin e trashëgimimit kulturore dhe natyrore .

Me datë 26 shtator, duke parë rëndësinë e dy mullinjve të vjetër dhe gjendjen e dy aseteve kulturore në fshatin Ngucat dhe rrezikun e lartë të humbjes, kam përgatitur kërkesën dhe lëndën për Qendrën Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Prizren për futjen në mbrojtje dhe restaurimin e Mullirit të Sylë Sahitit dhe Mullirin e Bajram Ukës në fshatin Ngucat.

Po ashtu, në këtë muaj kam pasur takim me drejtorin e Qendrës Rajonale për Trashëgimi kulturore në Prizren, me të cilin kemi diskutuar për mundësinë e investimeve në Komunën e Malishevës në fushën e trashëgimisë dhe e njoftuam për projektin që do të fillojmë për evidentimin e monumenteve kulturore, natyrore e shpirtërore në Komunën e Malishevës.

Më 15 dhe 16 shtator 2022, organizuar nga KVRL dhe mbështetur nga DKRS është mbajtur Kampi Rinor 2022 në fshatin Berishë. Në këtë kamp janë zhvilluar aktivitetet me karakter garues, lojëra të ndryshme dhe është mbajtur një ligjëratë nga përfaqësuesi i Kryqit të Kuq, z. Isuf Morina. Po ashtu, gjatë këtij kampi është vizituar Radio Kosova e Lirë dhe Kompleksi Memorial i varrezave të dëshmorëve në Kleçkë. Ky aktivitet është mbështetur nga DKRS nëpërmjet thirrjes publike për subvencionimin e OJQ-ve.

Gjatë këtij muaji kam marrë pjesë në diskutimin për draft strategjinë për sportin e cila është duke u punuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Prishtinë dhe ne si DKRS kemi dhënë edhe sugjerimet tona lidhur me këtë strategji.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN TETOR SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Më 7 Tetor 2022, së bashku me zyrtarin e kulturës kemi vizituar Muzeun e Qytetit “Jahir Mazreku” dhe Bibliotekën e Qytetit “Sokol Kryeziu” ku me këtë rast biblioteka është furnizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me donacion afër 570 ekzemplarë librash për bibliotekën e Qytetit.

Më 21 Tetor 2022, kemi filluar me implementimin e projektit dhe vizitat nëpër fshatrat e Komunës së Malishevës me qëllim të evidentimit të monumenteve të trashëgimisë kulturore, asaj natyrore dhe evidentimin e shtatoreve, dhe gjëra tjera që lidhen me trashëgiminë tone kulturore, natyrore e shpirtërore, të cilat mund t’i hasim gjatë hulumtimit në terren. Në këtë rast kemi vizituar fshatin Temeqinë, ku jemi pritur dhe takuar nga kryetari i fshatit Temeqinë z. Hajrush Kavaja.

Në këtë vizitë ne e informuam z. Kavaja për arsyen e kësaj vizite dhe kërkuam informata rreth ndonjë monumenti të trashëgimisë sonë kulturore, natyrore, lapidar të luftës së fundit të UÇK-së, artefakte tjera që ende nuk janë të ruajtura dhe të pidentifikuara.

Në fshatin Temeqinë ndodhet një Shpellë e evidentuar për Drejtorinë tone e cila është e pasur me stalaktite dhe stalagmite, kristale dhe me figura të krijuara në forma të ndryshme, e cila është zbuluar nga i riu Fatmir Zabelaj. Shpella e Temeqinës, është njëra ndër shpellat e veçanta të zbuluara në territorin e Malishevës.

Po ashtu, ne kemi vizituar edhe shtëpinë ku ka qenë shtabi i UÇK-së, dhe në këtë fshat ndodhej edhe busti i Ismet Jasharit, që është i vendosur në Oborrin e shkollës së këtij fshati.

Më 25 Tetor 2022, kemi vizituar fshatin e ri, ku fillimisht jemi takuar me Shefshet Zogajn, i cili na ka informuar për mullirin me rrymë që i ka shërbyer shumë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës njëkohësisht edhe banorëve të fshatit dhe shumë refugjatëve gjatë kohës së luftës. Gjatë vizitës kemi parë që mulliri i rrymës ruhet në një hapësirë tjetër nga vendi ku ka shërbyer më parë, por shihet që gjendja e tij teknike është e ruajtur mirë. Ne kemi marrë disa foto të mullirit njëkohësisht pronari i këtij mulliri ka kërkuar që mulliri të futet në mbrojtje për shkak të historikut që ka.

Në këtë rast kemi vizituar vendin ku ka qenë spitali i Partizanëve, ky objekt gjatë luftës nacionalçlirimtare ka qenë bazë partizane ku përveç të tjerash u strehuan dhe u mjekuan pjesëtarët e radhës partizane të Rakoshit në vjeshtën e vitit 1944. Ku për fat ky objekt është rrënuar dhe në këtë vend është ndërtuar një objekt që nga pamja dukej objekt afarist.

Më 20 Tetor 2022, me ftesë të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal (MZHR) dhe Agjensionit për Zhvillim Rajonal Jug (AZHR jug) kemi marrë pjesë në takimin konsultues ku është prezantuar “Draft dokumenti Kriteret për brendimin e rajoneve zhvillimore” takimi është realizuar në Prizren, ky dokument trajton hollësisht konceptin e brendimit, kërkesat për kriteret, elementet tjera përbërëse si dhe çështje tjera të rëndësishme si: marketing, promovimi, funksionimi etj.

Më 31 Tetor 2022, së bashku me zyrtarin e kulturës kemi bërë inspektimin e punimeve, të cilat janë duke u zhvilluar në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, në të cilën janë të parapara të ndërrohet çatia, dritaret, fasadimi, ndriçimi dhe ngrohja në këtë objekt.

Më 28 tetor janë mbajtur aktivitete të ndryshme rinore e kulturore për të shënuar ditën e rinisë dhe në bashkëpunim me Qendrën Rinore është mbajtur konkursi në artin pamor, gara në ese dhe në poezi.

Poezi:

Vendi I Enis Bytyçi

Vendi II Butrint Bytyçi

Vendi III Edita Gashi

Ese:

Vendi I Lenarta Suka

Vendi II Urinda Mazreku

Vendi III Haxhere Krasniqi

Art Pamor:

Vendi I Tringa Morina

Vendi II Edi Kastrati

Vendi III Anila Mazreku.

Aktivitetet janë mbajtur në hapësirën e Bibliotekës së Qytetit në Malisheve dhe në parkun e qytetit. Pjesëmarrës ishin të rinjtë nga komuna e Malishevës.

Gjatë këtij muaji kam qenë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe kam zhvilluar takim me Drejtorinë e Departamentit të Sportit, me të cilin kemi diskutuar për inventarizimin e zhvështoreve në Stadiumin “Liman Gegaj” në Malishevë. Kemi marrë premtime nga z. Iber Alaj se kjo çështje do të jetë prioritet në MKRS.

Gjatë muajit tetor, më datë 5 tetor, së bashku me kryetarin e Komunës së Malishevës z. Ekrem Kastrati kemi pritur në takim sportistin nga Malisheva, i cili jeton në Zvicër, Luan Rudaj, kampion i botës në sportin e Muay, i njohur edhe si Thai Boxing. Gjatë këtij takimi është diskutuar edhe mundësia për të zhvilluar ndeshje të boxit në komunën e Malishevës, nga boksieri Luan Rudaj.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN NËNTOR SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Gjatë këtij muaji së bashku me zyrtarin për kulturë z. Kushtrim Morina kemi zhvilluar një takim në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ku jemi takuar me sekretarin e kësaj ministrie z. Feim Hoxha. Ky takim u zhvillua me qëllim të informimit në lidhje me projektin për shtëpinë kulturore “Nexhmie Pagarusha” në vendlindjen e saj në Pagarushë. Nga sekretari u informuam se projekti në fjalë është anuluar nga ministri.

Gjatë këtij takimi me z. Feim Hoxha diskutuam edhe projekte të tjera kulturore, rinore e sportive. Po ashtu, në fillim të këtij muaji kemi filluar përgatitjet për shënimin e festave të 28 Nëntorit. Për nderë të shënimit të festave të nëntorit kemi zhvilluar aktivitete të ndryshme:

Më 23 nëntor është mbajtur mbledhja solemne e kuvendit komunal të Malishevës,

Shpallja “Qytetar Nderi” për personalitetet: z. Xhemal Jashari, (vëlla i Dëshmorit Ismet Jashari), z. Skënder Sinani, (vëlla i Dëshmorit Tahir Sinani) dhe z. Shpëtim Idrizi, Deputet në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë.

Në kuadër të agjendës së aktiviteteve për shënimin e 28 nëntorit, më 25 nëntor është përfunduar edhe libri “Dora e Shpresës” e autores Luljeta Telaku. Botimi i këtij libri është mbështetur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Më 28 nëntor, në mënyrë të organizuar janë bërë homazhe nderimi te Shtatorja e Komandantit Legjendar “Adem Jashari” pastaj homazhe te varrezat e Dëshmoreve në Malishevë, Kleçkë dhe Prekaz.

Po në këtë datë është mbajtur ekspozita personale “Vetëm në një Stuhi” e artistit nga komuna e Malishevës Arijon Krasniqi. Punimet e ekspozuara u pritën shumë mirë nga vizitorët e ekspozitës, për faktin që këto punime janë realizuar vetëm me anë të këmbëve. Ekspozita është mbajtur në hapësirat e Muzeut të Qytetit “Jahir Mazreku”.

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 28 nëntorit është realizuar një turnir në futboll të femrave së bashku me KFF “Shqiponja” në Malishevë. Në këtë turnir kanë marrë pjesë ekipe nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia.

Gjatë muajit nëntor kam marrë pjesë në Konferencën për Rini “Dreamin Kosovo” që është mbajtur në Prishtinë. Në këtë konferencë me karakter rinor kanë marrë pjesë përfaqësues rinorë nga komuna të ndryshme të Kosovës, gjithashtu edhe përfaqësues rinorë ndërkombëtar. Organizatori i kësaj konference ka nderuar komunën e Malishevës me mirënjohje për kontributin e dhënë për rini.

Organizuar nga Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, mbështetur nga DKRS, në gjimnazin “Hamdi Berisha” dhe në SH.F.M.U “Ibrahim Mazreku” janë mbajtur ligjërata më temën “Duhani, Alkooli dhe Drogat”. Në këtë ligjëratë, të rinjtë janë njoftuar me pasojat dhe rreziqet që u kanosen për shëndetin dhe jetën nga duhani, alkooli dhe drogat.

Po ashtu, e realizuar nga Këshilli i Veprimit Rinor Lokal dhe e mbështetur nga DKRS, në sallën e asamblesë komunale është mbajtur ligjëratë për vullnetarizmin dhe janë shpërndarë mirënjohjet për vullnetarët nga KVRL. Në këtë organizim është dorëzuar edhe vendimi për njohjen e Këshillit Rinor Lokal nga komuna e Malishevës.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN DHJETOR SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Gjatë këtij muaji kemi filluar me hartimin e kriterëve dhe kemi bërë shpalljen publike për përzgjedhjen e laureatëve për vitin 2022 në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit në komunën e Malishevës. Kemi formuar komisionin dhe gjatë muajit janar të vitit 2023 do të mbahet edhe aktiviteti në fjalë.

Gjithashtu, kemi filluar përgatitjet për krijimin e këndit arkivor të Shqipërisë, e cila do të bëhet në Bibliotekën e Qytetit “Jahir Mazreku” me qëllim që studiuesit tanë të kenë qasje më të lehtë për studim.

Kemi organizuar një mbledhje komemorative për të nderuar dhe vlerësuar veprimtarin dhe atdhetarin Halil Berisha nga fshati Bardh. Pas mbledhjes komemorative kemi filluar me procesin e varrimit në kompleksin e varrezave në Kleçkë.

Me 27 dhjetor, kam përgatitur planin e punës për sektorin e kulturës për vitin 2023, po ashtu kam përgatitur edhe raportin e punës për vitin 2022.

Është mbajtur trajnimi me temën “Avokimi, përfshirja e të rinjve në nivel lokal”, në të cilin kanë marrë pjesë 14 të rinj. Ky trajnim është mbështetur nga OSBE dhe është organizuar në

bashkëpunim me DKRS. Të rinjtë janë njohur e përgatitur për sfidat, problemet, mënyrat se si duhet të përfshihen në avokim dhe në vendimmarrje, për të drejtat e tyre në lidhje me vullnetarizmin, beneficionet që ua garanton rregullorja për vullnetarizëm e miratuar nga komuna e Malishevës, UA për vullnetarizëm dhe Ligji për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë. Gjithashtu, të rinjtë janë trajnuar edhe për organizimin e punës vullnetare, trajtimi i vullnetarëve, të drejtat dhe obligimet e ndërsjella.

Organizuar nga Qendra e Rinisë dhe mbështetur nga DKRS, janë mbajtur ligjërata për vullnetarizmin në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” dhe në Gjimnazin “Hamdi Berisha”. Në këtë ligjëratë të rinjtë janë njohur me mënyrën se si organizohet puna vullnetare dhe përfitimet nga kjo punë. Të rinjtë janë pajisur me certifikata të pjesëmarrjes në ligjëratë. Ky aktivitetet është mbështetur nga DKRS nëpërmjet Thirrjes Publike për subvencionimin e OJQ-ve.

Me ftesë nga Lidhja Rajonale e Futbollit në Prizren, së bashku me kryetarin e komunës z. Ekrem Kastrati dhe me kryetarët dhe drejtorët e DKRS së komunave; Prizren, Suharekë, Mamushë dhe Dragash kemi qenë në një darkë pune, ku kemi diskutuar për zhvillimin e futbollit në rajonin tonë, me theks të veçantë investimet në Stadiumin “Liman Gegaj” në Malishevë.

Kemi filluar me hartimin e planit të punës për vitin 2023 së bashku me zyrtarët e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe në bashkëpunim edhe me OJQ-të kulturore, rinore dhe sportive, jemi duke përgatitur planin e punës ku do të përfshihen aktivitete të shumta për kulturë, rini dhe sport.

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME - DAP

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2022, duke ju falënderuar të gjithë stafit të saj profesional, ka arritur që të realizoj thuajse të gjitha aktivitete e saj të parapara në Planin e Punës, dhe kjo ka ndikuar që Komuna e Malishevës të shënoj një lëvizje pozitive në rankimin e Komunave lidhur me performancën në qeverisje.

Gjithashtu, DAP përveç detyrave të parapara në planin e punës, ka realizuar edhe disa aktivitete të tjera, si më poshtë:

Pajisje me laptopë për asamblistët e Kuvendit Komunal dhe stafin e administratës sipas nevojës.

Krijimi i një formulari standard për adresimin e kërkesave dhe ankesave nga ana e qytetarëve për të gjitha institucionet komunale.

Funksionalizimi i vijueshmërisë së punës përmes sistemit digjital.

Funksionalizimi i marrjes së pushimeve përmes sistemit elektronik.

Dërgimi i materialeve të nevojshme përmes e-maileve (Asambleja Komunale)

Hapja e e-maileve zyrtare për të gjithë zyrtarët komunalë.

Hartimi i planit për integritet, për çfarë edhe ka fituar edhe çmim nga institucionet qendrore.

DAP, aktivitetet i kryen në sektorin e gjendjes civile, zyrën e pritjes dhe në sektorin e prokurimit, ku për dy të parat keni raport të detajuar, ndërsa lidhur me zyrën e prokurimit keni një shtojcë të veçantë.

Shërbimi i Gjendjes Civile

Shërbimi i Gjendjes Civile në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme të Komunës së Malishevës edhe gjatë muajit Janar- Dhjetor 2022 i ka kryer shërbimet sipas kërkesave të qytetarëve, në harmoni me ligjet dhe rregulloret që aplikohen. Kërkesat janë kryer me kohë dhe gjithëherë janë zgjidhur sipas procedurës duke ju përmbajtur afateve ligjore.

Raporti i këtij shërbimi si vijon;

- Aktvendime për ndërrimin, përmirësimin e emrit apo të mbiemrit personal.....	45
- Aktvendime për njohjen dhe Vërtetimin e ekzistimit të martesës.....	00
-Aktvendime për regjistrime me vonesë në LAL.....	120
-Aktvendime për regjistrime me vonesë në LAV.....	47
- Vërtetim sqarime të ndryshme.....	03
- Anulime të regjistrimeve në LAL.....	10

RAPORT I REGJISTRIMEVE DHE LËSHUARJES SË QERTIFIKATAVE NË SHËRBIMI E GJENDJES CIVILE NË KK MALISHEVË, PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR- 2022

Muaji	Jan ar	Shk urt	Ma rs	Pri ll	Maj	Qersh or	Korr rik	Gus ht	Shtat or	Teto r	Nën tor	Dhjet or	Total
Regjistrime t e reja në LAL	00	00	00	00	00	00	00	00	00	00	00	00	00
Regjistrime t e mëvon. në LAL	10	07	16	10	07	11	17	22	02	08	05	18	133
Regjistrime t e reja në LAM	102	71	51	52	52	43	40	127	06	42	39	91	849
Regjistrime t e mëvon. në LAM	00	00	00	00	00	00	00	00	00	00	00	00	00

Regjistrimet e reja në LAV	19	07	12	09	10	11	05	13	03	04	00	05	98
Regjistrimet e mëvonshme në LAV	04	04	02	03	06	10	05	06	00	01	05	02	42
Çertifikatat e Lindjes	1452	860	1029	1420	1284	1639	1594	2195	887	1186	1549	1328	16431
Çertifikatat Martesore	524	417	426	413	423	392	403	559	388	530	426	414	5315
Çertifikatat e Vdekjes	52	55	42	29	41	35	53	73	56	67	70	73	646
Çertifikatat e Statusit Martesor	269	181	156	171	170	127	140	280	63	02	172	271	2002
Deklaratë për bashkësin familjare	553	509	526	787	468	405	392	475	492	578	511	442	5709
Çertifikatat e Shtetësisë	11	08	13	14	18	16	40	22	07	07	07	09	172
Çertifikatat e Vendbanimit	103	113	132	465	133	122	196	190	132	162	167	133	2048
Ekstrakte të Lindjes	2468	1804	1736	1778	1896	2288	2470	3126	1276	2289	1206	1934	24265
Vertetim nga Arkiva	61	46	37	18	31	37	16	39	15	48	35	36	419

Raport i regjistrimeve dhe i lëshimit të certifikatave në shërbimin e gjendjes civile për regjistrimet e lindjeve, martesave dhe vdekjeve që kanë ndodhur jashtë Kosovës për periodën janar - dhjetor 2022.

muajt Regjistri met	Ja na r	Shk urt	M ar s	Pr ill	M aj	Qers hor	Kor rik	Gu sht	Shta tor	Tet or	Nën tor	Dhjet or	Total
Regjistri met në LAL	19	10	07	12	17	13	29	34	07	18	12	21	199
Regjistri met në LAM	02	02	00	04	00	04	10	13	00	06	00	01	42
Regjistri met ne LAV	00	01	00	01	06	00	04	04	00	03	01	01	21
Çertifika ta e Lindjes	19	08	07	09	15	09	22	30	04	16	06	21	166
Çertifika ta e Martese s	02	01	01	03	01	02	08	11	01	05	00	01	36
Çertifika ta e Vdekjes	00	00	00	02	06	01	04	06	00	02	01	01	23

Raporti nga Zyra e Pritjes:

Zyra e Kryetarit: Kërkesa 500, Aktvendime 597, Njoftime 65, Vendime 357, Vërtetime 61, Autorizime 15, Ankesa 18, Marrëveshje 20, Referenca 13, Shkresa 26, Procesverbale 16, Raporte 46, Formular aplikimi 3, të ndryshme 359. **Gjithsej 2144.**

Asambleja Komunale - Gjithsej 652

Drejtoria e Administratës - Gjithsej 448

Drejtoria për Ekonomi dhe Financa - Gjithsej 1220

Zyra e Prokurimit - Gjithsej 172

Fatura të regjistruara - Gjithsej 1148

Drejtoria e Urbanizmit - Gjithsej 795

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër - Gjithsej 326

Drejtoria për Inspektorat – Gjithsej 1031

Drejtoria për Bujqësi – Gjithsej 500

Drejtoria për Shërbime Publike - Gjithsej 318

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim - Gjithsej 506

Drejtoria për Arsim dhe Edukim – Gjithsej 2202

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - Gjithsej 367

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Gjithsej 104

Në total gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, janë pranuar dhe proceduar 11473 lëndë nga zyra e pritjes.

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM - DMSH

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë kësaj periudhe ka qenë bartëse e aktiviteteve në përgatitjen dhe menaxhimin e emergjencave në territorin e Komunës së Malishevës dhe e cila ka menaxhuar dhe koordinuar me sektorët varës në kryerjen e punëve dhe detyrave të parashtruara sipas Planit të Punës për vitin 2022, në përputhshmëri me ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret që janë në fuqi. Të gjitha sektorët e kësaj drejtorie i kanë kryer punët dhe detyrat e parapara me kohë dhe me sukses.

Gjatë muajit Janar gjendja në territorin e komunës së Malishevës ka qenë e qetë dhe kësaj Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim nuk ka pas raste intervenimi, sigurisht kemi qenë të përgatitur për situata intervenuese, mirëpo fatmirësisht nuk kemi pasur raste reaguese.

Sic edhe e dimë në territorin e komunës së Malishevës gjatë muajve Janar-Shkurt, për shkak të motit të keq kemi vërejtur nga ujërat, konkretisht dalja nga shtrati e lumit Mirusha, shembje të dheut në zona të rrezikuara, mirëpo fatmirësisht gjatë gjithë kësaj kohe kemi qenë në teren dhe kemi vëzhguar situatën nga afër dhe kemi konstatuar se nuk kemi rrezik nga shembjet e dheut.

Gjithashtu nuk kemi vërejtur nga uji, të gjitha ato zona të rrezikuara nga vërshimet janë pa dëme.

Gjatë muajit Mars drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka qenë e ngarkuar me punë në teren, ku si pasojë e temperaturave të larta, ka pasur edhe raste zjarri ku kemi pranuar telefonata nga qytetarët, me të marrë informacion ekipet e zjarrfikësve kanë reaguar në kohë dhe kanë arritur ta shuajnë zjarrin pa shkaktuar dëme në njerëz apo edhe gjëra materiale, konkretisht zjarret kanë

ndodhur në zonat fushore-malore, ku si pasojë edhe nga pakujdesia e qytetarëve ka ardhur deri te zjarri.

Gjithashtu, kemi përgatitur dhe e kemi dorëzuar kërkesën për fillimin e inicimit të procedurave për spërkatjen e zonave të cilat janë të rrezikuara nga ethet Hemorragjike. Gjithashtu është bërë edhe përgatitja e planeve Emergjente; KKSB ku edhe është mbajtur takimi i parë i rregullt me të gjithë akterët të cilët janë në këtë këshill.

Të gjithë sektorët e kësaj Drejtorie i kanë kryer punët dhe detyrat e veta të parashtruara me Ligjet, në kohë dhe me sukses.

Gjatë kësaj periudhe, përkundër rasteve emergjente që kanë ndodhur, e që si pasojë e tyre, nuk ka pasur humbje jete në njerëz, por vetëm dëme jo të konsiderueshme në të mira material, dhe që nuk pasur nevojë për aktivizimin e POEL.

Aktivitetet e veta të angazhimit i ka zhvilluar sipas Planit të Punës së DMSH-së për vitin 2022, duke realizuar aktivitetet si në vijim, dhe atë në:

1. Mirëmbajtjen e Planeve Emergjente për komunën e Malishevës,
2. Mbajtjen e Gatishmërisë së personelit të Drejtorisë dhe (ERE) Ekipeve për Reagim, gjatë situatave Emergjente, dhe OQ-ve (Organizata Qeveritare), të përfaqësuara në KKMSH (Komitetin Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim - Shtabi)
3. Inspektimin e rasteve Emergjente, (zjarreve, vërshimeve, aksidenteve etj) dhe shkaktarëve të rreziqeve, (shembje dheu dhe rreziqet e tjera), duke dhënë rekomandime dhe kërkesa,
4. Hartimin e Plan-Projektit për themelimin e SKMSHN-së (Struktura Komunale për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë),
5. Pjesëmarrja aktive e personelit të DKMSH-së në Grupe punuese për hartimin e Planeve Komunale (Planit të Integritetit, etj.),
6. Koordinimi i punës së KKSB-së (Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi),
7. Përgjigjja ndaj kërkesave të qytetarëve,
8. Paraqitjen e kërkesave për furnizim me mjete të punës, pajisje dhe pranim të personelit si: (pranim të personelit në NjPZSH, veshmbathje dimërore), autoveturë, pajisje të IT, material higjienik dhe administrativë,
9. Menaxhimi i kontratave dhe pjesëmarrja e personelit në komisione për pranimin e punëve, (Ethet hemorragjik KK, dezinfektimi i QKMF, etj)

Njësitë Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim (NjPZSH), i ka kryer detyrat e veta të parashtruara me kohë dhe me profesionalizëm, në përputhshmëri me Ligjin, Udhëzimet administrative, Rregulloren e punës dhe Planin e punës së NjPZSHS për vitin 2022,

Gjatë kësaj periudhe është vazhduar me: Trajnimet e rregullta për zjarrfikësit, regjistrimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, kërkesat për plotësimi me personel dhe mjete teknike, si dhe intervenime në raste emergjente dhe atë me gjithsej 77 dalje në:

1. Shërbime të ndryshme: - 7, (furnizim me ujë, vërshime etj.),
2. Zjarre fushore: - 33,
3. Zjarre në hapësira dhe zjarre malore: - 14,
4. Zjarre në objekte ndërtimore dhe objekte banimi: - 1,
5. Zjarre në objekte ndihmëse: - 2,
6. Zjarre në pajisje elektrike: - 8,
7. Zjarre në ushqim bagëtish dhe stalla: -4,
8. Zjarre në automjete: - 2,
9. Zjarre në Kontejnerë dhe Mbeturina: - 1,
10. Intervenime teknike: -2,
11. Aksidente komunikacioni: -2,
12. Intervenime në FNFT: -1, dhe
13. Thirrje të rrejshme: -1.

Ndërsa, Sektori i Preventivës ndaj zjarrit dhe hulumtimit, gjatë kësaj periudhe ka qenë bartës i aktiviteteve në Inspektimin dhe Preventivën kundër zjarrit në territorin e komunës së Malishevës, duke bërë gjithsej :

- Inspekte fillestare - 10 (në prona private dhe shoqërore),
- Inspekte të rregullta - 5, dhe
- Verifikime - 5,

QOEL (Qendra operative Emergjente Lokale), ka kryer detyrat e veta të parashtruara sipas ligjit, rregulloreve, udhëzimeve administrative që janë në fuqi dhe urdhrave dhe urdhëresave, duke qenë elementi themelor i informimit, vëzhgimit dhe të alarmimit, si dhe duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me Qendra të tjera Operative Emergjente të të gjitha niveleve të Republikës së Kosovës.

Gjatë periudhës së tre mujorit të fundit të vitit 2022, drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka qenë gjatë gjithë kohës e përgatitur për situatat të cilat nga ndryshimi i motit kanë rrezikuar ta godasin me vërshime vendin tonë.

Si pasojë e reshjeve të pandërprera atmosferike, kohë pas kohe të shoqëruara me erëra të fortashtrengata që kanë mbizotëruar prej datës 19-11-2022 e deri më 23-11-2022 në territorin e komunës së Malishevës, nuk ka pasur viktima në njerëz përveç dëmeve të konsiderueshme materiale në infrastrukturë, objekte banimi, lokale ekonomi dhe bujqësi.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim duke e ngritur nivelin e gatishmërisë, ka menaxhuar me situatën duke qenë vazhdimisht në monitorimin e situatës dhe duke u koordinuar me Personelin dhe ekipet për reagim Emergjent, përmes Qendrës Operative Emergjente Lokale, duke qenë vazhdimisht në kontakt me Qendra të tjera Operative të nivelit Regjional dhe atë AME-MPB-së.

Përmes QOEL, janë mbajtur kontaktet e vazhdueshme me KEDSI-në Hidroregjionin Jugor, Ekoregjionin dhe PTK-në.

Furnizimi me energji elektrike, me ndërprerje të vogla si pasojë e dëmtimit të rrjetit elektrik në fshatrat Bellanicë dhe Kërvasari, të cilat janë të sanuar.

Furnizimi me ujë, njoftimi ose rekomandimi që të vlohët para se të përdorët për pije, derisa telefonia dhe interneti, nuk kanë pasur ndërprerje.

NJPZSH ka pasur 7 (shtatë) intervenime.

Shërbimet tjera publike kanë funksionuar pa probleme të theksuara.

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Gjatë vitit 2022, Njësia e Auditimit të Brendshëm i ka përfunduar nëntë auditime, një prej tyre ka qenë më kërkesë nga menaxhmenti, ndërsa të tjerat sipas planit vjetor të punës.

Auditimet e përfunduara janë:

1. Rregullimi i Shtratit të Lumit Mirusha- Faza e parë , Zgjerimi i rrugës Malishevë- Banjë (auditim më kërkesë).
2. Menaxhimi i Pasurisë Jo financiare për vitin 2021
3. Subvencionet në Bujqësi për vitin 2021
4. Njësia e Personelit në Komunën e Malishevës
5. Drejtoria e Urbanizmit
6. Planifikimi, pranimi dhe shpenzimi i të hyrave vetanake për periudhën Janar –Qershor 2022
7. Auditimi i Drejtorisë së Shëndetësisë/QKMF - viti 2022
8. Auditimi i Sektorit të Prokurimit- viti 2022
9. Hapat gjatë buxhetimit dhe investimet kapitale Janar-Shtator 2022

1. Rregullimi i Shtratit të Lumit Mirusha- Faza e parë , Zgjerimi i rrugës Malishevë- Banjë (auditim më kërkesë).

Të gjeturat

- Projekti “Rregullimi i Shtratit të Lumit Mirusha- Faza e parë” në Malishevë është buxhetuar vetëm nga MMPH në shumën prej 300,000.00€ për vitin 2018 ndërsa vlera e kontraktuar nga viti 2018 ishte 323,884.63€ atëherë diferencën në shumën prej 23,884.63 € nuk është buxhetuar për vitin 2019 për përfundimin e projektit sipas marrëveshjes së mirëkuptimit ndërmjet palëve Komuna Malishevë- MMPH.

- Autoriteti Kontraktues ka filluar procedurat e prokurimit vetëm me një paramasë dhe parallogari teknike të punuar nga një kompani private “ Al Group” Shpk. dhe nuk ka hartuar projekt ekzekutiv të hollësishëm. Krijimi i kushteve të nevojshme për realizimin e projektit në fjalë ka qenë obligim që rrjedh nga marrëveshja e mirëkuptimit me MMPH prandaj komuna në lidhje me këtë ka hyrë në obligime kontraktuale, mirëpo nuk ka krijuar të gjitha parakushtet që kontraktuesi pa pengesa të implementoj projektin në fjalë.

-Njoftimi për nënshkrim të kontratës nga ana e zyrës së prokurimit është bërë me datë:28/12/2018 duke anashkaluar afatet ligjore dhe mos respektuar procedurat e njoftimeve të tilla.

- Menaxheri i kontratës nuk i ka lëshuar letrën për fillimin e punimeve operatorit ekonomik ndërsa një kopje e saj do të duhej ti dërgohej zyrës së prokurimit.

Menaxheri i kontratës ka hartuar një Plan të mangët të menaxhimit të kontratës pasi që nuk ka parashikuar asnjë datë të dorëzim – situacioneve në varshmëri nga progresi i punëve kontraktuese. Po ashtu në këtë plan të menaxhimit të kontratës nuk figuron asnjë shumë specifike e planifikuar [vlera e punëve të realizuara] e shprehur në vlerë monetare krahas datës së dorëzimit të situacionit. Mungesë tjetër në këtë plan është edhe parashikimi i një date të caktuar të përfundimit të punimeve dhe lëshimit të certifikatës së pranimi të përkohshëm të punimeve.

Bazuar në datën e fillimit të projektit dhe afatit 140 ditor (ditë pune), kemi vonesa në kryerjen e punimeve të kontraktuara dhe nuk kemi ndonjë aktivitet nga Autoriteti kontraktues që tregon perspektivën e daljes nga kjo situatë.

Vlera e punëve të pranuar përmes situacioneve nga menaxheri i kontratës, të faturuara nga OE dhe të paguara nga MMPH në njërin anë, dhe punëve të realizuara të kryera në teren (vend punishte) nga ana tjetër janë të barabarta dhe në pajtueshmëri me njëra tjetrën. Është pranuar dhe faturuar aq punë e kryer sa është realizuar në vend-punishte.

Bazuar në të dhënat e ofruara nga menaxheri i kontratës në fjalë dhe të dhënat nga dosja e projektit, nuk kemi gjetur ndonjë formë komunikimi me shkrim në mes të menaxherit të kontratës dhe departamentit të prokurimit si dhe Ministrisë përkatëse si bashkëfinancuese, për shkaqet e ndërprerjes së punimeve të projektit në fjalë dhe perspektivën e ekzekutimit të projektit.

- Totali i pagesave të realizuara për projektin në fjalë është :149,848.10€ ose rreth 48.77% të vlerës së kontratës bazë pa llogaritur 10% të parave të mbajtura në emër të sigurisë ekzekutive të punëve dhe kjo shumë e paguar është mbuluar tërësisht nga fondi i MMPH sipas obligimeve të Marrëveshjes së lartcekur të mirëkuptimit midis Komunës dhe MMPH. Në këtë rast komuna nuk ka kryer asnjë pagesë nga fondet e saj.

- Gjatë ekzaminimit të dokumentacionit, kemi vërejtur së fillimi i punimeve nuk ka ndodhur sipas afatit të paraparë në kontratë. Kjo vërehet edhe me kërkesën e bërë operatorit ekonomik më datë 07.09.2020 nga menaxherja e kontratës, për fillimin e punimeve pasi që kishte vonesa, në bazë të asaj që ishte parapa në kontratën e nënshkruar, ku fillimi i punimeve duhej të ndodhte më së largu pesë ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Procedurat e prokurimit kanë filluar vetëm me një paramasë dhe parallogari teknike të punuar nga drejtoria e urbanizmit që dmth së mungon projekti ekzekutiv, ashtu siç kërkohet në LPP. Nr. 04/L-042 , Neni 28. pika 10, Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit.

Rekomandimet:

- Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të ndërmerr veprime për të përmbyllur me sukses projektin në fjalë bazuar në obligimet e kontraktuara. Po ashtu rekomandojmë menaxhmentin e lartë që të adresojë rreziqet nga procesi i shpronësimit apo këmbimit të pronave (parcelave) private si parakusht i implementimit të kësaj faze të projektit bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në komunikimin me akterët e përfshirë në proces. Përfshirja e të gjitha kostove që lidhen me pronën qoftë shpronësimi apo këmbimi i saj të bëhet në faza më të hershme të projektit dhe duhet të jenë pjesë përmbytësore e projektit për implementimin e suksesshëm të tij.

Me qëllim të shmangies së pasojave financiare nga dështimi i kontratës, vazhdimi i punimeve në parcelat të cilat nuk kanë konteste pronësore me komunën është po ashtu e rekomandueshme. Rekomandojmë menaxhmentin e lartë të komunës që të rrit efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm (kontrollin parandalues) dhe të vlerësoj rreziqet gjatë implementimit të projekteve. Rritja e kapaciteteve menaxheriale qoftë brenda organizatës ose jashtë saj, rreth implementimit të projekteve të kontraktuara është po ashtu e rekomandueshme me qëllim të arritjes së objektivave të matshme të Autoritetit kontraktues.

- Rekomandojmë menaxhmentin e lartë që të ndërmerr veprimet e nevojshme në mënyrë që të përmbyllët sa më shpejtë ky projekt, pasi që në bazë të raporteve të prezantuara, ministria e ka përmbyllë pjesën e vet të pagesave, fokusi të jetë tek pjesa e obligimit të komunës. Gjithashtu rekomandojmë menaxhmentin që të rrit kontrollin e brendshëm, si gjatë fazës së planifikimit të projekteve, po ashtu kërkohet një kontroll më e madhe ndaj menaxherëve të kontratave, të kërkohet nga ta që të raportohet çdo aktivitet i punës i cili ndodhë gjatë fazës së mbikëqyrjes së projekteve.

Përmbajtja e shkurt drejtuese:

Projektet e investimeve kapitale zakonisht janë aktivitete të cilat kalojnë nëpër disa faza të cilat në fund kanë impakt në suksesin final të projektit dhe investitorit të tij. Në vazhdim të saj lidhur me projektin në fjalë në fazën e zbatimit të projektit sidomos shpenzimet e bartjes së pronësisë lidhur me shpronësimin (këmbimin) e asetit (parcelave private), me kusht që kompensimi i është paguar pronarit origjinal, nuk ka ndodhur paraprakisht para fillimit të implementimit të projektit.

Megjithatë pjesa dërmuese e pronarëve të parcelave private kanë pranuar kushtet e këmbimit të pronave-parcelave sipas vendimit të Asamblesë Komunale [nr. 02/213] për shpalljen e parcelave rreth lumit zonë me interes publik, një numër i pronarëve nuk kanë pranuar këto kushte këmbimi të parcelave në proporcion 1:3 dhe si rezultat kemi pasur ndalim të punimeve.

Mbetet e paqartë se përse Komuna si autoritet kontraktues nuk ka treguar gatishmëri që projekti të vazhdojë në drejtim të fshatit Banjë ku nuk kishte konteste pronësore apo të vazhdonte implementimin në pjesën publike të shtratit të lumit Mirusha në drejtim të perëndimit, duke krijuar kështu kushtet për shpenzimin e mjeteve të mbetura buxhetore të zotuar nga MMPH.

Në rrethanat kur kemi ndalim të realizimit të punimeve sipas kushteve të përgjithshme të kontratës për shkaqe të dështimit të Autoritetit kontraktues në sigurimin e qasjes në vend punishte, potencialisht bazuar në nenin 30 të KPK –shkaqet për kompensim, respektivisht pika (a). dhe (g) mund ta ngarkojnë Autoritetin kontraktues me detyrime kontingjente shtesë që dalin nga shkelja e kontratës, nëse paraprakisht këto konteste nuk zgjidhen me mirëkuptim të dyanshëm.

Ndërsa gjetjet në procesin e prokurimit më shumë janë të natyrës formale pa ndikime materiale në fund të procesit, përjashtimisht kur është fjala për mungesat lidhur me projektin ekzekutiv në fillim të procesit. Procesi i menaxhimit të kontratës si faza më e rëndësishme e projektit nuk ka përmbushur pritjet e Autoritetit kontraktues dhe është përcjellë me disa mangësi të cekura më lart. Bazuar në ekzaminimet e dosjes së prokurimit dhe menaxhimit të projektit ne konkludojmë se të gjeturat në procesin e prokurimit dhe menaxhimit të kontratës janë me impakt material pasi që nuk është arritur objektivi që mjetet e zotuar për projektin në fjalë të finalizohen në destinimin e tyre fillestar. Kjo situatë reflekton një gjendje jo efektive dhe jo efikase të sistemit të kontrollit të brendshëm në komunikimin: Prokurim, Urbanizëm dhe Financa duke mos vlerësuar dhe menaxhuar rreziqet që kanë pasur impakt në realizimin e objektivit, rregullimit të shtratit të lumit Mirusha në Malishevë.

-Gjatë auditimit, kemi vërejtur se procesi i implementimit të këtij projekti ka zgjatë më shumë sesa ka qenë i paraparë në kontratë dhe nuk është përfunduar akoma. Për mos përfundimin e tij kanë ndikuar faktorë të ndryshëm, fillimisht kompania fituese ka filluar punimet më vonë, pastaj janë paraqitur edhe pengesa në teren të cilat janë paraqitur si nevojë e zhvendosjes së shtyllave elektrike, pastaj është rasti i pengesës nga qytetarët për moslejimin e vendosjes së lëshesave gypore, gjithashtu kemi një rast të dëmtimit të pronës private nga ana e kompanisë gjatë punimeve të sajë, i cili ka kërkuar kompensim dëmi. Dhe bazuar në këto, mund të konstatojmë se që të gjitha këto kanë rrjedhur si pasojë e mos planifikimit të duhur më rastin e tenderimit të projektit (nuk është bërë një analizë e mjaftueshme rreth projektit), si dhe vonesat e kompanisë për përfundimin e projektit ashtu siç është parapa në kontratë më rastin e nënshkrimit (Zgjerimi i rrugës Malishevë- Banjë).

2. Menaxhimi i Pasurisë Jo financiare për vitin 2021

Të gjeturat:

- Pas ekzaminimeve dhe verifikimeve të kontrollit të brendshëm gjatë procesit të auditimit të pasurisë jofinanciare, kemi konstatuar se Organizata Buxhetore në fjalë nuk ka hartuar rregulla dhe procedura të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare komunale, të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi.

Po ashtu Organizata Buxhetore në fjalë ka një zyrtar për pasuri, por nuk ka caktuar një apo disa Zyrtar të Pranimit/Logjistikës i cili do të kishte përgjegjësinë për pranimin, deponimin dhe dhënien e pasurive jo financiare te personeli zyrtar i organizatës buxhetore.

Në mungesë të caktimit të një zyrtari të Pranimit/Logjistikës, organizata buxhetore nuk ka mbajtur asnjë evidence të sistemit "E pasuria". Sistemi "E pasuria" nuk është mbajtur dhe nuk është funksionalizuar fare në Komunë. Pasuritë jofinanciare të cilat është dashur të regjistrohen në SIMFK nga zyrtari i pasurisë gjatë vitit 2021 nuk janë regjistruar në sistemin e Free Balance.

- Aktivitetet e inventarizimit të pasurisë jo financiare, sipas kryetarit të komisionit, janë kryer në fund të muajit maj 2021, ndërsa është paraqitur si raport në muajin janar të vitit 2022.

- Inventarizimi i pasurisë jo financiare në komunë nuk është bërë i plotë, pasi që nuk janë përfshirë; automjetet në pronësi të komunës, nuk janë përfshirë objektet e saj, nuk është përfshirë sistemi i ngrohjes qendrore në objektin e vjetër të komunës. Në regjistra të inventarizimit nuk janë të paraqitura numrat serik apo barkodet e inventarit të gjetur dhe nuk specifikohet nëse kanë pasur apo jo barkode. Pas kryerjes së procesit të inventarizimit, komisioni në bashkëpunim me zyrtarin e pasurisë nuk kanë bërë krahasimin e gjendjes së regjistrit të inventarizuar me regjistrin e pasurisë jo financiare, si dhe nuk është debatuar për gjetjet apo mungesat e pasurisë jo financiare të inventarizuar. Është vërejtur edhe inventar i cili figuron si donacion në regjistrat e inventarizimit [zyra e regjistrimit të bizneseve, etj] edhe pse ka vite që është pranuar nga organizata buxhetore dhe duhet të figuroj si pasuri jo financiare e komunës. Procesi i vlerësimit të pasurisë jo financiare, sipas të gjeturave të procesit të auditimit të brendshëm nuk ka ndodhur fare në komunë gjatë vitit 2021.

-Pas ekzaminimeve të kryera lidhur me konstatimin e procesit të tjetërsimit të pasurisë jo financiare në komunë, kemi gjetur se një proces i tillë nuk ka filluar dhe nuk është kryer me vite në organizatën buxhetore. Ende në regjistrat e pasurisë jo financiare figurojnë objekte si shkolla në fsh. Mleqan, Astrazup etj. që raportojnë vlera financiare të cilat nuk ekzistojnë pasi që janë të rrënuara më herët.

Po ashtu në regjistrat e inventarizimit janë të paraqitura një numër i caktuar i inventarit jashtë përdorimit dhe i dëmtuar për të cilat edhe komisioni i inventarizimit ka rekomanduar që të formohet një komision për asgjësimin e tij.

Rekomandimet:

- Rekomandojmë menaxhmentin e lartë [ZKA] që të ndërmerr veprimet e nevojshme lidhur me hartimin dhe miratimin e rregullave të brendshme dhe procedurave që lidhen me menaxhimin e pasurisë jo financiare në komunë në pajtim me kriteret ligjore të specifikuara me rregulloren 02/2013. Po ashtu rekomandojmë që të caktohet një apo disa zyrtarë për pranimin e mallit të cilët duhet të jenë në kuadër të drejtorisë së Administratës së përgjithshme, me qëllim të funksionalizimit të aktiviteteve të tyre. Mbajtja e evidencave në sistemin “E pasuria” është e rekomandueshme të filloj të funksionalizohet sa më parë.
- Rekomandojmë menaxhmentin e lartë që të ndërmerr veprime për të siguruar që komisioni për inventarizimin e pasurisë jo financiare të caktohet dhe të ngarkohet sipas rregullores nr. 02/2013 duke përfillur afatet për fillimin dhe kryerjen e procesit të inventarizimit dhe dorëzimin e raportit përfundimtar para dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore të organizatës buxhetore, që procesi i inventarizimit të ketë një përfshirje të plotë të të gjithë pasurisë jo financiare duke përfshirë edhe asetet kapitale si : automjetet, objektet ndërtimore, stabilimentet e ngrohjes qendrore, kamerat e sigurisë etj, të cilat nuk ishin përfshirë në proces të inventarizimit. Është e rekomandueshme të bëhet edhe krahasimi i regjistrit të pasurisë jo financiare me regjistrin e inventarizimit nga ana e komisionit dhe zyrtarit të pasurisë pasi që ofron siguri në mbajtjen dhe kontrollin e pasurisë në komunë. Në lidhje me mungesat e inventarit të konstatuar në raportin e komisionit të inventarizimit, rekomandohet që të sqarohet deri në fund shkaku i mungesës së pasurisë në fjalë. Po ashtu pas përfundimit të procesit të inventarizimit rekomandohet që menaxhmenti i lartë të caktoj edhe komisionin për vlerësimin e pasurisë jo financiare me qëllim të vlerësimit dhe identifikimit të pasurisë së nevojshme të organizatës buxhetore.
- Rekomandojmë menaxhmentin e lartë që pas kryerjes së procesit të vlerësimit të pasurisë jo financiare, të filloj me procesin e tjetërsimit të pasurisë jo financiare duke caktuar një komision i cili do të kryente këto aktivitete bazuar në legjislacionin në fuqi për tjetërsimin e pasurisë jo financiare dhe në procedurat e brendshme të caktuara nga ZKA.

Përmbajtja e shkurt e drejtimit:

Duke vlerësuar gjendjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me menaxhimin e pasurisë jo financiare në komunë si të asaj kapitale, jo kapitale dhe stoqeve mund të konkludojmë se kemi ngecje në gjithëpërfshirjen e proceseve që do të krijojnë një sistem të plotë të kontrollit të pasurisë jo financiare në komunë. Mungesa e funksionalizimit të rregullave dhe procedurave ligjore që kanë të bëjnë me pasuritë jo financiare brenda komunës, pastaj mungesa e funksionalizimit të sistemit “E pasuria” dhe pranimin e mallit, paraqesin “hallkë të shkëputur” në sistemin e menaxhimit të pasurisë jo financiare brenda organizatës buxhetore.

Duke e vlerësuar procesin e inventarizimit më tepër si proces teknik dhe formal, si i tillë nuk ka përmblusur objektivin për të pasqyruar një gjendje reale të pasurisë jo financiare, pasi që nuk janë përfshirë në proces asetet si automjetet në përdorim dhe ato jashtë përdorimi, objektet dhe gjendja e tyre, kamerat e sigurisë, stabilimentet e ngrohjes qendrore të komunës etj. Mos

krahasimi i gjendjes së regjistrave të pasurisë me regjistrin e inventarizimit paraqet në vetvete një mundësi për të mos pasur informata të sakta mbi pasurinë jofinanciare në periudha kohore.

Mungesa e funksionalizimit të zyrtarit për pranim të mallit, sistemit “E pasuria” dhe aktiviteteve që lidhen me të, ka bërë që të mos kryhet procesi i vendosjes së numrit serik (barkodeve) tek pasuria komunale, procesi i ngarkimit dhe shkarkimit të zyrtarëve me inventar, ku si rezultat i saj edhe komisioni i ngarkuar për inventarizim nuk ka identifikuar asnjë inventar me numër serik.

Bazuar në analizën e të gjeturës lidhur me tjetërsimin e pasurive jo financiare mund të konkludojmë se menaxhmenti i lartë në komunë nuk e ka pasur në objektivë çështjen e vlerësimit të pasurisë jo financiare dhe rrjedhimisht edhe procesin e fillimit të tjetërsimit të pasurive jo financiare si fazë përcjellëse, me qëllim të asgjësimit të pasurisë jashtë përdorimit dhe asaj të dëmtuar, shitjes së pasurisë së panevojshme të organizatës dhe azhurnimit të plotë të regjistrit të pasurisë jo financiare.

3. Subvencionet në Bujqësi për vitin 2021

Të gjeturat:

-Bazuar në Qarkoren e Brendshme Buxhetore e cila u është dërguar të gjitha drejtorive dhe njësive kërkuuese të komunës, afati kohor për dorëzimin e kërkesave fillestare për buxhet dhe listën e projekteve ishte deri më 05/06/2020, mirëpo menaxhmenti i Drejtorisë së Bujqësisë ka dorëzuar me vonesë kërkesën më datë: 04/02/2021.

-Nga buxheti i alokuar prej 300,000.00€ për subvencione dhe investime në bujqësi, menaxhmenti i Drejtorisë së Bujqësisë ka planifikuar vetëm 200,000€ projekte për sektorin e bujqësisë, duke ngelur një diferencë prej 100,000€ të buxhetit të pambuluar me projekte konkrete. Shpenzimet e planifikuara për ngritjen e serave në vlerë prej 40,000€ dhe bashkëfinancimi në projektet e bujqësisë në vlerë prej 160,000€ janë buxhetuar gabimisht në kategorinë e investimeve kapitale. Shpenzimet e bëra për Investime Kapitale në bujqësi (ndërtimi i serave bujqësore dhe furnizimet me mekanizëm bujqësor), pas ndodhjes së tyre, nuk e rrisin vlerën e pasurisë komunale. Projekte të planifikuara në buxhet dhe të dështuara në ekzekutim ishin:

1. Projekti për “Furnizim me Farë Misri” në vlerë prej 50,000€ dhe

2. Projekti i furnizimit me “Pajisje për Bletari” në vlerë prej 20,000€.

-Lidhur me projektet për subvencione në bujqësi kemi konstatuar se plani i prokurimit për vitin 2021 ishte bazuar mbi planin e buxhetit për të njëjtin vit.

-Projekti i ndërtimit të Serave për bujqësi i planifikuar në vlerë prej 40,000.00€ ishte kontraktuar në fund të procesit me shumë prej 71,970.00€, një diferencë kjo në vlerë prej 31,970.00€ apo rreth 79% më lart (më shtrenjtë) nga plani i prokurimit. Nga ekzaminimi dosjes së prokurimit lidhur me tenderin “Furnizim me Mekanizëm Bujqësor” kemi konstatuar se: vlera e planifikuar e këtij tenderi ishte 90,000.00€, ndërsa kontrata e nënshkruar ishte në vlerë prej 120,930.00€ ose për 34.36% më e lartë se sa plani.

-Bazuar në dokumentacionin e analizuar të prokurimit në fjalë, procedurat janë zhvilluar në pajtueshmëri ligjore, me përjashtim të procedurës: "Njoftim për Nënshkrimin e Kontratës" e cila është bërë më datë 21/01/2022 [mbi gjashtë muaj vonesë].

-Pas ekzaminimeve të pajtueshmërisë ligjore të listave të përfituesve në subvencione kemi gjetur se në 21 raste kanë përfituar aplikues pa plotësuar tërësisht kriteret e shpalljes publike duke shfaqur mungesa dokumentacioni si: mungesën e fletë posedimit, kopjen e planit, kopjen e letërnjoftimit, apo edhe Certifikatën e pagesës së Tatimit në Pronë.

Po ashtu kemi gjetur një rast i cili edhe pse ka qenë përfitues i një "Shpërndarëse të plehut Kimik" nuk kishte nënshkruar marrëveshje me komunën – Drejtorinë e Bujqësisë.

Aktivitetet që nga shpallja (thirrja) publike për subvencione e deri tek përzgjedhja dhe nënshkrimi i marrëveshjeve me fermerët përfitues janë zhvilluar pa pasur një rregullore të brendshme mbi subvencionet në bujqësi. Në të gjitha shpalljet publike për aplikuesit e subvencioneve në bujqësi si dhe marrëveshjet e nënshkruara me përfituesit, mungonte referenca ligjore mbi të cilën ishte bërë shpallja apo nënshkruar marrëveshja.

-Po ashtu kërkesave të refuzuara të fermerëve aplikues, nuk iu është dhënë e drejta e ankesës ndaj organit vendim-marrës.

-Në lidhje me këtë, komuna nuk ka themeluar komision për shqyrtimin e ankesave eventuale dhe rrjedhimisht nuk ka shqyrtuar asnjë ankesë.

-Komuna, respektivisht Drejtoria e Bujqësisë nuk ka themeluar ndonjë komision për verifikimin e rasteve të fermerëve përfitues nga subvencionet në bujqësi lidhur me monitorimin e marrëveshjeve të nënshkruara midis Komunës dhe fermerëve përfitues, siç kërkohet në nenin 3 të saj.

Bazuar në këtë gjendje kemi konstatuar se aktivitetet nga ana e komunës rreth monitorimit në teren të marrëveshjeve të nënshkruara kanë munguar.

Rekomandimet:

- Rekomandohet ZKA që të forcon kontrollin e brendshëm në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë dhe sektorëve që ndërlidhen me planifikimin e buxhetit për subvencione në bujqësi siç është zyra e buxhetit me programin e investimeve publike (PIP). Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja e menaxhmentit drejtues të Drejtorisë së Bujqësisë në procesin e buxhetimit të shpenzimeve për bujqësi duhet të jetë më pro-aktive duke ofruar listën e projekteve dhe arsyeshmërinë e tyre në kohën e duhur ligjore, bazuar në Qarkoren e Brendshme Buxhetore komunale. Projektet për ndihmë me mekanizëm bujqësor dhe sera për fermerët nuk duhet të buxhetohen në kategorinë e investimeve kapitale, pasi që përfitimet nuk janë publike por private dhe nuk paraqesin vlerë të shtuar të pasurisë jofinanciare të komunës.

- Rekomandohet ZKA që të forcon kontrollin e brendshëm për arritjen e objektivave të planifikuar përmes një efikasiteti dhe efektiviteti më të lartë gjatë procesit të prokurimit duke siguruar informata më të sakta dhe të plota mbi vlerën e parashikuar të kontratës e cila do të ishte

në kondita të vlerës së tregut për kryerjen e punëve apo furnizimeve të planifikuara për subvencione në bujqësi, duke promovuar konkurrencë të hapur gjatë procesit.

- Rekomandohet ZKA që përmes menaxhmentit ekzekutiv të ndërmerr veprime për hartimin e një Rregulloreje të Brendshme për të adresuar menaxhimin e subvencioneve në bujqësi në Komunën e Malishevës. Respektimi i kritereve të specifikuara në shpalljet publike për subvencione në bujqësi duhet të jetë bazë e përzgjedhjes së vazhdueshme të përfituesve nga subvencionet komunale. Pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes së fermerëve përfitues, me rastin e publikimit të listave, duhet të parashikohet e drejta e ankesës së aplikantëve të refuzuar. Ankesat eventuale lidhur me shpërndarjen e subvencioneve në bujqësi duhet të shqyrtohen nga një Komision i themeluar nga ZKA.

- Rekomandohet ZKA që përmes Drejtorisë së Bujqësisë të siguron një proces të vazhdueshëm monitorimi të marrëveshjeve të realizuara me përfituesit e projekteve nga subvencionet në bujqësi për të pasur një siguri të arsyeshme se ndihma e komunës përmes subvencioneve ka arritur objektivin e saj në ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve bujqësore të fermerëve përfitues dhe parandalimin e keqpërdorimeve eventuale. Caktimi i një komisioni monitorues dhe vizitat në teren tek fermerët përfitues do të sillte një informatë kthyesë lidhur me performancën e subvencioneve në sektorin e bujqësisë.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit :

-Bazuar në ekzaminimet e dokumentacionit të analizuar, si dhe në intervistën verbale me zyrtarët e buxhetit përkitazi me pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e menaxhmentit të Drejtorisë së Bujqësisë në prezantimin e kërkesave dhe hartimin e buxhetit për subvencione mund të konkludojmë se aktivitete të tilla bashkërenduese kanë munguar. Në mungesë të angazhimeve nga njësia kërkuese, kjo pjesë e aktiviteteve në periudhën e përgatitjes së buxhetit [muaji qershor] sipas Qarkores së Brendshme Buxhetore është mbuluar nga zyrtarët e financave.

Buxheti i alokuar për subvencione në bujqësi në vlerë prej 100,000.00€ nuk ka qenë i mbuluar me projekte konkrete dhe si rezultat i saj pjesa dërmuese e tij prej 71% është shpenzuar për qëllime tjera jashtë destinimit buxhetor. Nga lista e projekteve të planifikuara për ndihmë në bujqësi [gjashtë projekte] , njësia kërkuese ka realizuar vetëm katër projekte si objektiva të matshëm. Nga buxheti i tërësishëm prej 15,851,399.50€ për vitin 2021, subvencionet dhe investimet kapitale për bujqësi ishin të alokuara në vlerë prej 300,000€ apo rreth 1.89% të buxhetit komunal.

-Sektori i Prokurimit ka përmbushur objektivin për procedimin e tenderëve në fjalë bazuar në planin e buxhetit për Organizatën Buxhetore. Megjithëse përgatitja e dosjes së tenderit për projektin “ Ndërtimi i Serave” ishte mbështetur në kosto historike [nga vitet e kaluara] në vlerë prej 40,000.00€ , vlera e parashikuar e kontratës ka rezultuar më e ultë për 79% në krahasim me kontratën efektive të nënshkruar në vlerë prej 71,970.00€ dhe kjo për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur në çmimet e tregut për materiale furnizuese në ndërtimin e serave. Konkluzion i njëjtë vlen edhe për tenderin për furnizim me mekanizëm bujqësor.

- Përkundër faktit që Drejtoria e Bujqësisë ka qenë e shtrënguar që të gjitha angazhimet rreth subvencioneve në bujqësi t’i kryejë me një staf të mangët civil brenda saj, pastaj të gjitha aktivitetet që nga hartimi i shpalljeve publike, krijimi i komisioneve përzgjedhëse dhe vet puna finale e

përzgjedhjes së përfituesve , pa pasur bazë të qartë të rregullativës ligjore ka qenë një sfidë. Nisur nga kjo gjendje mund të konkludojmë se menaxhmenti i kësaj drejtorie ka arritur që me sukses t'i realizoj objektivat e proceduar për subvencionet në bujqësi.

Mungesa e një rregulloreje të brendshme komunale e cila do t'i adresonte procedurat dhe do të rriste transparencën në shpërndarjen e subvencioneve në bujqësi, ka qenë një mangësi që ka përcjellë tërë procesin në fjalë.

- Procesi i monitorimit të çdo marrëveshjeje paraqet aktivitet që korrespondon me mënyrën më të mirë të menaxhimit qoftë kjo në nivel të sektorit apo edhe në nivel të organizatës.

Shpenzimi i parasë publike në kategorinë e subvencioneve dhe investimeve kapitale për nevoja të sektorit të bujqësisë, pa siguruar një proces monitorimi, krijon mundësitë e devijimeve nga qëllimi final duke rritur mundësitë e abuzimeve nga fermerët me subvencionet e përvetësuara.

4. Njësia e Personelit në Komunën e Malishevës

Të gjeturat:

- Njësia e personelit ka përgatitur dhe shpërndarë me kohë [datë:08.12.2021] tek Drejtoritë komunale Njoftimin dhe Formularin e zbrazët për fillimin e vlerësimit të rezultateve në punë për zyrtarët publik brenda OB-re në fjalë. Vlerësimi i performancë nga ana e menaxhmentit ka ndodhur gjatë muajit dhjetor (2021) dhe në janar (2022) dhe janë dorëzuar formularët e plotësuar në Zyrën e Personelit. Pas ekzaminimeve të hollësishme të formularëve të dorëzuar, kemi konstatuar se jo të gjitha drejtoritë komunale kanë kryer procesin e vlerësimit të performancës.

- Drejtoritë komunale të cilat nuk kanë dorëzuar vlerësime të performancës janë:

- Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, QKMF, QPS dhe Departamenti i Prokurimit.

- Drejtoritë komunale të cilat kanë dorëzuar vlerësime jo të plota të performancës janë: Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria e Emergjencës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,

- Mungesë në formularë e specifikimeve të aktiviteteve të kryera është paraqitur tek disa drejtori si Urbanizmi dhe Administrata e përgjithshme.

- Gjatë ekzaminimit të formularëve të vlerësimit kemi gjetur edhe vlerësim me zero(0).

- Formularët e vlerësimit nuk janë nënshkruar nga zyrtarët e bibliotekës së qytetit , gjithashtu rast të njëjtë kemi edhe në Drejtorinë e Shëndetësisë, ku formularët e vlerësimit të performancës nuk janë nënshkruar nga disa zyrtarë.

-Gjatë procesit të ekzaminimit të pagesave jashtë orarit për vitin 2021 kemi gjetur se procedurat kryesore ligjore të kryerjes së këtyre pagesave janë përfillur nga ana e Zyrës së personelit. Pas vlerësimeve në veçanti kemi gjetur se për nevojën e kryerjes së punëve jashtë orarit, tek të gjitha pagesat ka munguar urdhëresa me shkrim e menaxhmentit të lartë për fillimin e një aktiviteti të

tillë. Po ashtu pas kryerjes së punës jashtë orarit nga ana e stafit të angazhuar nuk kemi gjetur raporte pune të cilat janë të aprovuara nga mbikëqyrësi i procesit.

-Njësia e personelit gjatë vitit 2021 ka monitoruar vijueshmërinë në procesin e punës për nëpunësit civilë, mirëpo nuk është përcjellë me ndonjë evidencë të nënshkrimeve apo regjistër elektronik nga menaxhmenti ekzekutiv i komunës. Ndërsa nga muaji shkurt 2022 komuna ka ngritur kapacitete elektronike përmes të cilave ka krijuar regjistrin elektronik të përcjelljes së vijueshmërisë në hyrje-dalje nga vendi i punës.

Nga analizimi i regjistrin elektronik të aktiviteteve në hyrje –dalje kemi konstatuar se nëpunësit civilë (72) të cilët në fillim ishin pajisur me kartela identifikimi, përgjithësisht kanë respektuar orarin e punës sipas rregullatives ligjore. Për nëpunësit civilë të cilët nuk ishin pajisur ende me kartela identifikimi nuk është zbatuar ndonjë formë tjetër të paraqitjes në punë siç është lista e nënshkrimeve.

-Komuna, respektivisht Njësia e Burimeve Njerëzore nuk ka ndërmarr ndonjë aktivitet lidhur me fillimin e procedurave për hartimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, sipas kërkesës ligjore të parashikuar me rregulloren nr. 26/2020 (QRK).

Rekomandimet:

- Rekomandohet ZKA që të forcon kontrollin e brendshëm në kuadër të menaxhmentit të lartë lidhur me vlerësimin e performancës brenda OB. Procesi i vlerësimit të rezultateve në punë duhet të ndodhë gjatë gjithë vitit, që nga vendosja e objektivave dhe identifikimi i aktiviteteve në muajin janar ndërmjet drejtorit (mbikëqyrësit direkt) dhe stafit vartës, deri te vlerësimi përfundimtar në muajin dhjetor apo janar të vitit pasues. Zyra e personelit duhet të ofroj këshilla të plota ligjore dhe teknike tek menaxhmenti vlerësues, lidhur me procedurën e vlerësimit të performancës bazuar në rregulloren nr. 21/2020. E drejta e ankesës në rast mospajtimi lidhur me vlerësimin e performancës duhet të jetë pjesë e këshillave që duhet të afrohen nga Zyra e Personelit. Rekomandohet ZKA që përmes menaxhmentit të lartë të adresoj për ankesë rastet e zyrtarëve nga Administrata e Drejtorisë së shëndetësisë dhe Drejtorisë së Kulturës të cilët nuk kanë pranuar të nënshkruajnë formularin e vlerësimit të rezultateve në punë, pasi që reflektojnë raporte jofunksionale dhe mospajtimi me mbikëqyrësin e drejtpërdrejt.

- Rekomandohet ZKA që të rrit kontrollin e brendshëm përmes Zyrës së personelit dhe me këtë edhe tek drejtorët ekzekutivë në komunë që të aplikojnë procedurën e autorizimit të punëve jashtë orarit duke lëshuar paraprakisht urdhëresë për angazhime të tilla lidhur me objektiva të punës në organizatë. Njëheri duhet të verifikohet raporti i punës së kryer jashtë orarit lidhur me objektivat, pastaj të bëhet pranimi i punëve nga ana e mbikëqyrësit (drejtorit) si autorizues i punës jashtë orarit, duke proceduar më tutje me kërkesën për pagesë. Në rast të mungesës së buxhetit të alokuar për pagesën e orëve të punës jashtë orarit, menaxheri personelit mund t'i kalkuloj ato orë pune, në ditë pushimi për nëpunësin civil.

- Rekomandohet ZKA që përmes menaxhmentit ekzekutiv të ndërmerr veprime për pajisjen me kartela identifikimi për lajmërim në punë gjithë stafin civilë, të mundësohet që në objektin e vjetër të komunës të instalohet pajisje elektronike për lajmërim në punë, me qëllim të lehtësimit të procesit të paraqitjes në punë të stafit me moshë dhe probleme shëndetësore. Monitorimi i vazhdueshëm i procesit të vijueshmërisë dhe arsyeshmërisë së mungesave në punë për nëpunësit civilë mbetet e rekomandueshme në vazhdimësi për Njësinë e personelit.
- Rekomandohet ZKA që përmes Zyrës së Personelit në pajtim me kërkesën ligjore [neni 30 i Rregullores (QRK)nr. 26/2020], të filloj procedurat për hartimin e rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në organizatën buxhetore, duke themeluar komisionin prej tre anëtarësh, dy nga të cilët zyrtarë me përvojë në shërbimin civil dhe menaxheri i burimeve njerëzore si pjesë e komisionit.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit :

-Bazuar në të gjithë formularët e analizuar përkitazi me vlerësimin e performancës së nëpunësve civilë, mund të konkludojmë se brenda organizatës vlerësimi i performancës së rezultateve në punë ende nuk vlerësohet si një proces që duhet të zhvillohet gjatë gjithë vitit kalendarik, që nga muaji janar kur edhe duhet të bëhet vendosja e objektivave dhe deri në përfundim të tij.

Si pjesë e funksionimit të kontrollit të brendshëm, vlerësimi i performancës që njihet edhe si kontrolli feedback është identifikuar me dy situata të ndryshme brenda organizatës;

së pari, kemi konstatuar drejtori si ajo e Gjeodezisë dhe Kadastrit e cila ka kryer një vlerësim mjaft real të rezultateve në punë duke pasqyruar objektiva dhe aktivitete të realizuara, dhe

së dyti, kemi konstatuar drejtori apo sektorë si Drejtoria e shëndetësisë (QKMF), Drejtoria e Arsimit, apo Prokurimi që nuk kanë dorëzuar fare vlerësim performancës.

-Njësia e Personelit ka përmbushur objektivin për procedimin e pagesave në fjalë, megjithëse kompletimi jo i plotë i procedurave duke përfshirë autorizimet e menaxhmentit për fillimin dhe pranimin e punëve jashtë orarit mund të shihen si mangësi në proces, të cilat në rast të kundërt do t'i shtonin vlerë procesit në fjalë.

-Instalimi i pajisjes elektronike për regjistrimin e hyrje-daljeve në vendin e punës ka krijuar kushtet reale për menaxhimin e procesit të vijueshmërisë dhe informatën e saktë për kohën e hyrjes apo daljes nga orari i punës të nëpunësve civilë. Rritja e transparencës për punët jashtë orarit, punës me ndërrime dhe fund javës janë më lehtë të matshme për nëpunësit civilë.

- Përgatitja e rregullores që do të adresonte klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në nivelin profesional do të krijonte kushtet për trajtim të barabartë në paga bazuar

në nivelin e përgjegjësisë dhe ndërlikueshmërisë në vendin e punës.

Analiza e vendeve të punës është njëra nga aktivitetet të cilat duhet t'i karakterizojnë çdo

herë burimet njerëzore me qëllim të ngritjes së performancës në organizatë dhe arritjes së

objektivave të planifikuara.

5. Drejtoria e Urbanizmit

Të gjeturat:

-Gjatë procesit të ekzaminimit të kontratave për punë të vitit 2021[4 raste] ne kemi gjetur se AK nuk kishte bërë emërimin e mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të menaxherit të kontratës siç kërkohet me kriter ligjor për menaxhimin e kontratës [RrUOPP].

-Po ashtu ne kemi gjetur mangësi edhe në hartimin e Planit për Menaxhimin e Kontratës ku edhe pse është përgatitur dhe nënshkruar një plan i tillë nga menaxheri i kontratës dhe kontraktuesi i punimeve, tek të gjitha rastet që kemi analizuar, nuk është definuar qartë progresi i kontratës, respektivisht nuk janë specifikuar datat e dorëzimit të situacioneve të kryerjes së punëve, pastaj nuk janë dhënë data se kur pritet të përfundojnë punimet, apo kur do të bëhen pranimet/dorëzimet e punëve si dhe pagesat. Operatorëve ekonomik, pas nënshkrimit të planit për menaxhimin e kontratës, në të gjitha rastet, nuk iu është lëshuar “ Letra për fillimin e punëve” nga organi mbikëqyrës komunal.

-Gjatë procesit të testimit të mostrave të përzgjedhura nga menaxhimi i kontratave për punë ne kemi vërejtur se tek të gjitha rastet e testuara, ndryshimi i kontratave respektivisht punët shtesë janë iniciuar nga operatori ekonomik, duke bërë kërkesa si dhe duke bashkangjitur edhe paramasat e pozicioneve për punët shtesë.

Bazuar në RrUOPP, pjesën e menaxhimit të kontratës ku bëhet fjalë për ndryshimin e kontratës, çdo ndryshim i kontratës iniciohet nga Menaxheri i kontratës.

-Respektimi i kushteve të kontratës (kushteve të përgjithshme dhe të veçanta) që ka të bëjë me pranimin përfundimtar të punimeve pas përfundimit të periudhës 12 mujore, ne kemi gjetur se nuk ka ndodhur nga organi kompetent i urbanizmit i cili do të duhej të ishte emëruar nga Kryetari i Komunës si komision për pranimin përfundimtar të punëve.

-Nga mostrat e kontratave të analizuara kemi gjetur se në tre raste [kontrata nr. 02 “ Asfaltimi I rrugëve në fshatrat e Malishevës”, kontrata nr. 55 “ Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në Fshatin Astrazup, si dhe tek kontrata nr. 72 “ Ndërtimi i Rrugëve me kubëza Loto 2”] ka pasur vonesa disa mujore në implementimin e kontratave, ndërsa nuk kemi gjetur ndonjë arsyeshmëri (kërkesa) nga operatori ekonomik për shtyrje të afatit në përmbyllje të punimeve sipas kontratës. Në lidhje me këtë menaxheri i projektit nuk ka ndërmarrë veprime për përmbylljen e kontratës sipas KVK në rast të vonesave në realizimin dhe përmbylljen e punimeve.

-Drejtoria e Urbanizmit gjatë procedimit të kërkesave për Leje ndërtimore nuk ka lëshuar konfirmim aplikimi me rastin e pranimin të kërkesave për leje ndërtimore si dhe nuk ka respektuar afatet ligjore për shqyrtimin dhe kthimin e përgjigjeve ndaj kërkesave duke manifestuar vonesa në proces.

-Po ashtu Drejtoria e Urbanizmit ka lëshuar dy Leje Ndërtimore për njësi kërkuese komunale pa pranuar paraprakisht prej saj kërkesë me shkrim dhe pa marrë paraprakisht leje mjedisore. Në procedura të shqyrtimit të kërkesave për leje ndërtimore, në fund të procesit nuk i është dhënë e

drejta për ankesë kërkesës së refuzuar. Në raportet e vlerësimit të projekteve për Lejet Mjedisore Komunale, mungojnë nënshkrimet e anëtarëve të komisionit.

-Në dhjetë (10) mostra të përzgjedhura ne kemi gjetur se janë pranuar kërkesa për leje ndërtimore duke mos lëshuar konfirmim aplikimi (3) raste.

-Ne kemi gjetur se procedurat e kthimit e njoftimeve nga ana e organit kompetent për parashtruesit e kërkesave për Leje Ndërtimore nuk kanë ndodhur për rastet e kërkesave të pakompletuara duke manifestuar vonesa në proces të shqyrtimit dhe lëshimit të lejeve në fjalë. Vonesat nga fillimi deri në përmbyllje të procesit të lëshimit të Lejeve Ndërtimore kanë shkuar nga disa vite deri në disa muaj nga ana e organit kompetent të Urbanizmit.

-Ne kemi gjetur po ashtu që organi kompetent i drejtorisë në fjalë ka lëshuar për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dy (2) Leje Ndërtimore, pa parashtruar njësia kërkuese Kërkesë me shkrim për dy projekte publike. Njëkohësisht, njësia kërkuese nuk kishte marrë paraprakisht Leje Mjedisore siç kërkohet me UA. nr. 01/2017 për dhënien e Lejes Mjedisore komunale [pika 2 e nenit 6].

-Në procedurën e shqyrtimit të kërkesës së “IPKO Telecommunications LLC”, për Leje Ndërtimore komunale, ne kemi gjetur se në përgjigjen kthyesë [pa lëshuar aktvendim refuzimi] të organit kompetent komunal nuk i është dhënë e drejta e ankesës operatorit që iu ka refuzuar marrja e Lejes Ndërtimore, siç parashikohet në nenin 125 të ligjit mbi procedurën administrative.

-Tek Lejet Mjedisore Komunale në Raportet e Vlerësimit të Projekteve nga 6 mostra të testuara kemi gjetur katër (4) raste të Raporteve pa nënshkrime të komisionit përkatës. Nga këto raste Raporti i vlerësimit me Nr. 05/111 kishte dy shuma të vlerësimit për të njëjtin projekt me një diferencë prej 100,000€ apo 285,500€ ishte vlerësimi i parë dhe 385,500€ në vlerësimin e dytë ku për bazë është marrë vlera e fundit prej 385,500€ nga e cila edhe është llogaritur taksa mjedisore komunale.

Rekomandimet:

- Rekomandohet Kryetari i Komunës që gjatë procedurës së emërimit të menaxherit të kontratave për punë, të caktojë edhe mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të menaxherit të kontratës siç kërkohet me kritere ligjore. Forcimi i kontrollit e brendshëm në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit do të mundësonte që në fazën e mobilizimit të kontratës, të hartohet një plan i mirë i menaxhimit të kontratës me theks të veçantë në progresin e kontratës duke specifikuar në kohë pranimet e punëve, pagesat dhe përmbylljen e kontratës. Kompletimi i dokumentacionit para implementimit të projekteve kapitale komunale duhet të përmbajë, ndër të tjera dokumente, edhe lejet mjedisore, lejet ndërtimore, pëlqime dhe në fund edhe Certifikatën e Përdorimit. Rekomandohet menaxhmenti i lartë që përmes organeve mbikëqyrëse të kontratave të respektoj kriterin ligjor që ka të bëjë me ndryshimin e kontratës, respektivisht punët shtesë, ku kërkesa për punët shtesë nuk duhet të iniciohet nga operatori ekonomik, por nga menaxheri i projektit si organ mbikëqyrës nga komuna. Në raste të paraqitjes së vonesave në realizimin e kontratave, duhet të vije në shprehje respektimi i kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratave për punë nga ana e mbikëqyrësve të projekteve/kontratave për punë. Pranimi përfundimtar i

punimeve duhet të bëhet pas kalimit të afatit 12 mujor të sigurisë ekzekutive të projekteve kapitale nga një komision i emëruar nga Kryetari i Komunës.

- Rekomandohet Kryetari i Komunës që përmes menaxhmentit të Drejtorisë së Urbanizmit të forcon kontrollin e brendshëm në procedimin efektiv të kërkesave për leje mjedisore, leje ndërtimore e kërkesa tjera. Kompletimi i dosjeve të aplikacioneve për leje mjedisore, lejeve ndërtimore duke respektuar kriteret ligjore është në vazhdimësi e rekomandueshme. Shqyrtimit të kërkesave në fund të procesit, në raste të refuzimit të tyre duhet që përmes aktvendimeve të organit kompetent t'u njihet e drejta e ankesave aplikuesve të caktuar. Rekomandohet menaxhmenti drejtues i Urbanizmit që pas lëshimit të lejeve ndërtimore, një kopje të saj ta përcjellë vazhdimisht tek organi i inspektoratit ndërtimor komunal me qëllim të sigurimit të mbikëqyrjes së kushteve ndërtimore në teren të lëshuara nga Komuna.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit :

Bazuar në ekzaminimet e dokumentacionit të analizuar, si dhe në intervistën verbale me zyrtarët e urbanizmit ne kemi vlerësuar se duhet të rritet bashkëpunimi midis sektorëve të Drejtorisë së Urbanizmit që merren me mbikëqyrjen e projekteve, sektorit të prokurimit si nënshkrues dhe procedues të kontratave për punë dhe njërive kërkuese të cilat procedojnë apo iniciojnë projektet. Në fazën e inicimit të projekteve, njësia kërkuese e projektit të caktuar duhet të kompletojë kërkesën me dokumentacion përkatës si leje të ndryshme urbanistike para fillimit të procesit të prokurimit me qëllim që pas nënshkrimit të kontratës për punë i tërë dokumentacioni t'i përcillet organit mbikëqyrës të punëve në teren dhe operatorit ekonomik si punëkryes.

Mangësitë të cilat janë evidentuar në organin kompetent të pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave të ndryshme urbanistike dhe aplikacioneve janë kryesisht të natyrës formale ligjore, por që procedimi i tyre nuk e ka dëmtuar procesin në tërësi.

Rritja e efektivitetit në procedimin me kohë të kërkesave urbanistike dhe rritja e komunikimit me aplikuesit në kompletimin paraprak të dosjeve do t'i shtonte vlerë procesit në tërësi.

6. Planifikimi, pranimi dhe shpenzimi i të hyrave vetanake për periudhën Janar –Qershor 2022

Të gjeturat:

Realizimi i të hyrave vetanak në krahasim me planifikimin është 64.68%. Nga, këto shënime shihet qartë se: Realizimi i të hyrave për këtë periudhë Janar-Qershor 2022 në raport me Planifikimin e tërë vitit 2022 ka tejkalim për 14.68%. Si dhe krahasuar me përdhën e njëjtë të vitit paraprak, ka tejkalim rreth 27%.

Në Planifikimin e Buxhetit për 2022, në shumën e tërësishme prej 15,703,799.85€, nuk figuron shuma e mjeteve financiare të bartura nga vitet e mëparshme.

Pjesëmarrja e të hyrave vetanake në buxhetin përfundimtar për vitin 2022 ,dukët kështu:
 $(1,033,469.00\text{€} / 15,703,799.85\text{€}) \times 100 = 6.58\%$

-Planifikimi në raport me realizimin të tatimi në pronë ka ngecje në realizim, ende nuk ka arritur

50% i realizimit, taksat nga mjetet motorike janë realizuar 86% në raport me planin, ndërsa taksa nga ushtrimi veprimtarisë në raport me planifikimin është realizuar 33.82%. Realizimi për periudhën Janar-Qershor 2022 ka tejkalim në raport me planifikimin e tërë vitit 2022 për 16%. Taksa tjera administrative nuk janë planifikuar fare.

Drejtoria për gjeodezi dhe kadastër nuk ka ofruar një planifikim real të të hyrave. Mos bartja e të hyrave vetanake nga vitet e kaluara, kur të merret parasysh nevoja e madhe për investime në komunën e Malishevës është brengosëse. Shuma prej 477,257.28€ nga viti 2021 sipas deklarimit të ZKF-së janë bartur në vitin 2022. Ndërsa shuma prej 163,114.65€ nga viti 2020, nuk është bërë bartja.

Rekomandimet:

- Kryetari të merr masa që Drejtoria për Buxhet dhe Financa, të ndikoj përmes zyrtarit komunal të të hyrave vetanake, që të koordinojnë kontaktet me të gjitha drejtoritë dhe zyrtarët të cilat gjenerojnë të hyra vetanake, për harmonizim (barazim) vlerash në raportet e prezantuara çdo tre mujor, gjashtë mujor dhe atë vjetor, para se të procedohen në sistemin e free balancit.

- Kryetari i komunës të merr masat e duhura që, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, si dhe drejtoritë tjera, gjatë planifikimit të të hyrave vetanake, të bazohen në analizat reale, ose në bazë të potencialit real ekzistues të tatimpaguesve dhe të mos bazohen vetëm nga shënimet nga niveli i arkëtimit nga viti paraprak. Pra qasja e drejtorive në planifikimin e të hyrave vetanake të jetë e pa shmangshme, të mos ketë mospërputhje të theksuara.

- Rekomandohet Kryetari i Komunës, që përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, të ndërmerr veprimet e duhura që bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake të realizohet në kohën e duhur, me qëllim të realizimit të nevojave për investime në të mira publike

Përshkrimi i shkurt i drejtimit :

Në rastet e prezantuara ka ndryshim në vlera, për të cilat kërkohet koordinim i vazhdueshëm, në mes gjitha kategorive të brendshme cilat gjenerojnë të hyra vetanake dhe mbajnë evidenca për të cilat janë të obliguar ligjërisht, dhe Zyrtarit të të hyrave.

Planifikimi i të hyrave nuk bazohet në analizat reale, por zakonisht bëhen në bazë të shënimeve nga niveli i arkëtimit nga viti paraprak. Objektivat duhet të formulohen ekskluzivisht në bazë të potencialit dhe kjo pastaj të jetë përcaktuese e zhvillimit të kapaciteteve grumbulluese. Pra qasja e drejtorive të cilat gjenerojnë të hyra, në planifikimin e të hyrave të bëhet sa ma përafërsisht me mundësit e realizimit.

Bazuar në nevojën e madhe për investime në komuna e Malishevës dhe përkundër kërkesës së madhe për këto investime, prapë mosshpenzimi i të hyrave është një dukuri e shprehur dhe përcillet nga viti në vit.

7. Auditimi i Drejtorisë së Shëndetësisë/QKMF - viti 2022

Të gjeturat:

-Gjatë procesit të Auditimit të Brendshëm lidhur me vlerësimin e planit operativ të Drejtorisë së Shëndetësisë ne kemi gjetur se ende Organizata Buxhetore në fjalë nuk ka hartuar një plan strategjik të komunës për një periudhë trevjeçare nga i cili do të mund të derivohej plani operativ apo vjetor i veprimit të çdo departamenti duke përfshirë edhe atë të shëndetësisë/QKMF.

-Menaxhmenti drejtues i QKMF (Drejtori) në bashkëpunim me vartësit e tij kanë hartuar planin operativ të veprimit bazuar në nevojat e QKMF para fillimit të vitit kalendarik.

Objektivat e planifikuar për vitin 2022 janë paraqitur në mënyrë specifike dhe të matshme duke përfshirë edhe koston financiare si dhe kohën e realizimit të tyre.

Gjatë ekzaminimit të aktiviteteve të renditura në planin operativ të veprimit, ne kemi gjetur se menaxhmenti drejtues, përveç të tjerave si aktivitete me rëndësi:

☐ Nuk ka planifikuar furnizime me derivate dhe lëndë djegëse për nevojat e QKMF dhe shërbimeve në teren të QMF.

☐ Nuk ka ndonjë aktivitet të planifikuar që do të siguronte një inventarizim të pasurisë jofinanciare të QKMF për vitin vijues dhe objekteve tjera përcjellëse nëpër fshatra.

☐ Nuk kemi gjetur aktivitete të planifikuara për procesin e vaksinimit të rregullt(imunizimit)

☐ Mungesë tjetër e planit të veprimit kemi gjetur edhe mospërfshirjen e aktiviteteve rreth furnizimit të barnave nga Lista Esenciale që mbulohet nga MSH.

☐ Mirëmbajtja funksionale e aparaturave dhe pajisjeve për ekzaminimet shëndetësore nuk është renditur si pjesë e aktiviteteve të planifikuara.

Ne kemi gjetur po ashtu që menaxhmenti drejtues i QKMF ka zhvilluar procesin e planifikimit të aktiviteteve ndaras nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Zyra e Buxhetit nga Drejtoria e Financave, prej nga edhe janë paraqitur diferenca midis planit operativ të veprimit të përgatitur nga Drejtoria e QKMF dhe zërave buxhetorë të planifikuar për shëndetësi. Konkretisht, renovimi i katit të tretë të QKMF i planifikuar gjatë tre viteve të fundit nga menaxhmenti drejtues i QKMF, nuk është përfshirë në planin e buxhetit për shëndetësi gjatë vitit 2022.

Plani operativ i veprimit i hartuar nga udhëheqja menaxheriale e QKMF, nuk kemi gjetur se është aprovuar edhe formalisht nga Drejtori i Shëndetësisë, në fund të procesit.

Nga raportimi gjashtë-mujor i punës ne kemi gjetur se në tre punkte (AMF) nëpër fshatra si: LLapçevë, Lubizhdë dhe Berishë; nuk kishte pasur asnjë aktivitet apo shërbim për pacientë nga personeli shëndetësor, ndërsa nuk ishte dhënë ndonjë informatë sqaruese nga menaxhmenti lidhur me situatën e konstatuar.

- Gjatë procesit të ekzaminimit të çmimeve të shërbimeve shëndetësore në QKMF kemi gjetur se Lista e çmimeve për shërbimet e ofruara nuk ishte azhurnuar me vite duke pasqyruar një gjendje jo të plotë dhe jo gjithëpërfshirëse bazuar në legjislacionin aktual të shërbimeve shëndetësore në kuadër të Kujdesit Parësor Shëndetësor. Menaxhmenti drejtues i QKMF dhe stafi financiar i saj nuk kishin informatë për Rregulloren Komunale për tarifa dhe ngarkesa, përfshirë edhe shërbimet mjekësore në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë. Përderisa medikamentet nga Lista esenciale e Barnave janë dhënë sipas çmimeve të QKMF nga 0.50€, ky shërbim (medikament) bazuar në Rregulloren Komunale nr. 02/237 do të duhej të ofrohej me çmim prej 0.30€.

-Po ashtu ne kemi gjetur se edhe në Rregulloren Komunale të lartcekura kemi shërbim të përshkruar si “ Libreza Sanitare” që nuk do të duhej të përfshihej në shërbimet e KPSH pasi që i njëjti është shërbim që ofrohet nga IKSHPK dhe degët rajonale.

-Shërbime tjera shëndetësore të cilat nuk janë përfshirë në çmimoren aktuale të QKMF janë edhe:

- ☐ Certifikata shëndetësore [sipas RReg. komunale nr. 02/237 neni 20.2]
- ☐ Audiogrami
- ☐ Shpëlarja e veshit
- ☐ Dhënja e injeksionit intramuskular në shtëpi, përpos në rastet emergjente
- ☐ Dhënja e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente
- ☐ Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive
- ☐ Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme dhe
- ☐ Riparimi i protezës (ngjitja)

-Tek procedurat e mbajtjes së protokolleve gjatë vizitave shëndetësore , shërbimi i infuzioneve [5 mostra], shërbimi stomatologjik [2 mostra], mjekësia familjare [3 mostra], nga shërbimet laboratorike [19 mostra]dhe nga gjinekologjia [6 mostra], kemi gjetur se mungojnë evidencat e numrit personal të shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore.

-Mangësi të njëjta të evidentimit të nr. personal kemi gjetur edhe tek të gjitha dëftesat e participimit (bashkë pagesat), përderisa për rastet e liruar nga pagesat nuk lëshohen fare dëftesa.

-Shërbimet shëndetësore të cilat lirohen nga bashkë pagesat nuk janë azhurnuar me ligjin e ri të shëndetësisë respektivisht Nenin 61 të tij.

- Barnatorja në QKMF që udhëhiqet nga Farmacisti dhe tekniku i farmacisë në kuadër të detyrave të saj bënë planifikimin, pranimin, depozitim dhe shpërndarjen e Listës Esenciale të Barnave që vijnë nga Ministria e Shëndetësisë. Shpërndarja e tyre bëhet në bazë të kërkesave të reparteve Brenda QKMF si dhe QMF dhe AMF nëpër fshatra të komunës së Malishevës. Pjesa tjetër shpërndahet bazuar në recetat e mjekëve ndaj shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore.

Nga fillimi i vitit e deri më 12/10/2022 janë pranuar gjithsej nga LEB barna në vlerë prej: 143,866.94€ e cila sasi është shpërndarë sipas kërkesave të reparteve në vlerë prej: 78,852.23€ dhe pjesa tjetër prej 65,014.71€ është destinuar për Barnatore të QKMF.

Shuma e shpenzuar dhe e shpërndarë nga LEB është në vlerë prej: 65,531.81€ për reparte dhe shuma prej: 58,565.46€ për Barnatore të QKMF.

Gjatë ekzaminimeve të kërkesave për barnat nga lista esenciale nga repartet e QKMF dhe atyre nëpër fshatra, kemi gjetur se ndarja e detyrave lidhur me procedimin e kërkesave nuk është konform procedurave të kornizës së kontrollit të brendshëm. Aprovimi dhe realizimi i kërkesave për barna esenciale dhe material shpenzues ka ndodhur nga i njëjti zyrtar.

- Po ashtu nga 58 mostra të barnave të shpërndara përmes recetave të vizitave mjekësore 19 nga këto mostra nuk kishin fare vullë nga protokoli bazë i vizitës mjekësore, apo shprehur në përqindje rreth 33% nga mostrat e përzgjedhura.

Mangësi e evidentuar gjatë procesit të ekzaminimit të recetave të pranuar në barnatoren e QKMF ishin edhe mungesa e datës dhe nënshkrimeve të personelit të autorizuar në pjesën e recetës dedikuar farmacistit i cili procedon me recetat dhe dhënien e barnave nga Lista Esenciale.

Rekomandimet:

-Rekomandohet Kryetari i Komunës që në pajtim me kërkesat ligjore në fuqi të hartoj Planin strategjik të Komunës që do të përfshinte qëllime të arritshme në periudhën tre vjeçare. Nga Plani strategjik pastaj do të duhej të derivoheshin edhe planet vjetore të drejtorive përkatëse përfshirë edhe atë të shëndetësisë.

Intensifikimi i bashkëpunimit midis menaxhmentit drejtues të QKMF, DSHMS dhe sektorit të buxhetit dhe financave në komunë duhet të funksionalizohet paraprakisht në fazën e përgatitjes së buxhetit, me qëllim të hartimit të planit veprues real, të bazuar në mundësi buxhetore. Pas përgatitjes përfundimtare, aprovimi planit veprues të QKMF duhet të bëhet nga Drejtori i DSHMS. Nga raportimi gjashtëmujor i shërbimeve të kryera shëndetësore nga Drejtori i QKMF lidhur me performancën e AMF nëpër fshatra, është e rekomandueshme të kërkohej informatë e plotë dhe llogaridhënie, pse nuk ka asnjë shërbim të ofruar shëndetësor në fshatrat: Llapçevë, Lubizhdë dhe Berishë në gjysmën e parë të vitit vijues.

-Rekomandohet Kryetari i Komunës që përmes menaxhmentit të Drejtorisë së Shëndetësisë të forcon kontrollin e brendshëm dhe të siguroj implementimin e plotë të kornizës ligjore që ka të bëjë me tarifat dhe ngarkesat për shërbimet shëndetësore në QKMF. Përfshirja e shërbimeve tjera në listën shërbimeve shëndetësore të cilat janë të parashikuara edhe me Rregullore komunale për pjesën e shëndetësisë si dhe përfshirja e Nenit 61 të Ligjit nr. 04/L-125 për shëndetësi për kategoritë e liruar nga bashkë pagesat është gjithsesi e rekomandueshme. Mbajtja e evidencave në protokollin e shërbimeve shëndetësore duhet të përmirësohet dhe plotësohet duke përfshirë edhe evidentimin e numrit personal të shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe vërtetimin e recetave mjekësore. E njëjta procedure duhet të praktikohet edhe për dëftesat nga pagesat e participimit duke plotësuar numrin personal përgjithësisht edhe tek të gjitha dëftesat përfshirë edhe kategoritë e liruar të pacientëve sipas ligjit.

-Rekomandohet Kryetari i Komunës që përmes menaxhmentit të Drejtorisë së Shëndetësisë të forcon kontrollin e brendshëm dhe të siguroj një ndarje më të mirë të detyrave në procesin e menaxhimit të Listës së Barnave Esenciale. Aprovimi i kërkesave për barna dhe materiale shpenzuese duhet të ndahet nga aktivitetet e realizimit të kërkesave që kryhen nga depoisti, bazuar kjo në komponentën e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Rekomandohet forcimi i kontrollit të brendshëm në Barnatore me rastin e pranimi të recetave mjekësore nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore. Recetat mjekësore të pavulosura nga shërbimi i protokollit nuk duhet të pranohen si të rregullta. Po ashtu pranimi i recetave mjekësore duhet të nënshkruhen edhe nga zyrtari apo farmacisti përkatës në Barnatore tek pjesa e autorizuar e tyre duke përfshirë edhe datën e nënshkrimit.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit: Nga procesi i auditimit në Drejtorinë e Shëndetësisë/QKMF me target vlerësimin e ligjshmërisë gjatë proceseve si planit operativ- vjetor të punës, procesit të ofrimit dhe kryerjes së shërbimeve shëndetësore dhe sistemit të menaxhimit të LEB kemi konkluduar se:

Menaxhmenti i lartë i QKMF ka realizuar aktivitete dhe objektiva të caktuar, por nuk ka përmbushur tërësisht objektivat e planifikuar të saj. Nga raporti gjashtëmujor i punës i prezantuar tek Kryetari i Komunës, menaxhmenti drejtues i QKMF kishte listuar të gjitha shërbimet shëndetësore të cilat ishin kryer nga shërbimet e veçanta brenda QKMF, QMF dhe AMF nëpër vendbanime të komunës sonë në total prej 137,541 shërbime të kryera.

Menaxhmenti drejtues i QKMF kishte përgatitur një plan të shkruar vjetor lidhur me objektivat dhe aktivitetet që do të kryheshin gjatë vitit kalendarik 2022/23 me theks të veçantë tek investimet në infrastrukturën shëndetësore dhe pajisje, por edhe në ngritjen e vazhdueshme profesionale të stafit dhe të shërbimeve shëndetësore.

Ne vlerësojmë se menaxhimi i rreziqeve lidhur me ngjarjet të cilat determinojnë objektivat e QKMF mbeten target që duhet adresuar në vazhdimësi nga ana e menaxhmentit drejtues të QKMF. Pjesëmarrja pro-aktive dhe bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet menaxhmentit drejtues të DSHMS, QKMF dhe sektorëve të financave dhe hartim buxhetit komunal do të ishte një vlerë e shtuar në harmonizimin e planeve vjetore të veprimit me buxhetin vjetor për shëndetësi.

Njohja me ndryshimet e legjislacionit që lidhet me tarifat (çmimoret) për shërbimet shëndetësore të kujdesit primar dhe azhurnimi i vazhdueshëm i tyre mbetet çështje që duhet adresuar në vazhdimësi nga menaxhmenti drejtues i QKMF.

Ne vlerësojmë se menaxhimi relativisht i mirë i LEB në Barnatoren e QKMF duhet të vazhdoj, duke pasur synim përmirësimin e vazhdueshëm sipas rekomandimeve nga të gjeturat e Auditimit të Brendshëm.

8. Auditimi i Sektorit të Prokurimit- viti 2022

Të gjeturat:

Gjatë procesit të Auditimit të Brendshëm lidhur me vlerësimin e kriterëve për kërkesat ligjore mbi përshtatshmërinë e tenderuesve dhe kualifikimin e tyre, ne kemi gjetur se Sektori i Prokurimit gjatë përgatitjes së dosjeve të tenderëve për të gjitha procedurat dhe llojet e

kontratave, në asnjë rast nuk ka kërkuar që për përfituesit e tenderëve, përveç Vërtetimeve nga Administrata Tatimore e Kosovës që Operatori Ekonomik nuk ka borxhe apo nuk është në vonesë për pagesa të obligimeve tatimore, të sjellë edhe Vërtetimin apo Certifikatën tjetër lidhur me përmbushjen e obligimeve tatimore nga Tatimi në Pronë, si një lloj tjetër i tatimit të aplikueshëm në Kosovë. Të gjithë tenderuesit në të gjitha procedurat e tenderimit kanë dorëzuar dosje pa Certifikatën e Tatimit në Pronë pasi që një dokument i tillë nuk është

kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në fazën e përgatitjes së dosjes së tenderit dhe Njoftimit për Kontratë të kriterëve rreth Kërkesave të domosdoshme të Përshtatshmërisë dhe kualifikimit. Në kemi gjetur se është shpërblyer me kontratë Operatori Ekonomik: sipas kontratës nr. 55 të dt. 20/09/2022 për “Furnizim me Pije dhe Ushqim për Nevojat e Institucionit Parashkollor,” përderisa në regjistrat e Tatimit në Pronë kishte borxhe të papaguara në shumë prej: 9,378.33€ [fatura nr. 3354472297 e tatimit në pronë e datës: 18/11/2022].

- Gjatë procesit të ekzaminimit të dokumentacionit nga kontratat e përzgjedhura dhe intervistës verbale me bartësit e aktiviteteve të prokurimit kemi gjetur se sektori i prokurimit dhe menaxherët e kontratave ende nuk kanë funksionalizuar modulën e menaxhimit të kontratave dhe me këtë edhe procesin e vlerësimit të performancës së kontraktuesve siç kërkohet për kontratat me vlera të mesme dhe të mëdha në sistemin elektronik të prokurimit. Nga shtatë kontrata me vlera të mesme dhe të mëdha, në gjashtë prej tyre nuk kishte të bashkangjitur Planin për Menaxhimin e Kontratës. Menaxherët e kontratave nuk kanë zhvilluar qasje të rregullt në sistemin elektronik të prokurimit dhe si rezultat i saj nuk mund të pasqyrojnë progresin e kontratës sipas fazave të projektit dhe situacioneve të pranura nga kontraktuesit. Në procesin e caktimit të menaxherëve të kontratës kemi gjetur se nuk janë përfillur funksionet e Njesisë së Kërkesës e cila është përgjegjëse për pranimin e punëve, mallrave apo shërbimeve dhe hartimin e raporteve të pranimit dhe aranzhimit për pagesë të operatorëve. Kjo gjendje është evidentuar tek kontrata Kornizë nr. 52 lidhur me: “Furnizimi dhe Mirëmbajtja e Sistemeve të ngrohjes Qendrore në Institucionet Arsimore të Komunës së Malishevës” ku menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i menaxherit të kontratës janë nga e njëjta drejtori – Urbanizmi, duke anashkaluar në këtë rast Njësine Kërkuese – Drejtorinë e Arsimit për të cilën janë kryer punët dhe shërbimet.

- Gjatë procesit të verifikimit dhe testimit të mostrave të përzgjedhura nga kontratat e nënshkruara nga Autoriteti Kontraktues për vitin 2022 kemi evidentuar në radhë të parë si të gjetur që është përsëritur edhe nga vitet e kaluara mungesën e Njoftimit për Nënshkrimin të Kontratës tek të gjitha rastet. Nga një anashkalim i tillë i procedurës edhe është bërë e pamundur gjenerimi i raportit përmbledhës për kontratat e nënshkruara gjatë vitit 2022.

Nga regjistrat e prokurimit si kopje fizike kemi gjetur edhe këto mangësi:

- Deklarata e Nevojave dhe Vendosmëria për Disponimin e Mjeteve [DNVDF] dhe bashkë me të edhe Zotimi i mjeteve paraprakisht me fillimin e procedurave nga 15 mostra të verifikuara mungojnë tek kontratat me nr. 32, 37, 46, 55, 77 dhe 78 në regjistrat e prokurimit.

- Kopje fizike e Planit për Menaxhimin e Kontratës [PMK] është evidentuar në mungesë tek kontratat nr. 34, 37, 46, 55, 77 dhe 78 në regjistër të prokurimit.

- Vendimet për caktimin e Menaxherit të Kontratës dhe Mbikëqyrësit të Menaxherit të Kontratës janë evidentuar në mungesë tek kontratat me nr. 37, 46 dhe 78 në regjistër të prokurimit.

- Deklarata nën Betim e një anëtarit të komisionit vlerësues në mungesë është evidentuar tek kontrata nr. 46 e prokurimit.

Rekomandimet:

-Kryetari i Komunës përmes menaxherit të Sektorit të Prokurimit duhet të siguroj në pajtim me kërkesat ligjore në fuqi zbatimin e plotë të kriterit ligjor që lidhet me Kërkesat e Përshtatshmërisë dhe të Kualifikimit [sipas nenit 65. pika 4.8 të LPP] ku përveç kushteve tjera të specifikuara në dosjen e tenderit, Operatorët Ekonomik duhet të sjellin edhe Certifikatën e përmbushjes së Tatimit në Pronë si një lloj tjetër tatimi i aplikuar në Kosovë dhe i rëndësishëm për buxhetin komunal.

-Rekomandohet Kryetari i Komunës që përmes menaxhmentit të Sektorit të Prokurimit të ngrit kapacitetet formale dhe profesionale për të funksionalizuar Modulin për Menaxhimin e Kontratave në sistemin elektronik të prokurimit, përmes të cilit menaxherët e projekteve do të përcillnin progresin e kontratave dhe përmbylljen efikase dhe efektive të tyre.

Po ashtu gjatë caktimit të menaxherëve të kontratave/projekteve rekomandohet që të merren parasysh funksionet e Njesisë së Kërkesës lidhur me menaxhimin e kontratave ku përfshirja e personelit nga Njësia e Kërkesës në administrimin e kontratave duhet të jetë evidente.

-Rekomandohet Kryetari i Komunës që përmes menaxherit të Sektorit të Prokurimit të forcon kontrollin e brendshëm dhe të siguroj një mirëmbajtje të plotë të Regjistrit Përmbledhës të Prokurimit bazuar në kriterin ligjor në fuqi.

Rritja e kontrolleve parandaluese gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit do të ishte vlerë e shtuar në administrimin e hapave në proces, do të ndikonte në kompletimin e plotë të Regjistrit Përmbledhës të Prokurimit dhe rritjen e efektivitetit në realizimin e objektivave.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit :

Nga procesi i Auditimit të Brendshëm me target vlerësimin e ligjshmërisë dhe proceseve gjatë procedurave të prokurimit,në shqyrtimet tona kemi konkluduar se:

Menaxhmenti i sektorit të Prokurimit ka realizuar aktivitete dhe objektiva të caktuar, por nuk ka përmbushur tërësisht objektivat e planifikuar.

Menaxheri i Sektorit të Prokurimit kishte përgatitur planin vjetor të prokurimit për vitin vijues kalendarik bazuar në Ligjin për Ndarjet Buxhetore për Komunën e Malishevës për vitin 2022.

Ne shprehim skepticizëm të arsyeshëm lidhur me faktin që Sektori i Prokurimit nuk kishte bërë raportim me shkrim para Menaxhmentit të lartë (ZKA) lidhur me performancën e Njesisë së Prokurimit dhe objektivave të saj gjatë vitit vijues.

Vlerësimi i rreziqeve lidhur me ngjarjet të cilat kanë ndikuar negativisht në objektivat e Sektorit të prokurimit mbeten target për t'u adresuar në vazhdimësi nga ana e Menaxherit të Prokurimit.

Pjesëmarrja pro-aktive dhe bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet Sektorit të Prokurimit dhe sektorëve tjerë si të financave (në hartimin e buxhetit komunal) por edhe njësive tjera kërkuese me qëllim të identifikimit të nevojave në planifikimin e saktë të tyre është i domosdoshëm me qëllim të arritjes sa më të madhe të vlerës për para gjatë prokurimit të fondeve publike.

Po ashtu ne shprehim skepticizëm të arsyeshëm edhe në rastin e përzgjedhjes së Kontratave Kornizë lidhur me prokurimin e furnizimeve dhe shërbimeve në rastet kur dihet sasia e kërkuar nga Njësia Kërkuese dhe koha e liferimit të tyre.

Niveli i skepticizmit është i theksuar edhe kur bëhet fjalë për Kontratat për Shërbime të Veçanta me qëllim të arritjes së vlerës për paratë nga kontraktimi i tyre.

Megjithatë bazuar në të gjeturat dhe performancën e sektorit të audituar, niveli i përgjithshëm i shqetësimit nga ana e Auditorit të Brendshëm është mesatar.

9. Hapat gjatë buxhetimit dhe investimet kapitale Janar-Shtator 2022

Të gjeturat:

Planifikimi i buxhetit për vitin 2022 ka filluar me arritjen e Qarkores buxhetore 2022/1 Nr. prot. 797/2021 datë 14.05.2021 nga MEF ku janë dhënë të gjitha kufizimet buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike.

Procedurat e bërjes së buxhetit komunal- Vendimin për miratimin e Buxhetit të Komunës së Malishevës për vitin 2022/2024.

Përfshirja qytetare në procesin e hartimit të buxhetit komunal. Gjatë ekzaminimit të dhënave kemi hasur se janë bërë ftesa për pjesëmarrjen e grupeve të interesit për Kornizën Afatmesme Buxhetore:

1. Kryetarët e fshatrave ditë e Premte 25.06.2021,

2. OJQ-të, Bizneset, Shoqëria civile me 25.06.2021

3. Komitetet komunale 25.06.2021,

Ftesa tjetër me 12.08.2021 me të njëjtit akterë të grupeve të interesit

Dhe takimi i KPF-së me 06.09.202.

- Pas, skadimit të afatit kohor të përcaktuara në qarkoren buxhetore të shpërndarë Nr. 2022/01 Nr. prot. 797/2021 datë 14.05.2021, Sipas intervistës së realizuar me zyrën për buxhet dhe ZKF lidhur me aktivitetet dhe sfidat në hartimin e buxhetit, theksim të çështjes kishin faktin e

pjesëmarrjes dhe koordinimit të ulët të aktiviteteve ndërmjet menaxhmentit të lart drejtues (Drejtoret komunal) me Zyrën e Buxhetit dhe ZKF.

Drejtoria e financave ka shpërndarë me kohë tek të gjithë Drejtoret e Drejtorive Komunal kopjen e qarkores buxhetore, mirëpo nuk ka marrë përgjigje kthyesë, me projekt- propozime dhe arsyeshmëritë ekonomike të projekteve.

- Sipas konstatimit të auditorit, ka një ngecje të theksuar të shfrytëzimit racional dhe në kohë të mjeteve, që brenda nëntë muorit janë shpenzuar vetëm 41.41%, e pjesa tjetër prej 58.58% të pa shpenzuara që mbetin për 3 muaj të vitit 2022.

Nga të dhënat për këto kategori rezulton se; nga shuma totale për Investime kapitale 4,914,643.68€

Rrugë, Kanalizime e ndriçimin publikë janë ndarë: 3,568,674.85€, ose 73 %

Të shpenzuara për këtë kategori: 1,627,585.52€, ose 46%

Të pa shpenzuara për këtë kategori: 1,941,089.40€, ose 54%

Edhe në kategorinë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, ka pas ndarje shumë të ulët, e cila kategori sipas konstatimit të auditorit, ishte dashtë një vlerë më e lartë në investime për shëndetësi, ku bazohemi edhe në vlerën e shpenzuar dhe vlerën e mbetur.

Shëndetësi e mirëqenie sociale 186,765.00€, ose 4%.

Nga totali Investimeve kapitale 4,914,643.68€

Të shpenzuara 154,680.90€, ose 83%

Të pa shpenzuara 32,084.00€, ose 17%

Ndërsa në kategorinë për Arsim dhe Shkencë, vlera e ndarë në raport me vlerën e shpenzuar dhe mbetja na krijon bindje se është bërë një ndarje jo adekuate sepse ka një mbetje të lartë.

Arsim dhe shkencë 753,437.86€, ose 15% nga totali i investimeve Kapitale 4,914,643.68€

Të shpenzuara 168,076.27€, ose 22%

Të pa shpenzuara 585,361.59€, ose 78%

E njëjta gjendje qëndron edhe te kategoria e shpenzimeve për Kulturë, Rini e Sport, mjete të ndara 351,800.45 € ose 7.16% nga totali i Investimeve kapitale prej 4,914,643.68 €.

Të shpenzuara janë vetëm 85,043.53 , ose 24%

Të pa shpenzuara janë 266,756.92 , ose 76%

Edhe nga kjo kategori ka ngecje në shpenzimin e shumës së planifikuar.

Rekomandimet:

-Rekomandohet Kryetari i Komunës që të kërkojë nga Drejtorët e Drejtorive komunale, ti hartojnë projekt-propozimet me analiza dhe arsyeshmëri ekonomike me kohë dhe ti dorëzojnë në zyrën për buxhet e financa.

-Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të ndikoj tek drejtoritë relevante të ngarkuara me buxhet, që ti respektojnë me përpikëni, dinamikat e shpenzimeve në Investime kapitale, Si dhe të shikohen mundësitë buxhetore për vitin e ardhshëm të rritet investimi në kategorinë për shëndetësi si kategori me nevoja të shtuara në të mirë të qytetarëve të Komunës së Malishevës.

-Rekomandojmë që të hartohen projektet kryesore për secilin projekt bazuar në standarde unike të ndërtimit, të bëjnë planifikimin e duhur për secilin projekt, aktivitetet e prokurimit të fillojnë në kohën më të mirë të mundshme, të sigurohet buxhet i mjaftueshëm që projektet të realizohen brenda afateve kohore optimale, të planifikohet dhe të kryhet analizë e kosto-përfitimit, të sigurojnë menaxhim adekuat të kontrollit të cilësisë gjatë përfundimit të projekteve.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit :

Aktivitetet e planifikimit të buxhetit nuk janë respektuar sa duhet nga stafi menaxherial, drejtorët e drejtorive Komunale. Ka pasur koordinim të ulët të aktiviteteve rreth hartimit të buxhetit komunal ndërmjet departamenteve komunale në fazat e propozimit të projekteve dhe shpenzimeve kapitale. Koordinimi më aktiv në aktivitetet rreth hartimit të buxhetit komunal ndërmjet departamenteve komunale në fazat e propozimit të projekteve dhe shpenzimeve kapitale do të rezultonte me një planifikim më të mirë dhe më të drejtë të buxhetit.

Një pjesë e madhe e investimeve kapitale ende janë të orientuara në pjesën e infrastrukturës rrugore. Faktorë që ndikojnë në orientimin e investimeve kapitale më shumë në planifikim urban dhe mjedisor përfshijnë infrastrukturën ende të dobët në disa pjesë, kërkesa për të pasur vlerë të shtuar sidomos në shëndetësi, kujdesi i shpenzimeve në mundësinë sa më racionale tek kategoria e arsimit e cila rezulton me shpenzim të ulët për nëntëmujor, dhe kategoria për Kulturë, Rini e Sport e cila ka ngecje të larta.

Bazuar në gjetjet e këtij auditimi, arrijmë në përfundimin se: Implementimi I projekteve kapitale në vazhdimësi përcillen me vështirësi të shumta duke filluar nga : Mungesa e hartimit të projekteve kryesore, planifikimi jo adekuat i aktiviteteve, kërkesa për punë shtesë, buxhetimi i pamjaftueshëm, mungesa e sistemit të kontrollit të cilësisë.

ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Zyra për Barazi Gjinore gjatë periudhës janar – dhjetor 2022 ka realizuar një sërë aktiviteteve për të promovuar barazinë gjinore, të drejtat e grave në jetën shoqërore, sociale e politike.

Realizimi i ligjëratave, punëtorive duke përfshirë grupe të grave dhe nxënës nëpër të gjitha shkollat, me tema të ndryshme duke filluar nga të drejtat e njeriut me theks të veçantë të drejtat e fëmijëve, kundër-trafiking, kundër dhunës në familje, barazia gjinore në familje e shoqëri,

shpërndarje të fletëpalosjeve me tematika të ndryshme të cilat kanë ndikuar në sensibilizim dhe vetëdijesim e komunitetit.

Po ashtu ZBGJ ka promovuar barazinë gjinore në shumë institucione përmes aktiviteteve të ndryshme, duke bashkëpunuar dhe realizuar takime, debate, rekomandime të përbashkëta për të arritur dhe njoftuar opinionin për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore në përgjithësi si kusht për arritjen e një shoqërie të qëndrueshme dhe demokratike, dhe në bazë të saj në parandalimin e dukurive negative të cilat shërbejnë për vetëdijesimin dhe sensibilizimin e qytetarëve.

Krahas saj, ZBGJ ka qenë edhe pjesëmarrëse në shumë takime në nivel qendror dhe regjional për të marr përvoja të ndryshme, në mënyrë që të zgjerojë aktivitetet më tutje.

Bashkëpunimet:

Bashkëpunimi me përfaqësuesin nga zyra e avokatit të popullit (nivel regjional-Gjakovë) me ditën e hapur me qytetarët e komunës së Malishevës (ligjërata në dy shkolla, me nxënës dhe mësime të mësimdhënës)

Bashkëpunimi me organizatën Help in Kosova, kanë përfituar 37 biznese

Trajnim në qendrën inovative – Gjakovë, përpunimi i pemëve dhe perimeve (pjesëmarrëse në takim fermeret nga shoqata Fatjona)

Përmes qendrës për punë sociale vizita gjinekologjike falas kanë përfituar po ashtu gratë nga shoqata Fatjona

Panairi në bashkëpunim me DKRS dhe promovimi i produkteve bujqësore dhe ushqimore, pjesëmarrëse edhe komunat tjera

Trajnim artizanal për punën në vek (trashëgimia kulturore)

Bashkëpunimi me zyrën juridike falas rreth rasteve të ndryshme (dhuna në familje, e drejta pronësore)

Bashkëpunimi me drejtoritë komunale (kërkesë drejtorive që objektivat programore të hartohen nga perspektiva gjinore)

Të dhënat statistikore në baza gjinore

Komuna e Malishevës ka gjithsejtë 69.656 banorë me numër të përgjithshëm, 27.973 femra dhe 26.683 meshkuj dhe me 15.000 banorë jo rezident.

Prej 41 shkollave amë dhe dy paraleleve kemi 10 drejtoresha

Janë të regjistruara gjithsej 138 biznese – 22 femra – 116- meshkuj.

ZYRA PËR INFORMIM PUBLIK

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 ka realizuar këto aktivitete:

1. Përcjellja e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Këshillit të Drejtorëve, komiteteve dhe organizmave tjerë komunal.
2. Informimi i medieve për vendimet e marra në Kuvend dhe Këshill të Drejtorëve
3. Udhëheqja e shërbimit të informimit publik.
4. Informimi i organeve komunale, lidhur me shkrimet në media
5. Reagimi ndaj shkrimeve tendencioze.
6. Përgatitja e Buletinit mujor dhe vjetor, lidhur me informacionet dhe ngjarjet që kanë ndodhur gjatë muajit dhe vitit në komunën tonë.
7. Mirëmbajtja e ueb faqes zyrtare të komunës.
8. Punë dhe obligime të tjera në bashkëpunim me udhëheqësit komunal.
9. Informimi paraprak për ngjarjet në komunë.

- Nga obligimet dhe takimet e shënuara në detyrat e dhëna, kemi përgatitur informacione për medie, dhe pothuajse të gjitha janë publikuar në mediet elektronike dhe të shkruara, përfshirë radio dhe televizionet lokale TV Malisheva dhe RTV Malisheva, Radio "Kosova e Lirë", radiotelevizionin publik, televizionet tjera dhe portalet informative.

- Po ashtu, të gjitha informacionet janë bërë publike edhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Malishevës: <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>, si dhe në rrjetet sociale.

- Një punë tjetër e Zyrës për Informim Publik, është ruajtja e artikujve të botuar në gazetat ditore, për të cilat, çdo drejtor apo zyrtar komunal, mund ti shfletoj në Zyrën për Informim, por edhe të ketë kopje të tyre.

- Në mënyrë të rregullt përgatitet Buletini Mujor, i cili është i publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës, si dhe arkivohet në arkivin e komunës.

- Për të gjitha aktivitetet mujore, informohen mediet dhe njoftime bëhen publike në ueb faqet zyrtare.

Aktivitetet dhe publikimet tjera: Gjatë periudhës janar- dhjetor të vitit 2022, janë zhvilluar 1059 aktivitete të ndryshme, ku përfshihen përcjellja e aktiviteteve të kryetarit, drejtorëve komunal dhe zyrtarëve tjerë.

Prej këtyre aktiviteteve, janë aktivitete të kryetarit dhe qeverisë komunale, ku përfshihen takimet në zyrat përkatëse, vizita në terren, takime me qytetarë dhe të tjera, ku janë bërë 592 lajme, 103 njoftime, shpallje dhe 73 konkurse, 12 buletine (Janar- Dhjetor 2022), si dhe janë publikuar dokumente ku përfshihen, 30 kontratat, 7 plane pune dhe raporte pune, 8 Rregullore, dhe vendime të kryetarit, 99 vendime të Kuvendit të Komunës, 9 procesverbale të KK, mbledhje të

kuvendit, 10 të rregullta, 1 solemne, 2 të jashtëzakonshme, 3 urgjente, 8 procesverbale të Komitetit për Politikë, mbledhje të rregullta 9, 16 konsultime publike, debate me qytetarë, dëgjimet publike të kryetarit, kurse, drejtorisë për buxhet dhe financa, rregulloreve me pjesëmarrje të grupeve të interesuara, po ashtu janë thirrur 16 takimi dhe janë mbajtur, ku përfshihen 4 takime të kryetarit të komunës, pastaj 1 strategji, 8 rregullore, 1 plan pune dhe 7 dëgjime tjera, përfshi edhe 4 dëgjime për hartimin e buxhetit të komunës, për vitin 2023/2025. Në këto takime kanë marrë pjesë 252 pjesëmarrës 202 meshkuj dhe 50 femra, janë mbajtur edhe 2 takime publike me qytetarë të organizuara nga zyra e Kryetarit. 22 kërkesa në Qasjen për Dokumente Publike, prononcime publike për medie nga zyrtari për informim, e po ashtu edhe nga kryetari i komunës, 45 aktivitete të komiteteve dhe komisioneve janë përcjellë. Çdo të Enjte, pritja e palëve ka vazhduar me kryetarin.

Bazuar në këto të dhëna, Zyra për Informim Publik, ka kryer më shumë se shtatë aktivitete të ndryshme, brenda një dite, pa e llogaritur këtu edhe daljet në terren dhe punën jashtë orarit. Sipas nevojës, është punuar edhe jashtë orarit të punës, përfshi edhe ditët e vikendit apo ditët e festave zyrtare. Gjithashtu, ueb faqja e Komunës së Malishevës, është freskuar në vazhdimësi, sidomos linçet e lajmeve, njoftimeve dhe publikimi i dokumenteve, sipas nevojave dhe kërkesave të zyrave përkatëse.

Raport për konsultimet publike gjatë vitit 2022 nga Komuna e Malishevës

Gjatë vitit 2022, Komuna e Malishevës, ka bërë 13 konsultime publike, për rregullore, plane, strategji dhe çështje tjera të cilat duhet t'i nënshtrohen konsultimit publik. Po ashtu, gjatë këtij vitit janë zhvilluar apo thirrur edhe 16 takime konsultative me qytetarë dhe grupe të interesit, e që lidhen me dokumentet që duhet dalin në konsultim publik.

Në diskutim publik janë dalë 8 rregullore, 4 plane pune dhe 2 dokumente strategjike. Ndërsa në konsultime-takime publike janë mbajtur 16, ku përfshihen 4 takime të kryetarit të komunës, pastaj 1 strategji, 7 rregullore, 1 plan pune dhe 7 dëgjime tjera, përfshi edhe 4 dëgjime për hartimin e buxhetit të Komunës së Malishevës, 2023-2025. Në këto takime konsultative kanë marrë pjesë 252 pjesëmarrës, prej tyre 202 meshkuj dhe 50 femra.

Të gjitha njoftimet për diskutimet dhe konsultimet publike, së bashku me raportet e punës janë në vegzën – linkun në ueb faqen e Komunës së Malishevës:

Po ashtu, të njëjtat të dhëna, pra njoftimet për diskutime dhe konsultime publike janë të publikuara në platformën qeveritare për konsultime publike:

PËRFUNDIM:

Në këtë raport është paraqitur puna dhe aktivitete thuajse të detajuara të Kryetarit të Komunës dhe të Drejtorive Komunale, për periudhën raportuese Janar-Dhjetor 2022. Shpresoj shumë që me përvojën e fituar përmes angazhimeve gjatë kësaj periudhe raportuese, si dhe me përkrahjen e përfaqësuesve të zgjedhur në Kuvendin Komunal të Komunës së Malishevës, do të vazhdojmë të realizojmë projekte të mira, me interes për qytetarët dhe në funksion të jetësimit të projektit të madh për Malishevën Urbane.

Mirëpresim sugjerimit dhe propozimet me rastin e shqyrtimit, përkatësisht diskutimeve rreth këtij Raporti, në Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe më pas në Kuvendin Komunal.

KRYETARI

EKREM KASTRA TI



Malishevë, maj 2023



SHTOJCA NR. 1

RAPORTI I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE PËR PËRIUDHËN JANAR-DHJETOR 2022



PËRMBAJTJA

HYRJE	2
Raporti periodik i Informatave Menaxheriale për Kryetarin, K.K. Komunal,	3
TË HYRAT	4
1. Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas burimeve Tab. 1.	4
1.1. Shkalla e alokimit të buxhetit për vitin 2022. Grafiku. 1.	4

2.	Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas kodeve ekonomike Tab. 2.....	5
2.1.	Realizimi i të hyrave sipas kodeve ekonomike janar-dhjetor 2022.Grafiku 2.....	5
3.	Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas Drejtorive Tab. 3.....	6
4.	Përmbledhja e të hyrave të drejtorive sipas kodeve ekonomike Tab. 4.	6
4.1.	Zyra e Kryetarit Tab. 4.1.	6
4.2.	Administrata dhe personeli Tab. 4.2.....	7
4.3.	Qështjet gjinore Tab. 4.3.....	7
4.4.	Zyra e Kuvendit komunal Tab. 4.4.	7
4.5.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa Tab. 4.5.....	8
4.6.	Drejtoria e Shërbimeve Publike Tab. 4.6.....	8
4.7.	Zyra lokale e komuniteteve Tab. 4.7.	8
4.8.	Drejtoria për Bujqësi, Plltari dhe zhvillim rural Tab. 4.8.	9
4.9.	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër Tab. 4.9.	9
4.10.	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis Tab. 4.10.....	9
4.11.	Drejtoria për Shëndetësi primare Tab. 4.11.....	10
4.12.	Shëndetësi sociale Tab. 4.12.....	10
4.13.	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport Tab. 4.13.	11
4.14.	Drejtoria për Arsim dhe Shkencë Tab. 4.14.	11
5.	Të hyrat vetanake sipas drejtorive dhe kodeve ekonomike Tab. 5.	12
5.1.	THV të planifikuara,të realizuara në PR Janar-dhjetor 2022 dhe krahasimi 2021.Gr.3.....	15
5.2.	THV në mënyrë analitike Tab.5.1.....	16
6.	SHPENZIMET.....	17
6.1.	Përmbledhja e shpenzimeve sipas burimit të financimit Tab. 6.....	17
6.2.	Planifikimi dhe shpenzimi i buxhetit 2022.Grafiku 4.....	17
6.3.	Përmbledhja e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike Tab. 7.....	18
6.4.	Shpenzimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike Grafiku. 5.	18
6.5.	Shpenzimet për paga dhe mëditje në mënyrë analitike janar-dhjetor 2022. Tab. 7.1.....	19
6.6.	Shpenzimet për shërbimet komunale në mënyrë analitike janar-dhjetor 2022. Tab. 7.2.....	19
6.7.	Shpenzimet për subvencione dhe transfere në mënyrë analitike janar-dhjetor 2022. Tab. 7.3.....	19
6.8.	Shpenzimet për mallra dhe shërbime në mënyrë analitike janar-dhjetor 2022. Tab. 7.4.....	20
6.9.	Shpenzimet për investimet kapitale në mënyrë analitike janar-dhjetor 2022. Tab. 7.5.....	21
6.10.	Shpenzimet sipas drejtorive janar-dhjetor për vitin 2022. Tab. 7.6.	22
8.	PROJEKTET KAPITALE.....	23
8.1.	Projektet kapitale të Drejtorisë për administratë Tab. 8.1.....	23
8.2.	Projektet kapitale të Drejtorisë për shërbime publike Tab. 8.2.....	24
8.3.	Projektet kapitale të Drejtorisë për planifikim urban dhe mjedis Tab. 8.3.	25
8.4.	Projektet kapitale të Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenje sociale Tab. 8.4.....	26
8.5.	Projektet kapitale të Drejtorisë për kulturë, rini dhe sport Tab. 8.5.....	27

8.6. Projektet kapitale të Drejtorisë për Arsim dhe Shkencë Tab. 8.6.	28
8.7. Projektet kapitale prej Donacioneve të ndryshme Tab.8.7.....	29
8.8. Burimet e financimit të projekteve kapitale në total. Tab. 8.8.....	30

HYRJE

Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048 si dhe Ligjit nr.03/L-221 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-048, gjegjësisht nenit 6.3,6.4 si dhe nenit 45, për raportimet vjetore dhe periodike mbi menaxhimin dhe shpenzimin e buxhetit, Organizatat buxhetore janë të obliguara ti paraqesin raportet periodike dhe përfundimtare financiare.

Prandaj Drejtoria për Buxhet dhe financa ka përpiluar raportin financiar për periudhën Janar-dhjetor 2022 në bazë të standardeve të Kontabilitetit dhe procedurave të thesarit mbi të hyrat dhe shpenzimet e ndodhura në këtë periudhë.

Sipas të dhënave të prezantuara në tabelat përkatëse del se K.K-Malishevë ka një buxhet të miratuar nga Kuvendi Komunal për vitin fiskal-2022, në shumën prej **15,655,757.00€** për të gjitha programet dhe nën programet. Kur kësaj i shtohen bartjet e disa shumave të vogla të donacioneve të mbetura nga vitet e kaluara në shumë prej **1,140.35€** të regjistruara në SIMFK, del se shuma totale e buxhetit është **15,656,897.35€**. Kësaj shume i shtohen edhe shumat prej **640,429.28€** nga të hyrat e bartura nga viti **2021**, fin. nga huamarrjet për paga në shëndetësi **92,883.00€** dhe rritja e buxhetit për paga në arsim për mbulimin e vendimeve gjyqësore për **367,711.25€**, del se buxheti i tërësishëm i futur në SIMFK si buxhet aktual përfundimtar kap shumën prej **16,757,920.88 €**.

-Buxheti i alokuar për këtë periudhë, (Janar-dhjetor 2022), kap shumën prej: **16,749,384.69€** çka do të thotë se shkalla e realizimit (alokimit të buxhetit total) është **99.95%**.

-Sipas shënimeve nga librat e thesarit del se shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar (alokuar) për periudhën janar-dhjetor 2022 është **(16,,705,105.04/16,749,384.69)x100= 99.74%**.

-Kurse përqindja e tërësishme e buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë është:
(16,705,105.04/16,757,920.88)X100=99.68%.

Në faqet në vazhdim janë dhënë tabelat e planit të buxhetit, realizimi dhe shpenzimi i tij sipas programeve, sipas burimeve (fondeve), sipas kategorive ekonomike dhe sipas drejtorive në mënyrë sintetike dhe analitike për periudhën Janar-dhjetor 2022

Sipas buxhetit për vitin fiskal 2022, nga të hyrat vetanake janë planifikuar të mblidhen, **1,033,469.00€**.

Plani i realizimit të të hyrave vetanake për periudhën Janar-dhjetor 2022, është: të hyrat e rregullta janë **914,297.11€**. Këto të hyra janë të futura në sistem, kurse janë alokuar shuma prej **1,033,469.00€**, pra aq sa janë të planifikuara, kurse gjobat në trafik për janar-dhjetor, kapin shumën **350,001.00€**. Kurse gjobat e gjykatave në këtë periudhë janë **51,580.00€**. Gjithashtu të hyrat nga agjencioni pyjor i Kosovës për këtë periudhë janë **21.60€**. Pra të hyrat e gjithmbarshme, vetanake të realizuara për këtë periudhë kapin shumën prej **1,315,899.71€**.

Pra sipas shënimeve aktuale, në këtë periudhë pra janar-dhjetor 2022, përqindja e realizimit të të hyrave vetanake në krahasim me planifikimin është **(1,315,899.71/1,033,469.00/)x100=127.33%**. Pra kemi një tejkalim prej **27.33%**


Drejtoria për Ekonomi, Financë dhe Buxhet

TË HYRAT

1. Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas burimeve Tab. 1.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të shpenzuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	€
Fin.nga Huamarrjet	11	92,883.00	92,883.00	100.00	35,564.69
Granti Qeveritar	13	14,989,999.25	14,981,463.50	99.94	15,007,386.46
Të hyrat vetanake	14	1,033,469.00	1,033,469.00	100.00	807,308.00
Mjetet e bartura	20	640,429.28	640,428.84	100.00	
Donacionet e brendshme	30	412.97	412.97	100.00	412.97
Donacionet e jashtme		727.38	727.38	100.00	727.38
TOTALI		16,757,920.88	16,749,384.69	99.95	15,851,399.50

1.1. Shkalla e alokimit të buxhetit për vitin 2022 Grafiku. 1.




Nga tabela e më sipërme shihet se buxheti përfundimtar për vitin -2022 është **16,757,920.88€**. Shuma totale e buxhetit e miratuar në kuvend është **15,665,757.00€**, shuma prej **1,140.35€** është nga disa shuma të vogla të mbetura të donacioneve nga vitet paraprake, që buxhetin e rrisin në **15,656,897.35€**, shuma prej **640,429.28€** të hyrat e bartura nga 2021, shuma prej **92,883.00€** fin. nga huamarrjet për paga në shëndetësi, rritje e buxhetit për paga në arsim për mbulimin e vendimeve gjyqësore **367,711.25€**, e rrisin buxhetin përfundimtar në SIMFK në **16,757,920.88€**.

2. Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas kodeve ekonomike Tab. 2.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	€
Paga dhe medetje	11	9,044,541.50	9,043,718.00	99.99	9,281,978.15
Mallra dhe shërbime	13	1,836,023.45	1,836,023.45	100.00	1,541,424.90
Komunali	14	455,000.00	455,000.00	100.00	455,000.00
Subvencione dhe transfere	20	500,000.00	500,000.00	100.00	459,000.00
Investimet kapitale	30	4,914,643.68	4,914,643.24	100.00	4,113,996.45
				#DIV/0!	
TOTALI		16,750,208.63	16,749,384.69	100.00	15,851,399.50

Në këtë tabelë është dhënë buxheti dhe realizimi (alokimi) i tij sipas pesë kategorive ekonomike si dhe krahasimi sipas periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Pra për periudhën janar-dhjetor **2022** është alokuar shuma prej **16,749,384.69€**.

2.1. Realizimi i të hyrave sipas kodeve ekonomike janar-dhjetor 2022. Grafiku 2.



3. Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas Drejtorive Tab. 3.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	€
Zyra e Kryetarit	160	108,773.03	108,773.03	100.00	93,033.47
Administrata dhe personeli	163	625,119.39	625,119.39	100.00	509,509.36
Qështje gjinore	165	12,901.46	12,901.46	100.00	12,172.87
Zyra e Kuvendit komunal	169	143,781.19	143,781.19	100.00	135,702.36
Buxheti dhe Financat	175	165,243.57	165,243.57	100.00	319,049.30
Shërbimi publik, mbrojtja civile dhe emergjenca	180	2,166,807.12	2,166,806.68	100.00	1,495,005.04
Zyra lokale e komuniteteve	195	11,841.36	11,841.36	100.00	10,913.81
Bujqësi, Pylltari, zh. Rural	470	332,100.19	332,100.19	100.00	431,374.99
Gjeodezi dhe Kadastër	650	60,232.13	60,232.13	100.00	52,676.38
Planifikimi urban dhe mjedisi	665	1,963,065.79	1,963,065.79	100.00	2,070,660.09
Shëndetësia primare	730	2,234,586.08	2,226,873.83	99.65	2,066,946.40
Shërbimet sociale	755	114,706.78	114,706.78	100.00	102,858.54
Kulturë, Rini dhe Sport	850	496,230.20	496,230.20	100.00	370,733.41
Arsim dhe Shkencë	920	8,322,532.59	8,321,709.09	99.99	8,180,763.48
TOTALI		16,757,920.88	16,749,384.69	99.95	15,851,399.50

Buxheti planifikuar dhe realizuar(alokuar) sipas drejtorive aktuale si dhe krahasimi me periudhën e njëjt të vitit të kaluar është dhënë në këtë tabelë.

4. Përmbledhja e të hyrave të drejtorive sipas kodeve ekonomike Tab. 4.

4.1. Zyra e Kryetarit Tab. 4.1.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
Paga dhe meditje	11	36,023.03	36,023.03	100.00	33,033.47
Mallra dhe shërbime	13	7,750.00	7,750.00	100.00	10,000.00
Shpenzimet komunale	14				
Subvencionet dhe transferet	20	65,000.00	65,000.00	100.00	50,000.00
Investimet kapitale	30				
TOTALI		108,773.03	108,773.03	100.00	93,033.47

4.2. Administrata dhe personeli Tab. 4.2.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	€
Paga dhe medetje	11	297,215.39	297,215.39	100.00	289,209.36
Mallra dhe shërbime	13	274,904.00	274,904.00	100.00	220,300.00
Shpenzimet komunale	14				
Subvencionet dhe transferet	20				
Investimet kapitale	30	53,000.00	53,000.00		
TOTALI		625,119.39	625,119.39	100.00	509,509.36

4.3. Qështjet gjinore Tab. 4.3.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2021	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	€
Paga dhe medetje	11	6,701.46	6,701.46	100.00	6,672.87
Mallra dhe shërbime	13	6,200.00	6,200.00	100.00	5,500.00
Shpenzimet komunale	14				
Subvencionet dhe transferet	20				
Investimet kapitale	30				
TOTALI		12,901.46	12,901.46	100.00	12,172.87

4.4. Zyra e Kuvendit komunal Tab. 4.4.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	€
Paga dhe medetje	11	97,281.19	97,281.19	100.00	85,702.36
Mallra dhe shërbime	13	46,500.00	46,500.00	100.00	50,000.00
Shpenzimet komunale	14				
Subvencionet dhe transferet	20				
Investimet kapitale	30				
TOTALI		143,781.19	143,781.19	100.00	162,582.36

4.5. Drejtoria për Buxhet dhe Financa Tab. 4.5.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
Paga dhe medijtje	11	121,761.20	121,761.20	100.00	121,055.93
Mallra dhe shërbime	13	28,111.42	28,111.42	100.00	38,622.42
Shpenzimet komunale	14			#DIV/0!	
Subvencionet dhe transferet	20	15,000.00	15,000.00		159,000.00
Investimet kapitale	30	370.95	370.95	100.00	370.95
TOTALI		165,243.57	165,243.57	100.00	319,049.30

4.6. Drejtoria e Shërbimeve Publike Tab. 4.6.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
Paga dhe medijtje	11	183,733.86	183,733.86	100.00	193,505.04
Mallra dhe shërbime	13	144,945.00	144,945.00	100.00	119,721.00
Shpenzimet komunale	14	170,000.00	170,000.00	100.00	170,000.00
Subvencionet dhe transferet	20				
Investimet kapitale	30	1,668,128.26	1,668,127.82	100.00	1,011,779.00
TOTALI		2,166,807.12	2,166,806.68	100.00	1,495,005.04

4.7. Zyra lokale e komuniteteve Tab. 4.7.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	€
Paga dhe medijtje	11	6,042.36	6,042.36	100.00	5,913.81
Mallra dhe shërbime	13	5,799.00	5,799.00	100.00	5,000.00
Shpenzimet komunale	14				
Subvencionet dhe transferet	20			#DIV/0!	
Investimet kapitale	30			#DIV/0!	
TOTALI		11,841.36	11,841.36	100.00	10,913.81

4.8. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe zhvillim rural Tab. 4.8.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	€
Paga dhe medetje	11	114,900.19	114,900.19	100.00	115,875.25
Mallra dhe shërbime	13	17,200.00	17,200.00	100.00	15,499.74
Shpenzimet komunale	14				
Subvencionet dhe transferet	20	200,000.00	200,000.00	100.00	100,000.00
Investimet kapitale	30			#DIV/0!	200,000.00
TOTALI		332,100.19	332,100.19	100.00	431,374.99

4.9. Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër Tab. 4.9.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	
Paga dhe medetje	11	50,396.87	50,396.87	100.00	44,441.12
Mallra dhe shërbime	13	9,600.00	9,600.00	100.00	8,000.00
Shpenzimet komunale	14				
Subvencionet dhe transferet	20				
Investimet kapitale	30	235.26	235.26	100.00	235.26
TOTALI		60,232.13	60,232.13	100.00	52,676.38

4.10. Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedisi Tab. 4.10.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	
Paga dhe medetje	11	51,314.75	51,314.75	100.00	44,245.71
Mallra dhe shërbime	13	11,200.00	11,200.00	100.00	16,000.00
Shpenzimet komunale	14				
Subvencionet dhe transferet	20				
Investimet kapitale	30	1,900,551.04	1,900,551.04	100.00	2,010,414.38
TOTALI		1,963,065.79	1,963,065.79	100.00	2,070,660.09

4.11 Drejtoria për Shëndetësi primare Tab. 4.11.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	€
Paga dhe medijtje	11	1,176,592.77	1,168,880.52	99.34	1,023,065.64
Mallra dhe shërbime	13	601,228.31	601,228.31	100.00	454,290.76
Shpenzimet komunale	14	170,000.00	170,000.00		170,000.00
Subvencionet dhe transferet	20	100,000.00	100,000.00		
Investimet kapitale	30	186,765.00	186,765.00	100.00	419,590.00
TOTALI		2,234,586.08	2,226,873.83	99.65	2,066,946.40

4.12 Shëndetësi sociale Tab. 4.12.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	€
Paga dhe medijtje	11	64,262.78	64,262.78	100.00	52,414.54
Mallra dhe shërbime	13	50,444.00	50,444.00	100.00	50,444.00
Shpenzimet komunale	14				
Subvencionet dhe transferet	20				
Investimet kapitale	30			#DIV/0!	-
TOTALI		114,706.78	114,706.78	100.00	102,858.54

4.13. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport Tab. 4.13.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	€
Paga dhe medijtje	11	47,241.75	47,241.75	100.00	51,487.43
Mallra dhe shërbime	13	27,188.00	27,188.00	100.00	117,993.98
Shpenzimet komunale	14				
Subvencionet dhe transferet	20	70,000.00	70,000.00	100.00	80,000.00
Investimet kapitale	30	351,800.45	351,800.45	100.00	121,252.00
TOTALI		496,230.20	496,230.20	100.00	370,733.41

4.14. Drejtoria për Arsim dhe Shkencë Tab. 4.14.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	€
Paga dhe medijtje	11	6,798,786.15	6,797,962.65	99.99	7,215,355.62
Mallra dhe shërbime	13	604,953.72	604,953.72	100.00	430,053.00
Shpenzimet komunale	14	115,000.00	115,000.00	100.00	115,000.00
Subvencionet dhe transferet	20	50,000.00	50,000.00	100.00	70,000.00
Investimet kapitale	30	753,792.72	753,792.72	100.00	350,354.86
TOTALI		8,322,532.59	8,321,709.09	99.99	8,180,763.48

TOTALI	16,757,920.88	16,749,384.69	99.95%	15,851,399.50
---------------	----------------------	----------------------	---------------	----------------------

Në këtë tabelë është dhënë buxheti dhe realizimi (alokimi) i tij sipas drejtorive komunale dhe sipas kategorive ekonomike për program dhe nën program buxhetor, gjithashtu krahasimi për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

5. Të hyrat vetanake sipas drejtorive dhe kodeve ekonomike Tab. 5.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6 (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
Administrata	163	€	€	%	€
Certifikata dhe dokumente zyrtare		73,571.00	56,559.05	76.88	52,115.85
Taksa tjera komunale (administrative)		10,000.00	7,732.63	77.33	10,142.68
Të tjera			9.14		
TOTALI		83,571.00	64,300.82	76.94	62,258.53

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2022	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2022	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
1	2	3	4	5=4/3*100	6 (alokuara) në të njëjtën periudhë 2021
Buxheti	163	€	€	%	€
Tatimi në pronë		436,484.00	370,492.96	84.88	374,470.71
Taksa e mjeteve motorike		100,000.00	103,366.00	103.37	95,573.24
Taksë për ushtimin e veprimtarisë		50,000.00	44,117.10		8,985.00
Qiraja vendosje objekt tregtar		10,000.00	8,879.00		
TOTALI		586,484.00	526,855.06	89.83	479,028.95

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
